




ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA



PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL



2014-2029+

Municipal Spatial Planning Support Programme in Kosovo
Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë
Program Podrske Prostornom Planiranju u Opstinama na Kosovu

Implemented by:
UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financed by:
**SWEDISH DEVELOPMENT
COOPERATION**





„Komuna e Graçanicës, e pasur me thesare dhe bukuri natyrore antike dhe mesjetare- me mjedis modern dhe me ekonomi dhe infrastrukturë të zhvilluar ku çdokush gëzon të njëjtat të drejta dhe liri“

(“Punëtorja për vizionimin e Graçanicës ”, Ohër, 2010)

Ky dokument është i përgatitur nga Komuna e Graçanicës, ku bartës është Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mjedisit, me mbështetjen e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP), e realizuar nga UN-Habitat-i dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor respektivisht Instituti për Planifikimin Hapësinor.

Ky draft version i Planit Zhvillimor Komunal të Graçanicës është rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë dhe mbështetjes nga UN-Habitat-i, por nuk i shpreh domosdoshmërishtë pikëpamjet dhe opinionet e UN-Habitat-it.



Graçanicë, Korrik 2014

GRUPET PUNUESE PËR HARTIMIN E PZHk- KOMUNA E GRAÇANICËS

Komiteti Drejtues për Hartimin e PZhK

(Administrata e tanishme)

Branimir Stojanovic, Kryetar;
Srdjan Petkovic, Zëvendës Kryetar;
Miljaz Gashi, Zëvendës Kryetar për çështje të komunitetit shqiptar;
Sebastian Serifovic, Zëvendës Kryetari për çështje të komunitetit rom;
Nebojsa Peric, Këshilltar i Kryetarit të Komunës për çështjet politike.
Vladeta Kostic, Kryetar i Kuvendit.
Dejan Jovanovic, Drejtor, Departamenti i Planifikimit;
Aleksandar Mihajlovic, Drejtor, Departamenti i Shërbimeve Publike;
Dragan Dimitrijevic, Drejtor, Departamenti i Arsimit;
Jovica Vasic, Drejtor, Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies.
Slavisa Nicic, Drejtor, Departamenti i Financave;
Zvonko Stevic, Drejtor, Departamenti i Administratës;
Milos Dimitrijevic, Drejtor, Departamenti i Inspektimit;
Vojkan Marinkovic, Shef i Kadastrit.

(Administrata e kaluar)

Bojan Stojanovic, Kryetar;
Igor Ariconovic, Zëvendës Kryetar;
Viktor Djokic, Këshilltar i Kryetarit për çështjet politike dhe koordinator i projekteve.
Goran Lazic, Kryetar i Kuvendit.
Nada Brkljac, Drejtor, Departamenti i Planifikimit;
Jelena Stojanovic, Drejtor, Departamenti i Shërbimeve Publike;
Verica Ristic dhe Elia Mladenovic, Drejtorët, Departamenti i Arsimit;
Bojan Todorovic, Drejtor, Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies.
Slavisha Nicic, Drejtor, Departamenti i Financave;
Nebojsa Milovanovic, Drejtor, Departamenti i Administratës;
Agron Batalli, Drejtor, Departamenti i Inspektimit;
Vojkan Marinkovic, Shef i Kadastrit.

Ekipi Kryesor për Hartim të PZhK

Dejan Jovanovic, Drejtor, Departamenti i Planifikimit (Menaxher aktual i PZhK);
Nada Brkljac, Drejtor, Departamenti i Planifikimit (Menaxher i kaluar i PZhK);
Natasa Dimitrijevic, Zyrtar për Planifikim (Koordinator e PZhK);
Mirjana Stanojevic, Zyrtar për Planifikimi.

Ekipi Komunal për Planifikim

Natasha Dimitrijevic, Zyrtar për Planifikim (Drejtues i Groupit Tematik), Departamenti i Planifikimit;
Mirjana Stanojevic, Zyrtar për Planifikim (Drejtues i Groupit Tematik), Departamenti i Planifikimit;
Nevenka Rika, Zyrtar për Leje te Ndërtimit, Departamenti i Planifikimit;
Igor Rasic, Zyrtar për Mbrojtje te Mjedisit, Departamenti i Planifikimit;
Alexander Kukurekovic, Gjodet, Departamenti i Planifikimit;
Zoran Mandic, Gjeodet, Departamenti i Planifikimit.
Ljubisa Janicijevic, Bashkepunetor i Jashtem (Drejtues i Groupit Tematik), Departamenti i Planifikimit;
Milos Nicic, Zyrtar për Shërbime Publike, Departamenti i Shërbimeve Publike;
Boban Marinković, Službenik za Obrazovanje, Odeljenje za Obrazovanje;
Sonja Jovanovic, Zyrtar për Çështje Sociale, Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies;
Sonja Artinovic, Zyrtar për Zhvillim Ekonomik (Drejtues i Groupit Tematik), Depart. i Ekonomisë dhe Financave;
Sasha Zdravkovic, Zyrtar për Zhvillim Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave;
Mirjana Stankovic, Zyrtar për Auditimit të Brendshëm, Departamenti i Ekonomisë dhe Financave;
Sinisa Subaric, Zyrtar për Integrim Evropian, Departamenti i Administratës;
Aleksandar Jovic, Zyrtar për Teknologji Informative, Departamenti i Administratës;
Sladjana Maksimovic, Zyrtar për Informim, Departamenti i Administratës;
Miljan Blagic, Zyrtar për Informim, Departamenti i Administratës;
Boban Todorovic, Koordinator per Trashëgimi Kulturore;
Miloš Maksimovic, Drejtor, Spitalet Regjionale;
Manushaqe Susari, Zyrtar për Perkthim, Departamenti i Administratës.

UN-Habitat/ Programi i Mbështetjës së Planikimit Hapësinor Komunal në Kosovë

Mbështetje në Komunë:

Sadije Kelmendi, Zyrtare për Planifikim Hapësinor/ Urban.

Mbështetje e Specializuar:

Visar Salihu, Zyrtar për Planifikim Hapësinor/ Urban.

Ekipi Mbështetës:

Jillian Bywater, Zyrtare për Planifikim Hapësinor/ Urban;

Ishaku Maitumbi, Zyrtar për Planifikim Hapësinor/ Urban;

Pren Domgjoni, Zyrtar për Planifikim Hapësinor/ Urban;

Lumnije Gashi Shabani, Zyrtare për Planifikim Hapësinor/ Urban;

Rudina Qerimi, Zyrtare per Informacion dhe Planifikim Hapësinor;

Klodeta Krasniqi, Zyrtare- Juniore për Planifikim Hapësinor/ Urban;

Arijeta Himaduna, Zyrtar për Çështje Gjinore dhe Bashkëpunim me Shoqërinë Civile;

Gloriosa Hisari, Zyrtar për Çështje Ligjore;

Peter Engstrom, Këshilltar për Koordinim të Njesisë për Planifikim;

Hasse Eriksson, Këshilltar për Koordinim të Njesisë për Planifikim.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	10
1.1. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE RËNDËSIA E TIJ	10
1.2. QËLLIMI I PZHK-SË (PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL).....	10
1.3. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E PZHK-SË	11
1.4. DOKUMENTET E KONSULTUARA QË KISHIN RËNDËSI PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR	11
1.5. THEMELIMI I ADMINISTRATES LOKALE	12
1.6. STRUKTURA E ORGANEVE KOMUNALE	13
1.7. GRAÇANICA BRENDA KONTEKSTIT KOMBËTAR DHE REGIONAL	14
1.7.1. Baza historike.....	14
1.7.2. Graçanica në kontekst të Kosovës.....	15
1.7.3. Të dhënat e përgjithshme për komunën e Graçanicës	16
1.7.4. Graçanica në Zonën e Kaltër të Planit Hapësinor të Kosovës	16
1.7.4.1. Karakteristikat e Zonës së Kaltër.....	16
1.7.4.2. Vizioni i zones së kaltërt.....	17
1.7.4.3. Qëllimet e përgjithshme të zonës së kaltërt	17
1.7.4.4. Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve	17
1.7.4.5. Zonat me interes të veçantë brenda zonave të kaltërta	17
1.7.4.6. Konfliktet dhe sinergjitë e skenarëve të Zonave të Kaltërta Zhvillimore	18
1.7.4.7. Konfliktet.....	18
1.7.4.8. Sinergjitë.....	18
2. PROFILI I KOMUNËS	19
2.1. PASQYRA GJEO-KLIMATIKE DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS	19
2.1.1. Klima.....	21
2.1.2. Shfrytëzimi i Tokës	21
2.2. INFRASTRUKTURA SOCIALE, BANIMI DHE DEMOGRAFIA	24
2.2.1. Popullsia	24
2.2.2. Dendësia e popullsisë.....	25
2.2.3. Rritja e Popullsisë.....	25
2.2.4. Shkalla e Vdekshmerisë.....	26
2.2.5. Përbërja e popullsisë sipas përkatësisë etnike	26
2.2.6. Përbërja e popullsisë sipas moshës.....	26
2.2.7. Migrimet.....	26
2.2.8. Banimi.....	27
2.2.8.1. Objektet e banimit.....	27
2.2.9. Vendbanimet	28
2.2.9.1. Vendbanimet Joformale	28
2.2.10. Qendrat Kolektive	30
2.2.11. Objektet Ilegale.....	30
2.2.12. Shëndetësia	30
2.2.13. Shërbimet sociale.....	32
2.2.14. Arsimimi.....	34
2.2.15. Institucionet Kulturore	37
2.2.16. Hapësirat Publike (Sheshet dhe Memorialët)	37
2.2.17. Rekreacioni dhe Sporti.....	39
2.3. ZHVILLIMI EKONOMIK.....	40
2.3.1. Gjendja ekonomisë lokale	40
2.3.2. Industria.....	42
2.3.3. Punësimi (Sektori Privat).....	43
2.3.4. Organizatat Joqeveritare (OJQ).....	44
2.3.5. Bujqësia	44
2.3.6. Ujitja	45
2.3.7. Mbarëshkrimi i blegtorisë	45

2.3.8.	<i>Potencialet turistike</i>	46
2.4.	INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE	47
2.4.1.	<i>Transporti dhe rrugët</i>	47
2.4.2.	<i>Transporti Hekurudhor</i>	49
2.4.3.	<i>Transporti ajror</i>	49
2.4.4.	<i>Transporti publik</i>	49
2.4.5.	<i>Ujësjetësi</i>	50
2.4.6.	<i>Kanalizimi</i>	51
2.4.7.	<i>Menaxhimi i mbeturinave</i>	51
2.4.8.	<i>Rrjeti elektrik</i>	51
2.4.9.	<i>Komunikimet (telekomunikimet dhe interneti)</i>	52
2.5.	MJEDISI, RESURSET NATYROR DHE TRASHËGIMIA KULTURORE	53
2.5.1.	<i>Resurset natyrore</i>	53
2.5.2.	<i>Lumenjtë në territorin e komunës</i>	54
2.5.3.	<i>Pylltaria</i>	56
2.5.4.	<i>Situata në mjedis</i>	57
2.5.5.	<i>Ndotja</i>	57
2.5.5.1.	<i>Ndotja e ujit</i>	57
2.5.5.2.	<i>Ndotja e ajrit dhe tokës</i>	59
2.5.6.1.	<i>Deponia e hapur industriale e mbetjeve nga objekti për përpunimin e mineraleve</i>	61
2.5.7.	<i>Menaxhimi i vlerësimit të rrezikut të katastrofave (MVRK)</i>	62
2.5.8.	<i>Frekuentimi dhe zhurma në trafik</i>	63
2.5.9.	<i>Trashëgimia kulturore dhe natyrore</i>	64
2.5.10.	<i>Manastiri i Graçanicës</i>	65
2.5.11.	<i>Ulpiana</i>	66
2.5.12.	<i>Ligatina e Hencit- Zone e Vecante e Mbrojtur e Zogjeve</i>	68
2.5.13.	<i>Kishat dhe vendbanimet brenda Komunës së Graçanicës</i>	68
2.6.	VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE	71
2.6.1.	<i>Infrastruktura Sociale, Strehimi dhe Demografia</i>	71
2.6.2.	<i>Infrastruktura, Shërbimet Publike dhe Transporti</i>	71
2.6.3.	<i>Zhvillimi Ekonomik</i>	72
2.6.4.	<i>Mjedisi, Resurset Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore</i>	72
2.7.	SFIDAT E ZHVILLIMORE	73
2.7.1.	<i>Infrastruktura Sociale, Strehimi dhe Demografia</i>	73
2.7.2.	<i>Infrastruktura, Transporti dhe Shërbimet Publike</i>	73
2.7.3.	<i>Zhvillim Ekonomik</i>	73
2.7.4.	<i>Mjedisi, Resurset Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore</i>	74
2.8.	VLERËSIMI I KAPACITETEVE TË KOMUNËS PËR INVESTIME	75
3.	VIZIONI, PARIMET DHE OBJEKTIVAT	78
3.1.	VIZIONI PËR TË ARDHMEN E KOMUNËS	78
3.2.	PARIMET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM	80
3.3.	OBJEKTIVAT AFATGJATA TË ZHVILLIMIT	81
3.3.1.	<i>Infrastruktura Sociale, Strehimi dhe Demografia (A)</i>	82
3.3.2.	<i>Zhvillimi Ekonomik (B)</i>	82
3.3.3.	<i>Shërbimet Publike, Infrastruktura dhe Transporti (C)</i>	82
3.3.4.	<i>Mjedisi Jetësor, Resurset Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore (D)</i>	82
3.4.	PRIORITETET STRATEGJIKE	83
4.	KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL	85
4.1.	KARAKTERISTIKAT E SKENARIT TË ZHVILLIMIT	85
4.1.1.	<i>Skenari i zhvillimit sipas trendit</i>	85
4.1.2.	<i>Skenari i zhvillimit të koncentruar</i>	87
4.1.3.	<i>Skenari i zhvillimit të decentralizuar</i>	89
4.2.	VLERËSIMI I SKENARËVE TË ZHVILLIMIT	91
4.3.	KONCEPTI I SKENARIT TË INTEGRUAR	95

4.4.	STRUKTURA E KORNIZES ZHVILLIMORE.....	97
4.4.1.	<i>Infrastruktura Sociale, Banimi dhe Demografia.....</i>	97
4.4.1.1.	<i>Banimi dhe vendbanimet.....</i>	97
4.4.1.2.	<i>Shëndetësia.....</i>	99
4.4.1.3.	<i>Shërbimet sociale.....</i>	99
4.4.1.4.	<i>Arsimimi.....</i>	100
4.4.1.5.	<i>Kultura, Rinia, Sporti dhe Rekreacioni.....</i>	100
4.4.2.	<i>Zhvillimi Ekonomik.....</i>	101
4.4.3.	<i>Infrastruktura dhe Sherbimet Publike.....</i>	103
4.4.3.1.	<i>Transporti publik.....</i>	103
4.4.3.2.	<i>Rrjeti rrugor.....</i>	103
4.4.3.3.	<i>Furnizimi me ujë.....</i>	103
4.4.3.4.	<i>Kanalizimi.....</i>	104
4.4.4.	<i>Mbrojtja e Mjedisit.....</i>	105
4.4.4.1.	<i>Ndotja e ajrit dhe zhurma.....</i>	105
4.4.4.2.	<i>Ndotja e ujit.....</i>	105
4.4.4.3.	<i>Ndotja e tokës.....</i>	105
4.4.4.4.	<i>Mbeturinat e ngurta.....</i>	106
4.4.4.5.	<i>Zvogëlimi i rrezikut nga katastrofat.....</i>	107
4.4.5.	<i>Vleresimi Socio-Ekonomik dhe Mjedisor ne Kornizen e Propozuar.....</i>	108
4.4.6.	<i>Strategjite dhe Aktivitetet per Zbatim.....</i>	110
4.4.6.1.	<i>Infrastruktura Sociale, Banimi dhe Demografia.....</i>	110
4.4.6.2.	<i>Zhvillimi Ekonomik.....</i>	112
4.4.6.3.	<i>Infrastruktura dhe Sherbimet Publike.....</i>	114
4.4.6.4.	<i>Mjedisi, Burimet Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore.....</i>	116
4.5.	PLANI VEPRIMIT.....	119
5.	DISPOZITAT PËR ZBATIM.....	127
5.1.	UDHËZIMET PER INTERPRETIM TE PZHK GJATE HARTIMIT TE PRRU/ PHRR DHE PLANEVE TJERA.....	127
5.2.	KUSHTET QE PERCAKTOHEN NGA RREGULLORET E QEVERISE LOKALE NE LIDHJE ME ZHVILLIMIN DHE SHFRYTEZIMIN E TOKES NE KOMUNE.....	127
5.3.	KUSHTET E RREGULLAVE HAPËSINORE.....	128
5.4.	OBJKTET/ ZONAT ME RËNDËSI KOMBËTARE.....	128
5.5.	ZONA E VENDBANIMIT.....	128
5.6.	PRINCIPET UDHËHEQËSE PËR ÇAKTIMIN E AKTIVITETEVE EKONOMIKE.....	129
5.7.	ZONAT EKONOMIKE KOMUNALE- ZONAT INDUSTRIALE, TE BIZNESIT DHE TREGETARE.....	130
5.8.	PARIMET KRYESORE PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE.....	130
5.9.	PARIMET UDHËZUESE PËR PËRCAKTIMIN E SHTIGJEVE DHE KORRIDOREVE DHE SISTEMEVE TË TJERA TË INFRASTRUKTURËS.....	131
5.10.	MASAT E MBROJTJES SË PEIZAZHIT, VLERAVE NATYRORE DHE TRASHËGIMISË KULTURORE.....	133
5.11.	MASAT PËR PARANDALIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.....	133
5.12.	MASAT PËR PARANDALIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE SOCIALE.....	134
5.13.	MASAT PËR REALIZIMIN E PLANEVE.....	135
5.14.	DISPOZITAT PER BASHKEPUNIM.....	136
5.15.	DISPOZITAT PER RENDITJEN KRONOLOGJIKE TE FAZAVE TE ZBATIMIT.....	136
5.16.	ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIME TË MËTEJSHME.....	136
5.17.	DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....	137
6.	ANEKS- HARTAT E PZHK-SE.....	138

Lista e Shkurtesave

ZEQ- Zona ekonomike qendër
KGJO- Klinika për gjinekologji dhe obstetri
QMS- Qendra për mirëqenie sociale
EIA – Vlerësimi i ndikimit në mjedis
EULUP- Projekt i financuar nga BE-ja "Mbështetje e mëtutjeshme për shfrytëzimin e tokës "
PHK- Plani Hapësinorë i Kosovës
ZHEK- Zhvillimi Ekonomik i Kosovës
TZHEK- Trekëndëshi i zhvillimit ekonomik të Kosovës
KEK- Korporata Energjetike e Kosovës
AKMM- Agjencia Kosovare për Mbrojtje të Mjedisit
ZHEL- Zhvillimi Ekonomik Lokal
MBPZHR – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MKK – Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS – Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport
PZHK- Plani Zhvillimor Komunal
MEZH – Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MF – Ministria e Financave
MI – Ministria e Infrastrukturës
MAPL- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MPMS- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MAP – Ministria e Administratës Publike
EKP- Ekipi komunal për planifikim
OJQ- Organizatë jo qeveritare
ZKMQM- Zyra e Kryeministrit- Zyra për çështje të komuniteteve
OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OP- Objektet parashkollore
SHF- Shkolla fillore
RTV- Radio dhe Televizioni
VSM- Vlerësimi Strategjik Mjedisor
VNS- Vlerësimi i ndikimit social
KOS- Kisha Ortodokse Serbe
SHM- Shkolla e Mesme
UNESCO- Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencë e Kulturën
UNHCR- Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

1. HYRJE

1.1. Planifikimi Hapësinor dhe Rëndësia e tij

Struktura e planeve hapësinore të Kosovës është e përcaktuar me Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr. 2003/14 dhe Ligjin Nr. 03/L-106 për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor udhëzimet administrative përkatëse. Plani hapësinor është përcaktuar si një plan për rregullimin dhe shfrytëzimin e territoreve komunale brenda Kosovës.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka hartuar Planin Hapësinor të Kosovës në bazë të të cilit të gjitha komunat do të hartojnë Planet Zhvillimore Komunale.

Qasjet e reja për planifikimin hapësinor dhe strategjik që përfshijë më shumë se sa rregullore të thjeshta mbi shfrytëzimin e tokës, pasojë e të cilave është më shumë strategji e integruar për zhvillimin e tokës si dhe një vizion i qartë në përputhje me të gjitha grupet e integruara që të veprojnë në drejtim të përmbushjes së qëllimeve të identifikuar gjatë procesit të vizionimit.

Ideja themelore e proceseve të zhvillimit është rregullimi i situatës ekzistuese dhe harmonizimi me aktivitetet e planifikuara.

1.2. Qëllimi i PZHK-së (Plani Zhvillimor Komunal)

Plani Zhvillimor Komunal mbulon tërë territorin e komunës, duke përfshirë zonat urbane dhe rurale. Ky plan përcakton caqet afatgjata në lidhje me zhvillimin hapësinor, social dhe ekonomik.

Qëllimi i Planit Zhvillimor Komunal është që të ofrojë vizion dhe synime të qarta për zhvillimin e ardhshëm hapësinor komunal dhe të përcaktojë programet, politikat e zhvillimit dhe aktivitetet për realizimin e qëllimeve të identifikuar si dhe të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm. Mënyra se si të e zhvillojmë banimin, mënyra e duhur si të ruajmë atë, por edhe zhvillimi i pasurisë natyrore dhe vlerave të trashëgimisë kulturore në favor të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale; si të lehtësohet lëvizja e banorëve dhe si të sigurohet qasje më e lehtë për vizitorët - janë vetëm disa nga çështjet ku PZHK-ja duhet të ofrojë përgjigje.

Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Graçanicës i ofron komunes strategji për zhvillim urban dhe rural dhe këshilla të mëtejshme mbi çështjet themelore të planifikimit. Pasi ajo të miratohet nga Kuvendi Komunal dhe të jepet pëlqimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Plani Zhvillimor Komunal do të ketë rol kyç në tërheqjen dhe orientimin e investimeve private dhe komerciale. Për më tepër, do të shërbejë si një bazë për aktivitetet e ardhshme të planifikimit.

Të gjitha ndryshimet brenda zhvillimit urban janë pjesë e një konteksti më të gjerë. Komuna ishte përherë nën ndikimin e proceseve të ndryshme ekonomike, sociale dhe politike që ndodhin në shoqëri. Qëllimi i rëndësishëm i procesit të planifikimit është zhvillimi i komuniteteve të qëndrueshme dhe të balancuara, ku të gjitha pjesët e shoqërisë, pa dallim, pasurinë e tyre, profesionin apo origjinën, e konsiderojnë veten të përfshirë. Prandaj, është jetike që planifikuesit dhe vendimmarrësit të kenë një pasqyrë të qartë të kontekstit atëherë kur planifikojnë zhvillimin e ardhshëm komunal.

1.3. Baza Ligjore për Hartimin e PZHK-së

Sipas Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor Nr. 2003/14 dhe Ligji Nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 2003/14, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e mbajtur më 23.06.2010, ka marr vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të komunës së Graçanicës.

Ligjet në vijim janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të PZHK-së:

- Ligji Nr. 2003/14 për Planifikim Hapësinorë;
- Ligji Nr. 03/L-106 për amendamentimin e ligji për Planifikim Hapësinorë Nr. 2003/14;
- Ligji Nr. 02/L-88 për trashëgimin kulturore;
- Ligji Nr. 04/L-110 mbi Ndërtimin;
- Ligji Nr. 2003/11 për Rrugët
- Ligji Nr. 03/L-120 për amendamentimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/11 për rrugët;
- Ligji për transportin rrugor Nr. 04/L-179;
- Ligji mbi tokat bujqësore Nr. 02/L-26
- Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230;
- Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025;
- Ligji për mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233;
- Ligji Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Rreziqet natyrore dhe rreziqet e tjera;
- Ligji për zonat ekonomike Nr. 04/L-159;
- Ligji mbi mbeturinat Nr. 04/L-060;
- Ligji mbi Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- Ligji mbi Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural Nr. 03/L-098
- Ligji Nr. 04/L-090 për amendamentimin plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;
- Ligji për Kufijtë Administrative Nr. 03/L-041;
- Ligji Zonat e Veçanta të Mbrojtura Nr. 03/L-039;
- Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës Nr.03/L-072;
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040;
- Vendimi për Mbrojtjen e Zonës Arkeologjike në Ulpianë;
- Vendimet relevante dhe rregulloret e Komunës së Graçanicës.

1.4. Dokumentet e Konsultuara që Kishin Rëndësi për Planifikimin Hapësinor

Deri në fund të vitit 2009, Komuna e Graçanicës dhe vendbanimet e saj ishin nën komnatat e; Prishtinës Lipjanit dhe Fushë Kosovës. Prandaj, administrata komunale nuk ishte në proces të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal. Përveç kësaj, Komuna e Prishtinës ka dështuar që të hartoj Planin Zhvillimor Komunal, që do të shërbente si bazë për udhëheqjen e zhvillimeve të ardhshme.

Dokumentet në vijim janë përdorur si bazë gjatë hartimit të PZHK-së së Graçanicës:

- Plani Hapësinor i Kosovës (2010-2020);
- Plani i Marti Ahtisaarit;
- Plani i veprimit i Komunës së Graçanicës për zhvillimin e infrastrukturës;
- Agjenda e Gjellbër e Komunës së Graçanicës;
- Plani Zhvillimor Komunal i Lipjanit;
- Dokumenti i Integruar i Vizionimit (2011).

Për më tepër, Ekipi Komunal i Planifikimit gjatë hartimit të PZHK-së ishte e angazhuar në konsultimin e draftit të Planit Zhvillimor Komunal të Prishtinës dhe Draftin e Planit Zhvillimor Komunal të Lipjanit, gjatë procesit të shqyrtimit të tyre publik.

1.5. Themelimi i administrates lokale


Komuna e Graçanicës është themeluar në pajtim me planin e Marti Ahtisaarit nëpërmjet përfshirjes së pjesëve të komunave të Prishtinës, Lipjanit dhe Fushë Kosovës.

Komuna e Graçanicës përfshin vendbanimet dhe njësitë kadastrale si në vijim:

- nga komuna e Fushë Kosovës: Batushë dhe Uglar;
- nga komuna e Lipjanit: Gushterice e Epërme, Dobratin, Gushterice e Poshtme, Lepina, Livagje, Radeve, Skulaneva dhe Suvi Do,
- nga komuna e Prishtinës: Graçanica, Badoci i Ri, një pjesë nga Badoci i Vjetër, Llapnasella, Sushica, Preoci, Kishnica dhe një pjesë e Çagllavicës.

Komuna e Graçanicës është themeluar në pajtim me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave të miratuar më 20 shkurt 2008. Pasuar nga zgjedhjet e 15 nëntorit të vitit 2009, Komuna e Graçanicës është themeluar zyrtarisht më 29 dhjetor 2009.

1.6. Struktura e Organeve Komunale



1.7. Graçanica brenda kontekstit kombëtar dhe regional

1.7.1. Baza historike

Gjatë një periudhe të lashtë historike, Kosova është e populluar me Ilir, nga të cilët më me ndikim ishte fisi Dardanë, që ka formuar Mbretërinë e Dardanisë 1000 PK. Përleshjet më të shpeshta të Dardanëve kundër maqedonasve dhe romakëve u zhvilluan në shekullin e tretë dhe të dytë. Dardanët sunduan deri në shekullin e parë, kur ata u pushtuan nga romakët.

Vendi më i vlefshëm arkeologjik i periudhës së lashtë është qyteti romak i Ulpianës afër Graçanicës së sotme. Supozimet janë se qyteti Ulpiana është formuar në mes të shekullit të parë dhe të dytë gjatë perandorit romak Trajanit (Marcus Nerva Ulpius Traianus). Ulpiana ishte një qytet nën autoritet epror romak, por me vetë-qeverisjes kushtetutë dhe ligje. Qytetarëve të saj u ishte dhënë e drejta romake civile, duke përfshirë edhe të drejtën për të votuar. Nuk ka asnjë dyshim se Ulpiana, si një qytet i vetë-mbajtur brenda Perandorisë Romake, e zhvilluar si qendër ekonomike dhe kulturore e kohës, për shkak të vendndodhjes së favorshme gjeografike, në afërsi të depozitave të mëdha të zinkut, plumbit dhe metaleve të çmuara. Ulpiana arriti kulmin e saj gjatë shekullit të tretë për shkak të bukurisë së saj dhe me të drejtë u quajt URBS SPLENDISSIMA- Qytet i mrekullueshëm. Ulpiana është shkatërruar nga barbarët në vitin 471, Ulpiana shkatërrimin e plotë e përjetoi në vitin 518 për shkak të një tërmeti të fortë. Qyteti u rindërtua më vonë kah mesi i shekullit të gjashtë nga perandori bizantin Justinian, pas të cilit qyteti u quajt Justiniana sekunda.

Për herë të parë Graçanica është përmendur si Grazanica në vitin 1303, në një letër të Papës Benedikti IX dërguar te Kryepeshkopi Marino, në lidhje me famullinë katolike në Janjevë dhe koloninë e minierave në Kishnicë në periferi të Graçanicës. Në këtë letër ajo ishte përmendur si famulli katolike e Grazanizas. Është e qartë se emri i kësaj famullie erdhi nga emri i fshatit të Graçanicës në afërsi të të cilit kanë ekzistuar kolonitë saksone dhe minatorët në Janjevë. Deri në shekullin e IX-të, Kosova ka qenë zonë kufitare bizantine. Gjatë kësaj periudhe, Graçanica ka qenë pjesë e Serbisë mesjetare, e ndërtuar në afërsi të Ulpianës.

Nën emrin e saj aktual, për herë të parë Graçanica u përmend nga Mbretit Millutin në vitin 1321 në Kartën e Graçanicës, të lëshuar me rastin e ndërtimit të Manastirit. Manastiri ishte qendra e spiritualitetit gjatë asaj kohe deri në rënien e Serbisë nën Turqi. Për shkak të luftës austrojako-turke, rezistencës dhe zgjimit të popullit të Turqisë, serbët dhe shqiptarët e bashkuan ushtrinë në luftë kundër turqve. Për shkak të disfatës së ushtrisë austriake dhe nga frika e hakmarrjes nga turqit, në vitin 1690 ndodhi një migrimi i madh i serbëve, cka ka ndikuar që vendbanimi i Graçanicës të braktiset krejtësisht.

Graçanica është çlirua nga turqit gjatë luftërave serbe-turke në vitin 1878, kur ushtria serbe arriti në periferi të Prishtinës, por për shkak të vendimit të Kongresit të Berlinit, Graçanica mbeti jashtë shtetit të Serbisë, çfarë e shkaktoi që banorët të shumtë, jo vetëm pjesëmarrës të luftës, u desh të ikin në Serbi. Pas luftërave në Ballkan dhe çlirimit nga Turqia, në vitin 1918 ajo u bë pjesë e Serbisë, më saktësisht Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, përkatësisht Mbretëria e Jugosllavisë dhe më pas në vitin 1945 pjesë e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë.

1.7.2. Graçanica në kontekst të Kosovës

Komuna e Graçanicës është e vendosur në pjesën qendrore të Kosovës, përkatësisht në jug të kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës. Komuna është e ndarë në 16 zona kadastrale. Komuna ka një karakter rural me tokë bujqësore të kualitetit të lartë. Figura 1, tregon vendndodhjen e Komunës së Graçanicës brenda Kosovës dhe shteteve me të cilat ajo kufizohet.

Kosova është e vendosur në pjesën qendrore të Evropës Jug-Lindore me sipërfaqe prej 10,907.00 km². Kosova kufizohet me Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi. Territori i saj përfshin lugina të gjera deri tek malet e larta. Kosova është e rrethuar nga vargmalet: Malet e Sharrit, Pashtrikut, Bjeshkëve të Nemuna, Mognës dhe Albanikut, me lartësinë më të lartë prej 2,656 metra.



Figura 1. Pozicioni i Komunës së Graçanicës

Lumenjtë kanë formuar lugina të thella, duke tejkaluar pengesat natyrore, duke formuar kështu lidhjet natyrore me zonat përreth. Në mes të Kosovës gjenden dy fushat kryesore, Fusha e Kosovës dhe Rrafshi i Dukagjinit, të cilat janë të ndara nga njëra-tjetra nga rrafshnalta e Drenicës.

Kryeqyteti i Kosovës Prishtina ndodhet në fushën e Kosovës. Ajo është qendra administrative dhe ekonomike e Kosovës. Densiteti i lartë i industrisë së rëndë, për shkak të depozitave të qymyrit në kuadër të rajonit të Prishtinës, shkakton ndotje të rëndë të mjedisit në këtë rajon. Autostrada lidhë Prishtinën me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Serbinë. Rrjeti hekurudhor është aktualisht në gjendje të keqe.

1.7.3. Të dhënat e përgjithshme për komunën e Graçanicës

Territori i komunës mbulon një sipërfaqe prej 122,25 km². Per shkak te situates se ndieshme politike ne komune, nuk ka ekzistuar vullnet i shumices se popullsisë komunale per pjesemarrje ne regjistrimin e popullsisë, te realizuar me 2011. Te dhenat e prezentuara me poshte jane marruar nga anketea e ekonomive familjare, e realizuar nga Komuna e Graçanicës.

Komuna e Graçanicës ka 25,000 banorë me strukturë shumetnike, nga të cilat 85.7% serbë, 3.7% shqiptarë dhe 10,6% romë, ashkali, egjiptas dhe të tjerët.

Me vendndodhjen e saj të përshtatshëm, d.m.th afër kryeqytetit Prishtinës, ofron mundësi të mëdha për zhvillimin e Graçanicës në tregti komerciale dhe banesore të begatë, multi- kulturore (Burimi: Plani i Veprimit i Graçanicës 2010).

Me themelimin e komunës së re, banorët që banojnë në këtë zonë janë të pajisur me mundësi të mëdha për shërbime më të mira dhe përmirësimin e standardit të jetesës.

1.7.4. Graçanica në Zonën e Kaltër të Planit Hapësinor të Kosovës

Sipas planit hapësinor të aprovuar të Kosovës, Komuna e Graçanicës është e vendosur në zonën e caktuar të kaltër të zhvillimit ekonomik.




Figura 2. Strategjia e Zhvillimit Hapësinor- Zona e Kaltër

1.7.4.1. Karakteristikat e Zonës së Kaltër

Kjo zonë paraqet pjesën veriperëndimore të Kosovës që përfshinë: Prishtinën, Obiliqin, Podujevën, Fushë Kosovën, Lipjanin, Glllogovcin dhe Shtimen , me Prishtinën në qendër. Kjo zonë e paraqitur me ngjyrë të kaltër e ka dendësinë e popullatës që është karakteristike për qendrat urbane, dhe me zona rurale të zhvilluara, me kualitet të lartë të tokës bujqësore, resurse nëntokësore (lingnit, nikel, plumb, zink, ari), vende të rëndësishme arkeologjike dhe kulturore, zona të lira të gjelbra, përderisa aktivitetet ekonomike karakterizohen me industri, tregti dhe shërbime. Kur kemi të bëjmë me çështjet administrative, eksitojnë autoritetet ndërkombëtare dhe lokale, godinat akademike, arsimore dhe shkencore.

1.7.4.2. Vizioni i zones së kaltërt

Zonë e begatë dhe gjallëruese, ku qytetet aspirojnë zhvillim urban modern dhe të vazhdueshëm në mënyrë planifikuese dhe garuese, përderisa në të njëjtën kohë ato janë të bashkuara dhe bashkëpunuese për të garuar me qytetet fqinje në një regjion më të gjerë, tërheqëse për të jetuar dhe punuar. Zona e kaltër me Prishtinën në qendër, si një metropol, kryeqytet kombëtar, vendndodhje e zyrave qeveritare dhe diplomacive të huaja, qasje të mirë nga qytetet tjera të Kosovës dhe qytetet përgjatë kufirit me rrjet të zhvilluar infrastrukturor (rrugë, hekurudha, trafik ajror, pajisje energjetike), si dhe objekte administrative dhe institucionale. Rrjeti i këtyre pajisjeve do të krijojë parakushte dhe mjedis adekuat për aktivitete ekonomike, industriale, komerciale, dhe të shërbimeve. Në mes të zonës së kaltër është paraparë një Trekëndësh i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës (TZhEK), i ashtuquajtur i kurriz i zhvillimit ekonomik me interes kombëtar, burim i të ardhurave për ekonominë e Kosovës, si dhe vend i mundshëm për investitor nga kompanitë shumëkombëshe. Arsyet për një përcaktim të tillë të zhvillimit të ardhshëm hapësinor të TZhEK-ut janë: 1) afërsia me Prishtinën si qendër më e madhe administrative, arsimore-shkencore dhe e shërbimeve në Kosovë, si një vend i mundshëm tërheqës për investitorët lokal dhe të huaj, por gjithashtu edhe për turizëm të kongreseve; 2) korridoret kryesore të infrastrukturës rrugore, hekurudhore, ajrore, të telekomunikacionit dhe energjisë; 3) Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës si një pikë strategjike e ndërlidhjes me botën në aspektin e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, tani më është vërtetuar si një qendër e rëndësishme për zhvillim ekonomik; 4) afërsia me korridoret regionale.

1.7.4.3. Qëllimet e pergjitheshme të zonës së kaltërt

- Zhvillimi i rrjetit të qytetit, qasje të lehtë e atraktive për jetë dhe punë;
- Mbështetje e ZHEL-it për ZHEK - përdorimi i avantazheve konkurruese;
- Zhvillimi i lidhjeve efikase urbane, ndër-urbane me 5 zona të tjera regionale dhe më gjerë, nëpërmjet zhvillimit të rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore, TI-së)
- Promovimi i lokacioneve të TZhEK për grupimin e aktiviteteve nga aspekti hapësinor, investimet e huaja dhe kompanive multinacionale,,
- Mbështetje për aktivitetet e H dhe ZH përkritazi me ekonominë e njohurive, me mbështetjen e kapaciteteve organizative,
- Promovimi i Prishtinës si një qendër e aftësive të rajonit më të gjerë të Evropës Jug-Lindore.
- Zhvillimi i aktiviteteve administrative, arsimore dhe tregtare, objekteve të energjisë, industrisë së përpunimit të ushqimit dhe turizmit.


1.7.4.4. Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve

Qendrat më të vogla, përfshirë edhe komunën e Graçanicës, përfaqësojnë grupin e qendrave që në zhvillimet e ardhshme hapësinore duhet të luajë rol aktiv:

- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve duke i bërë ato më të efektshme;
- Forcimi i lidhjeve me fshatrat përreth, dhe
- Përpjekjet për të krijuar një zonë që funksionon si një tërësi bazuar në programet specifike të zhvillimit.

1.7.4.5. Zonat me interes të veçantë brenda zonave të kaltërta

Zonat e veçanta të mbrojtura janë kategori e veçantë hapësinore e përshkruar hollësisht në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura Nr.03 /L-039. Ky ligj është pjesë integrale e pakos së Ahtisaarit miratuar nga Kuvendi i Kosovës në korrik të vitit 2008. Sipas këtij ligji, Territori i Kosovës përfshin 45 zona të tilla të cilat në masë të madhe i përkasin trashëgimisë së kulturës ortodokse.



Kufijtë e këtyre zonave në hartë përfshijnë:

1. Manastirin e Graçanicës.

Zonat e ndotura mjedisore që duhet të rehabilitohen dhe të përdoren për qëllime të tjera janë:


- Deponitë e mbeturinave industriale në Kishnicë;
- Lokacionet e deponive të mbyllura komunale.

Zonat me interes të veçantë në Kosovë

Ekzistojnë zona brenda kësaj kategorie ku duhet të ofrohet një regjim i vendosur zhvillimor:

- Investimet kapitale në nivel qendror;
- Zona e veprimit të koordinuar (Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës- TZHEK);
- Aeroporti i Prishtinës;
- Zonat tjera të përcaktuara nga Qeveria qendrore.

1.7.4.6. Konfliktet dhe sinergjitë e skenarëve të Zonave të Kaltërta Zhvillimore



1.7.4.7. Konfliktet

Zhvillimi i TZHEK-së është në konflikt me mbrojtjen e tokës bujqësore, mjedisit dhe banimit.

1.7.4.8. Sinergjitë

Zhvillimi i TZHEK-së është i favorshëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës, duke rritur atraktivitetin e Prishtinës, investimet e huaja/tërheqjen e kompanive ndërkombëtare, zhvillimin dhe zbatimin e drejtpërdrejtë të hulumtimeve dhe zhvillimit dhe orientimin e investimeve kapitale për infrastrukturën fizike.

2. PROFILI I KOMUNËS

2.1. Pasqyra gjeo-klimatike dhe shfrytëzimi i tokës

Komuna e Graçanicës është e vendosur në pjesën qendrore të Kosovës, me kufijtë e saj në veri dhe lindje me komunën e Prishtinës, në jug me Komunën e Lipjanit dhe po ashtu në jug me komunën e Fushë Kosovës.



Qendra administrative e komunës është vendbanimi Graçanica, që ndodhet tetë kilometra në jug-lindje nga Prishtina, në skajin lindor të basenit të Kosovës, ku fillon ngritja e lehtë e shpateve Veletin me lartësi mbidetare prej 874 m dhe shpatet e rrëpira të Strazevcit me lartësi mbidetare prej 796 m, si edhe Glasnoviku. Vendbanimi është i vendosur në afërsi të lumit Graçanka, furnizues i lumit Sitnica, në kuadër të luginës së madhe poshtë Liqenit të Badovcit dhe deponisë së mbeturinave industriale të Kishnicës-Novobërdës, objekteve të minierave të plumbit dhe zinkut. Fshati ka një lartësi mbidetare prej 570m dhe është i vendosur në pjesën e basenit tektonik si dhe shtrihet përgjatë çarjes që nga mesi-terciar. Veletini dhe Maja e Mprehtë janë maja të shuara vullkanike të pasura me gurë mineral.




Figura 3- Pozita gjeografike në raport me komnatat fqinje

Rruga rajonale që kalon përmes vendbanimit, lidh Graçanicën me Serbinë jug-lindore dhe rrugët që shpijnë drejt Anamoravës perëndimore që lidhin Graçanicën me Detin Adriatik dhe Shqipërinë. Lumi Graçanka i takon sistemit të lumit Sitnicë. Pranë fshatit gjendet Liqeni i Badovcit. Diga në lum u ndërtua në periudhën 1963-1966. Ky liqen siguron ujë të pijshëm për një numër të vendbanimeve në Kosovën qendrore, duke përfshirë Prishtinën, Graçanicën dhe vendbanimet përreth.

2.1.1. Klima

Klima në Kosovë është kryesisht klimë kontinentale, që karakterizohet nga vera të ngrohta dhe dimra të ftohtë, me ndikime të klimës së Mesdheut dhe të Alpeve (temperatura mesatare sillet nga plus 30 ° C gjatë verës deri në minus -10 ° C gjatë dimrit). Gjithashtu, në varësi të diferencave në lartësinë mbidetare, ekzistojnë disa variacione të temperaturave dhe reshjeve.


Dhjetori dhe janari janë muajt më të ftohtë dhe korriku e gushti janë më të ngrohtë. Volumi maksimal i reshjeve të shiut është në muajt tetor dhe dhjetor. Në periudhën mes nëntorit dhe marsit, dëbora mund të priten në të gjithë Kosovën, madje edhe në zonat fushore. Reshje më të mëdha bore mund të priten në zonat malore. Dëbora në luginë në përgjithësi arrin 10 deri 30 cm. Reshjet e bores janë gjithashtu të mundshme në periudhën deri në fund të prillit.

Bazuar në karakteristikat klimatike, Kosova mund të ndahet në tre zona klimatike: Fusha e Kosovës, Rrafshi i Dukagjin si dhe malet e larta dhe pyjet. Zona klimatike e Fushës së Kosovës, duke përfshirë luginën e lumit Ibër, është nën ndikimin e masave ajrore kontinentale. Për këtë arsye, kjo zonë është e karakterizuar me dimra të ftohtë me temperatura mesatare më të ulëta se minus -10 ° C, ndonjëherë duke arritur në minus -26°C. Vera është e ngrohtë me temperaturë mesatare prej 23 ° C dhe maksimumi nganjëherë arrin në 40 ° C. Është karakteristike se përveç temperaturave të larta të përditshme gjatë verës, netët janë shumë të ftohta. Kjo zonë është e karakterizuar nga një klimë e thatë me reshje totale vjetore shiu rreth 600 mm për m².

2.1.2. Shfrytëzimi i Tokës

Nr.	Njësi	Ha	Km ²	%
1	Toka bujqësore	9519,64	95,196	76.93
2	Livadhe	178,11	1,7811	15.1
3	Pyje	389,79	3,8979	29.69
4	Liqen	41,44	0,4144	0.31
5	Deponi industriale	48,35	0,4835	0.36
6	Basene peshku	69,82	0,6982	0.53
7	Pemishte	34,25	0,3425	0.26
8	Pjesa urbane me infrastrukturë	1828,6	18,286	17.1
9	Totali	12107	121,0996	

Tabela 1- Siperfaqja e teresishme e tokes



CZ Gracanica Municip.	Municipal		Social	
	m ²	%	m ²	%
CZ Sušica	94097	0.95%	1252442	12.61%
CZ L.Selo	427061	3.82%	2733765	24.45%
CZ Batuse	164145	3.60%	100629	2.21%
CZ Livađe	112579	1.09%	5490	0.05%
CZ Lepina	42144	0.85%	303188	6.13%
CZ Suvi Do	266171	2.18%	1369376	11.24%
CZ Preoce	195473	2.50%	913581	11.67%
CZ Radevo	82083	2.37%	858319	24.80%
CZ Skulanevo	142911	2.39%	534489	8.93%
CZ Ugljare	140396	2.14%	220034	3.35%
CZ Dobrotin	54738	0.69%	881487	11.04%
CZ G.Gušterica	811879	12.78%	110918	1.75%
CZ D.Gušterica	1361287	12.01%	577684	5.10%
CZ Gračanica	3275542	24.82%	749083	5.68%
Total	7170506	5.87%	10610485	8.68%

Tabela 2- Siperfaqja e tokes komunale dhe shoqerore

Nga 7170506 m² të tokës komunale, 1.595.591 m² tashmë është në shfrytëzim. Zona e pashfrytëzuar është 5574915 m².




Figura 4- Klasifikimi i përshtatshmërisë së tokës bujqësore (Burimi: EULUP)

Nga harta mund të shihet se shumica e tokës bujqësore është e kategorisë I-IV e cila është e mbrojtur me Ligjin mbi Tokën Bujqësore.

2.2. Infrastruktura Sociale, Banimi dhe Demografia

2.2.1. Popullësia

Bazuar në të dhënat e siguruar nga Ministria e Financave dhe OSBE-ja, në vitin 2008 ishin 18.642 banorë, dhe në bazë të vlerësimeve të Komunës së Graçanicës nga viti 2011, ky numër ishte 25,000. Rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovë të vitit 2011 nuk mund të merren si autentike meqë regjistrimi u realizua vetëm pjesërisht (është vlerësuar se rreth 50% e popullsisë është përfshirë në regjistrim - Burimi: Komisioni Komunal i Regjistrimit). Për shkak të dallimeve shumë të mëdha në vlerësime, EPK është udhëhequr me një vlerë mesatare 22,000 banorë.


Brenda territorit të Komunës së Graçanicës gjenden rreth 4.500 ekonomi familjare. (Burimi: Përfaqësuesit e fshatrave).

Tabela 3- Popullsia, Ekonomitë familjare në vendbanime dhe organizimi territorial i Graçanicës deri në vitin 2008 (Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Nr.	Vendi	Popullata						Ekonomitë familjare							
		1948	1953	1961	1971	1981	1991	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2008	
1	Gracanica	1,087	1,240	1,891	3,478	4,537	4,739	160	208	329	672	905	930	915	
2	Badovac	351	419	977	280	302	413	56	79	315	54	56	78	3	
3	Kishnica	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	119	
4	Llapnasella	852	932	1043	1072	1209	1383	135	144	172	208	240	271	343	
4	Preoci	428	471	520	585	661	755	56	65	81	107	124	140	168	
5	Cagllavica	669	741	789	866	1,104	1,205	83	95	122	156	208	222	571	
6	Sushica	575	643	757	718	746	863	74	89	98	116	130	145	160	
7	Uglari	595	682	748	763	949	1,107	80	91	118	147	191	218	353	
8	Batusha	373	409	419	458	489	542	50	57	61	85	88	99	41	
9	Dobrotin	858	931	958	902	1,004	1,111	133	146	152	170	194	212	257	
10	Gushterica e E	391	451	479	495	537	604	59	64	80	86	101	109	133	
11	Gushterica e P	974	1,097	1,187	1,158	1,210	1,269	154	162	190	214	245	245	280	
12	Lepina	343	413	453	425	455	498	52	68	75	73	76	84	83	
13	Livdja	777	863	914	704	626	618	121	127	142	126	129	118	159	
14	Radevo	254	282	322	260	272	272	40	46	54	49	57	174	52	
15	Skulaneva	462	525	515	440	425	361	64	75	80	79	74	64	73	
16	Suvido	725	679	626	589	638	641	124	116	130	129	144	143	176	
	TOTAL	9,714	10,778	12,598	13,193	15,164	16,381	1441	1632	2199	2471	2962	3252	3886	

Rezultatet historike dhe neglizhimi i përhershëm i zhvillimit ekonomik të rajonit ka çuar në migrimet e vazhdueshme të popullsisë së këtyre fshatrave në qendrat e afërta në rajon. Mungesa e institucioneve, shkollave të mesme, cilësia e dobët e shërbimeve sociale në përgjithësi ka pasur ndikim në mos-rritjen ose në uljen e numrit të popullsisë në fshatrat si Lepinë, Radevë, Skulanevë, Suvi Do dhe Livade. Zhvillimi i minierës në afërsi të fshatit Kishnicë ka çuar në mundësi më të mëdha për punësim dhe në këtë mënyrë edhe të vendosjes në vendbanimin e Graçanicës. Për shkak të shpërbërjes së RSFJ, sanksioneve në vitet nëntëdhjeta, puna në minierë ishte zhvilluar, por në një shkallë më të ulët.

2.2.2. Dendësia e popullsisë



2.2.3. Rritja e Popullsisë

Sipas të dhënave të ofruara nga Drejtoria e shëndetësisë, p.sh. KGjO¹, 372 kanë lindure në komunën e Graçanicës në vitin 2010, ndërsa ky numër ishte 472 në vitin 2011. Bazuar në të dhënat e ofruara nga regjistri i lindjeve (libri amzës), në vitin 2011 janë regjistruar 437 të sapolindur, ndërsa ky numër ishte 394 në vitin 2012. Numri i vdekjeve në vitin 2009 ishte 176, në vitin 2011 ishte 177, dhe në vitin 2012 ky numër ishte 177.

Këto të dhëna tregojnë se numri i banorëve është rritur për 195 persona në vitin 2010, ndërsa në vitin 2011 ky numër ishte 295, dhe në vitin 2012 kjo u rrit për 217. Në mesatare, rritja vjetore e popullsisë ishte 236 banorë, çka në proporcion me numrin e vlerësuar prej 25.000 banorësh jep rritje vjetore natyrale prej 0.94%. Në një periudhë 15-vjeçare, pritet shtimi natyror popullsisë deri në 28783 banor.

$$P = 25000 (1 + 0.094)^{15}$$

$$P=28783$$

¹ Klinika e gjinekologjisë dhe obstetrisë, Graçanicë

2.2.4. Shkalla e Vdekshmerise

Vendbanimi	2011		2009		2012	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Graçanica, Badovaci, Sushica	34	0.14%	37	0.15%	27	0.11%
Çagllavica, Preoci, Lapnasella	73	0.29%	74	0.30%	88	0.35%
Gushterica, e E dhe P, Livadja, Lepina, SuviDo, Radeva,	44	0.18%	40	0.16%	42	0.17%
Batuse, Ugljare	26	0.10%	25	0.10%	20	0.08%
Total	177	0.71%	176	0.70%	177	0.71%

2.2.5. Përbërja e popullsisë sipas përkatësisë etnike

Komuna e Graçanicës ka strukturë shumetnike të popullatës të përbërë nga serbët 85,7%, shqiptarët 3.7% dhe romët, ashkallit, egjiptianët dhe të tjerët 10.6%.

2.2.6. Përbërja e popullsisë sipas moshës

Sipas regjistrimit të popullsisë së Kosovës të vitit 2011, në të cilin morën pjesë rreth 50% të popullatës së komunës, popullata e re e moshës 20-29 paraqet një proporcion të lartë prej 17.2% nga popullsia totale e regjistruar në komunën e Graçanicës. (Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës) Përfshinë të dhëna për të gjitha moshat e tjera).

2.2.7. Migrimet

Lëvizshmëria e popullsisë është karakteristikë e shoqërisë njerëzore që nga fillimi i saj e deri në kohën e tanishme. Gjithashtu, në këtë zonë ekzistojnë të ashtuquajturat migrimet të detyruara, të cilat janë si rezultat i trazirave të mëdha sociale- politike, e mbi të gjitha rezultat i konflikteve të luftës. Zyra e UNHCR-it në Prishtinë nuk ka asnjë informacion zyrtar lidhur me numrin e personave të zhvendosur nga territori i Komunës së Graçanicës. Sipas vlerësimeve të UNHCR-it nga viti 2001, deri në korrik të vitit 2011, 392 familje me 1,381 anëtarë të familjes u kthyen në Komunën e Graçanicës, me përbërjen e mëposhtme:

- Serb: 331 familje me 1,095 anëtarë të familjes;
- Romë: 51 familje me 231 anëtarë të familjes;
- Ashkali: 9 familje me 50 anëtarë të familjes;
- Malazezë: 1 familja me 5 anëtarë të familjes.

Njëkohësisht, ekziston migrimi dhe proceset e migracionit në këtë zonë. Gjegjësisht, ka njerëz që nuk duan të largohen nga kjo zonë por më parë do të kërkojnë një jete më të mirë në Graçanicë dhe në kë mënyrë ata zhvendosen nga vendbanimi i tyre në Graçanicë, si një qendër kryesore administrative, arsimore, shëndetësore dhe kulturore, jo vetëm serbe, por edhe të etnive tjera.

Nuk ka asnjë informacion të saktë mbi numrin e atyre që janë larguar jashtë vendit. Shumë emigrantë në kërkim të një jete më të mirë u larguan drejt vendeve skandinave, si dhe në drejtim të Evropës perëndimore. Numri i përgjithshëm i familjeve të riatdhesuara të regjistruara në zyrën komunale për komunitete dhe kthim që nga themelimi i komunës së Graçanicës është 104, i përbërë nga:

- 28 Burra;
- 23 Gra;
- 53 Fëmijë.

Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete (ZKKK) që nga themelimi i saj, nga muaji maj deri në nëntor 2012 i regjistroi 70 persona të riatdhesuar. Nga ky numër, 48 persona i përkasin komunitetit RAE (romë, ashkalinjë dhe egjiptas) dhe 22 të komunitetit serb.

Para fillimit të punës së tij, ZKKK-ja e Graçanicës regjistroi 34 persona të riatdhesuar, të gjithë nga komuniteti RAE. Ky regjister përfshin edhe personat e sjellë në Aeroportin e Prishtinës.

(Burimi: UNHCR)

2.2.8. Banimi

2.2.8.1. Objektet e banimit

Lloji mbizotërues i objekteve të banimit brenda territorit të komunës janë shtëpi individuale banimi. Sipas rezultateve paraprake të regjistrimit të ofruara nga Enti i Statistikës, ekzistojnë 3250 shtëpi individuale banimi. Në Graçanicë, aktualisht ekzistojnë 5 objekte kolektive banimi, 5 në Llapnasellë dhe 2 në Dobratin, që në total janë 210 njësi të banimit.

(Burimi: Komuna e Graçanicës).



Figura 5- Objekte kolektive të banimit, Graçanicë



Figura 6- Objekte kolektive të banimit, Llapnasellë



Figura 7- Objekte kolektive të banimit, Dobratin

2.2.9. Vendbanimet

2.2.9.1. Vendbanimet Joformale

Termi "Vendbanimet joformale" fillimisht është përdorur në Kosova dhe Plani për Zbatimin e Standardeve në vitin 2004 sipas definicionit si në vijim: "Vendbanimet joformale janë vendbanime njerëzore që nuk i ofron banorëve të vet asnjë mundësi të që të gëzojnë të drejtat e tyre për standard adekuat të jetesës, në veçanti të drejtat për strehim të përshtatshëm".

Nënshkrimi i Deklaratës së Vjenës në vitin 2005 ka mundësuar pëlqimin e të gjitha vendeve anëtare rreth masave për rregullimin e vendbanimeve joformale në mënyrë të qëndrueshme, në mënyrë për të parandaluar krijimin e tyre në të ardhmen. Kjo Deklaratë u pasua nga Plani i Veprimit për Partneritetit Evropian 2006 duke imponuar detyrimin që të zbatohet rregullimin e vendbanimeve joformale.

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-106 mbi Ndryshimin e ligjit për Planifikim Hapësinor nr 2003/14, vendbanim joformal u karakterizuan si vendbanim me karakteristikat e mëposhtme:

- Pronësi jo formale e pronës,
- Shërbime joadekuate apo privim total,
- Pjesëmarrje joadekuate apo mos pjesëmarrje në qeverisje, dhe
- Nivel i lart i diskriminimit të banorëve.

Që nga themelimi i saj, Komuna e Graçanicës u ballafaqua me probleme të shumta, njëra prej të cilave ishte e tërë komuna është rurale dhe duhet të rregullohet. Bazuar në kriteret rreth vendbanimeve joformale, u krye analiza e detajuar e të gjitha vendbanimeve në vitin 2010 dhe ishte konstatuar se ka pasur 15 (pesëmbëdhjetë) vendbanime joformale. Analiza tregon nivelin e zhvillimit të infrastrukturës sociale dhe fizike të këtyre vendbanimeve.

Tre vjet pas themelimit të Komunës, ka pasur përmirësim të dukshëm në zhvillimin e këtyre vendbanimeve në drejtim të infrastrukturës sociale dhe fizike.

Bazuar në analizat e kryera dhe duke marr në konsideratë projektet e zbatuara, u konkludua se disa vendbanime joformale në vitin 2010, tani kanë formën e vendbanimeve formale. Nga 15 vendbanimeve joformale të regjistruara më parë, vetëm tre kanë mbetur si të tilla:

- Një pjesë e vendbanimit Padalishtë në Graçanicë;
- Lagja rome në Graçanicë, dhe
- Lagja e Romëve në Preoc.

Tabela 4- Analize e vendbanimeve joformale ekzistuese në Graçanicë në 2013

Vendbani met joformale	Sip. (ha)	Topologjia	Nr. i shtëpive	Nr. i banorëve	Infrastruktura fizike	Infrastruktura sociale	Prona	Situata në lidhje me vendbanime t joformale	Prioriteti	Nëse është përfshi rë ndonjë subjekt tjetër në rregulli min e vendbanimeve joformale	
Graçanica											
1	Padalishtë Graçanicë	4.35	Urban	22	100	-Ujësjiellës/PO -Kanalizim/PO -Rruge dhe trotuare /ndriçimi i rrugëve-JO/PO -Sip. të zbrazëta/PO -Sip. e Gjellbëruar e rregulluar /JO	-Shkolla / Nuk ka nevojë për objekte të reja -Ambulanca / Nuk ka nevojë për objekte të reja -Çerdhe/ Nuk ka nevojë për objekte të reja -Shtëpi kujdesi/ PO -Shtëpi të kulturës- / Nuk ka nevojë për objekte të reja	Pronë komunale	Vendbanim është i parregulluar ; në kuadër të vendbanimit ka vendbanim kontejner për personat e zhvendosur brenda vendit.	Sigurimi i donacioneve është me prioritet	Nuk ka informacion
2	Lagja e romëve në Graçanicë	17.58	Urban	120	580	Ujësjiellësi / Pjesërisht Kanalizimi / Pjesërisht Rrugët dhe trotuaret / ndriçimi - Pjesërisht/Pjesërisht Zonat e zbrazëta / PO Sip. e Gjellbëruar e rregulluar/JO	-Shkolla / Nuk ka nevojë për objekte të reja -Ambulanca / Nuk ka nevojë për objekte të reja -Çerdhe/ Nuk ka nevojë për objekte të reja -Qendra rinore /PO	Prona private; një pjesë e vogël është pronë komunale	Vendbanim është i parregulluar me nivel të ulët të standardit të jetesës	Varet nga ofrimi i donacioneve	Nuk ka informacion
3	Lagja e romëve në Preoce	1.56	Rural	40	320	Ujësjiellësi / Pjesërisht Kanalizimi / Pjesërisht Rrugët dhe trotuaret / ndriçimi -PO/PO Sip. e Gjellbëruar e rregulluar/JO	--Shkolla / Nuk ka nevojë për objekte të reja -Ambulanca / Nuk ka nevojë për objekte të reja -Çerdhe/ Nuk ka nevojë për objekte të reja	Pronë private	Vendbanim është i parregulluar me nivel të ulët të standardit të jetesës	Varet nga ofrimi i donacioneve	Nuk ka informacion

2.2.10. Qendrat Kolektive

Sipas vlerësimeve të UNHCR, ekzistojnë 68 familje me katër qendra kolektive për refugjatë (Deri në qershor 2011).

Tabela 5- Numri i familjeve dhe numri i anëtarëve të familjeve në qendrat kolektive

Qendra kolektive	Nr. i familjeve	Nr. i anëtarëve të familjes	Kombësia
Vendbanimet kontejner „Voçar“	25	63	Serb
„Padaliste“	19	31	Serb
„Bergen“	17	21	Serb dhe Ashkali
Uglar	7	11	Serb dhe Malazias

2.2.11. Objektet Ilegale

Edhe pse nuk ka regjistër të objekteve të paligjshme të identifikuar, komuna konsideron se ekzistojnë ndërtesa ekzistuese ilegale brenda territorit të komunës. Keto çështje do të rregullohen sipas dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-188 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.

2.2.12. Shëndetësia

Sistemi i kujdesit shëndetësor që ofron kujdes primar dhe sekondar shëndetësor për të gjithë banorët e Kosovës, është një sistem i njohur për shërbimet e saj të nivelit të lartë dhe përfshin spitalin, shtëpitë e shëndetit dhe numrin e ambulancave.

Gjendja në sistemin e kujdesit shëndetësor është e kënaqshme duke marrë parasysh kushtet specifike të punës, mungesën e pajisjeve mjekësore dhe mungesën e ambulancave të specializuara, hapësira për pritjen e pacientëve etj Shumë shpesh ata japin maksimumin e tyre, nëse ne shikojmë në numrin e kontrolleve specialiste, numrin e ekzaminimeve me ultrazë, numri i operacioneve dhe numrin e të porsalindurve.

Pavarësisht kufizimeve për shkak të mungesës së kapaciteteve, objekteve joadekuate dhe hapësirave, mungesa e pajisjeve të nevojshme, personeli mjekësor arriti të sigurojë kujdesin e plotë sekondar shëndetësor për të gjithë qytetarët që kërkojnë trajtim mjekësor në spitalet tona.

Tabela 6- Objektet e kujdesit shëndetësor brenda territorit të komunës

SPITALE	SHTËPI SHËNDETI	AMBULANCA
Kirurgjia dhe GAK-Graçanicë	SHSH në Graçanicë	Çagllavicë
Spitali i internos Llapnasellë	SHSH në Gushtericën e E	Preoc
	SHSH në Uglarë	Lepina
	SHSH Prishtina në Graçanicë	Suvi Do
		Livadje
		Gushtericë e Epërme
		Batushë
		Sushicë
		Dobrotin
		Llapnasellë

Burimi: Spitali, Llapnasellë, Graçanicë

Që nga themelimi i saj, stafi mjekësor i shtëpisë së shëndetit në Graçanicë ofron ndërhyrjet emergjente dhe shërbimet e urgjencës si njësi e veçantë organizative. Ky shërbim ka dy ekipe të emergjencës që veprojnë 24 orë, e përbërë nga 1 mjek, 2 ndihmësmjekë dhe një shofer. Ekipi i parë është një ekip i terrenit, dhe një tjetër është gjithnjë në detyrë në dhomën e urgjencës, si dhe personelin laboratorik.

Tabela 7- Numri i mjekëve dhe shtretërve

Klinika	Numri i Mjekëve	Nr i Shtretëve
Kirurgjia	29	18
GAK	12	22
Interno dhe Pediatri	31	30
TOTALI	72	70

Burimi: Spitali, Llapnasellë, Graçanicë

- Klinika e Kirurgjisë në Graçanicë ka 18 shtretër për qëndrim të pacientëve gjatë natës. Ajo punëson 25 kirurgë dhe anesteziolog, 3 mjekë të përhershëm dhe 1 mjek të përgjithshëm, në total janë të punësuar 29 staf mjekësor në këtë klinikë.
- Klinika e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës ka 22 shtretër për pacientë. Ajo punëson 8 gjinekologë dhe obstetër, 1 mjek i përhershëm, 3 neonatolog, i përbërë prej 12 anëtarëve të stafit mjekësor.
- Klinika interne dhe pediatrike ka 30 shtretër për pacientët. Ajo punëson 10 Internistë, 8 pediatër, 8 neurofiziolog, 2 internist të përhershëm, 1 biokimist dhe 2 mjekë të përgjithshëm, totali 31 anëtar të stafit mjekësor.

Tabela 8- Numri i mjekëve specialist në ambulanca dhe qendrën spitalore

Mjekë specialist	Kirurg	Gjinekolog dhe Obstetër	Internist- Pediatër
Kirurgjia dhe anesteziologjia	25		
Gjinekolog dhe Obstetër		8	
Neonatolog		3	
Internist			10
Pediatër			8
Neurofiziologë			8
Mjek të përgjithshëm	1		2
Mjek të përhershëm	3	1	3
TOTAL	29	12	31

Burimi: Spital, Llapnasellë, Graçanica

Në mënyrë që të rrisë nivelin e shërbimeve shëndetësore, është e nevojshme të siguroj hapësira të reja dhe pajisje të reja mjekësore që do të mundësonte organizimin shumë të mirë të punës në dhënien e shërbimeve shëndetësore.

Në mënyrë që të rrisë nivelin e shërbimeve shëndetësore, është e nevojshme të siguroj hapësira të reja dhe pajisje të reja mjekësore që do të mundësonte organizimin shumë më të mirë të punës në dhënien e shërbimeve shëndetësore.

2.2.13. Shërbimet sociale

Një nga detyrat parësore të qendrave komunale për punë sociale është asistenca sociale në pajtim me Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale nr. 2003/15. Skema e ndihmës sociale përfshin dy kategori të shfrytëzuesve. Kategoria e parë ofron ndihmë financiare familjeve që kanë anëtar persona me invaliditet, në të cilat asnjë anëtar është i punësuar. Kjo kategori përfshin prindërit të vetëm. Kategoria e dytë ka për qëllim të ofrojë ndihmë financiare mujore të prindërve të papunë me të paktën një fëmijë nën 5 vjet, si dhe familjet kujdestare. Qendra për punë sociale ushtron të drejtat në fushën e mbrojtjes sociale, ofrimin e sigurisë sociale dhe familjare të qytetarëve.

Kjo qendër ofron shërbime për kategoritë vijuese të qytetarëve:

- Fëmijë dhe të rinj të lënduar të cenusshëm për shkak të situatës jo të mirë në familje, fëmijë dhe të rinj me sjellje të parregullta, Fëmijë dhe të rinj me nevoja të veçanta, persona me çrregullime mendore ose persona me aftësi të kufizuara psikofizike,
- Të rritur me çrregullime në sjellje, persona me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, persona pa të ardhura dhe persona pa përkujdesje.
- Persona me probleme familjare, persona me dhunë në familje persona, prindër që kanë birësuar.
- Persona të moshuar pa përkujdesje familjare, persona të moshuar pa të ardhura, persona të moshuar që janë të sëmur kronik dhe me aftësi të kufizuara, persona të moshuar me probleme familjare, persona të moshuar të tjerë që kanë kujdestar të përkohshëm.

Gjatë ofrimit të shërbimeve të mirëqenies sociale, kryhen aktivitet vijuese:

- Realizimi i të drejtës për mbështetje materiale;
- Realizimi i të drejtës për banim në objektet e mirëqenies sociale;
- Adoptimi i fëmijëve;

Qendra e mirëqenies Sociale ofron shërbimet e tyre çdo ditë pa pagesë për të gjithë banorët e komunës. Duke marrë parasysh llojet e shërbimeve sociale dhe familjare, ekziston nevoja për objektet vijuese brenda komunës:

- Shtëpia të sigurt që të ofrojnë strehim për viktimat e dhunës në familje dhe lloje të tjera të dhunës;
- Shtëpi të pleqve (objekti është në ndërtim e sipër);
- Objektet e këshillimit për çështjet e rëndësishme shoqërore;
- Strehimore për fëmijët pa kujdes prindëror;
- Strehimore për fëmijët me aftësi të kufizuara (objektit tillë ekziston në Padalishtë, e ashtu-quajtur "Shtëpia e Fëmijëve ", e cila është aktualisht nën kompetencë të Komunës së Shtimes).

Përfituesit e mirëqenies sociale

Një nga detyrat kryesore të Qendrave komunale të Mirëqenies Sociale është që të ofrojnë ndihmë sociale, në përputhje me Ligjin Nr 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale. Skema e ndihmës sociale përfshin dy kategori të përfituesve. Kategoria e parë përfshin familjet me anëtarët e familjes me aftësi të kufizuara, ku të gjithë anëtarët e familjes janë të papunë. Kjo kategori përfshin edhe prindërit beqar. Kategoria e dytë përfshin prindërit të papunë me të paktën një fëmijë më të ri se 5 vjet, si dhe të familjeve kujdestare.

Sipas QMS Graçanicës, në qershor të vitit 2011 ka pasur 176 familje të regjistruara që marrin ndihmë sociale. Nga ky numër, 25 familje janë nga kategoria e prindërve beqar, 69 familje kanë personat me aftësi të kufizuara dhe 82 familje janë nga kategoria e dytë të përfituesve.

Ndihma financiare është siguruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Komuna siguron mbështetje për popullatën më të rrezikuar përmes shumë projekteve të tjera.

Tabela 9- Numri i familjeve përfituese të mirëqenies sociale në qershor 2011

Vendbanimet	Graçanica	Lapnasella	Preoci	Çglavica	Badovci	Sushica	Kishnica	Livadja	Dobrotini	Gusterica e Fnërme	Gusterica e Poshtme	Lenina	Radeva	Skulaneva	Suvi Do	Uglare	Batushe	Totali
Numri i familjeve	4	1	2	3	5	2	2	3	10	8	3	4	7	2	5	1	1	17
	1	2	2				2								5	2		6

Përqindja më e lartë e përfituesve është nga Graçanica 23.3%, çka përkon me numrin e banorëve, pastaj nga Preoci dhe Kishnica me nga 12.5%. Varfëria është e dukshme në qendrat kolektive në Graçanicë dhe në Uglarë si edhe në vendbanimet rome në Graçanicë dhe në Preoc.

Sipas përkatësisë etnike, struktura e familjeve përfituese të mirëqenies sociale është si në vijim:

- 93 Familje Serbe- 52,84% ;
- 44 Familje Rome- 25%;
- 31 Familje Shqiptare- 17.61%;
- 6 Familje Ashkali- 3.41 %;
- 2 Familje Turke- 1.14%.




Figura 8- Struktura e familjeve përfituese të mirëqenies sipas përkatësisë etnike

Personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Graçanicës

Ekzistojnë katër shoqata të personave me aftësi të kufizuara në komunën e Graçanicës: shoqata e personave me distrofi muskulore, shoqata e personave me aftësi të kufizuara, shoqata e personave të verbër dhe me dëmtime në shikim dhe shoqata e personave invalidë të luftës. Shoqatat përballen me probleme të shumta, para se gjithash me mungesën e lokaleve për aktivitetet që lidhen me personat me aftësi të kufizuara

Shkolla Speciale

Në kuadër të shkollës fillore "Milladin Mitiç" në Llapnasellë ekziston një klasë e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ekziston nevoja për të hapur shkollën e veçantë për arsimin fillor dhe të mesëm të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Personat me distrofi muskulore

Sipas të dhënave të ofruara nga organizata e personave me aftësi të kufizuara nga nëntori i vitit 2012, janë 620 persona me aftësi të kufizuara të regjistruar në katër shoqata. Përveç objekteve gjithashtu ka nevojë për një qendër ditore.

2.2.14. Arsimimi

Brenda komunës së Graçanicës, ofrohet arsim fillore dhe i mesëm, si dhe në objektet parashkollore. Përveç shkollave kryesore, arsimi ofrohet edhe në paralelet e ndara. Ka disa degë të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës nga Mitrovica brenda territorit të komunës që ofrojnë mësimin në gjuhën serbe. Të gjitha këto shkolla ofrojnë arsim në gjuhën amtare serbe, me një përjashtim të Kishnicës dhe një klasë në Sushicë ku shkollimi ofrohet në gjuhën shqipe.

Arsimi i mesëm i popullsisë lokale në Komunën e Graçanicës deri në vitin 1999 është dhënë në gjuhën serbe në shkollat e mesme në Prishtinë, Lipjan dhe Fushë Kosovë . Pas 1999, të gjitha shkollat e mesme me lëndë serbe nga komunat e lartpërmendura kanë qenë të zhvendosura në territorin e Komunës së Graçanicës. Aktualisht këto shkolla ofrojnë arsimim në ambientet e shkollave ekzistuese fillore në kushte të papërshtatshme për procesin arsimor për shkak të mungesës së lokaleve.

Në mënyrë që të mundësohet funksionimi i shkollave të mesme dhe të degëve të fakulteteve, është e nevojshme që të ndërtohen ndërtesa qendrore apo të ndara për secilën shkollë të mesme me të gjitha infrastrukturën e nevojshme: kabinete, salla sportive dhe kënde lojërash.

Mësimdhënësit në të gjitha shkollat e mesme dhe në degët e fakultetit janë të trajnuar siç duhet dhe janë të mjaftueshme në numër, por kushtet e punës pengojnë realizimin adekuat të plan programit mësimor.

Tabela 10- Institucionet arsimore me numrin e nxënësve dhe të punësuarve

Nr .	Shkolla	Lokacioni	Nr. i Klaseve	Hapësira /m ²	Nr. i Studentëve/Nxënësve	Nr. i të Punësuarve	Numri i Mësuesve / Arsimitarëve	Nr. i të Punësuarve në Administratë	Nr. i të Punësuarve Mbeshtetës
1.	SH.F Petar Pan	Llapanaselë , Dobratin		400	45	23	10	4	8
2.	SHF”Djurdjevack“	Graçanicë, Llapanaselë, Preoce,Çagllavicë		1300	318	75	27	4	23
3.	Institucioni Parashkollor	Lepinë, Gushtericë, Suvi Do		300	100	11	6	2	2
4.	SHF “Nasir Radost“	Ugljare		220	102	25	15	3	6
5.	SHF ”Kralj Milutin“	Graçanicë	26	4000	580	80	56	4	19
6.	SHF “Miladin Mitic“	Llapanaselë	44	3500	400	78	57	5	14
7.	SHF “Sveti Sava“	Sushicë-Badovc	15	2500	100	39	30	2	7
8.	SHF “Ditet e minatorit“	Kishnicë (Sushicë)	9	420	182	20	16	0	3
9.	SHF “Knez Lazar“	Gushtericë e ultë(Dobrotin, Livagjë , Gushtericë e Epërme)	32	4000	530	105	83	6	15
10 .	SHF “Vuk Karadžic“	Lepinë (Radevë,Skulan evë Batushë)	18	2000	130	47	35	5	6

11	SHF „Ugljare“	Ugljarë	10	1500	210	37	30	2	4
12	SHF „Braca Aksic“	Suvi Do	4	300	93	11	8	1	2
13	Shkolla e Mjekisë	Graçanicë	8	Në Lokalet e SHF.Miluti n , K.Lazar ,SHF V.Karadzic	350	43	87	10	22
14	Shkolla Teknike/ Inxhinierisë Civile	Graçanicë	12	Në Lokalet e SHF K.Milutin	250	69	47	5	11
15	Shkolla e Muzikës	Graçanicë (D.Gusterica)	20	Në Lokalet e SHF.Miluti n , SHF K.Lazar ,SHF M.Mitic	180	41	24	6	9
16	Shkolla e Ekonomisë/ Tregtisë	Llapnaselë	14	Në Lokalet e SHF M.Mitic	200	33	27	3	3
17	Gjimnazi	Llapnaselë	8	Në Lokalet e SHF M.Mitic	115	37	27	3	2
18	Shkolla e Mekanikës	Preoce	9	Në Lokalet e SHF M.Mitic	90	58	42	4	13
19	Shkolla e Inxhinierisë Elektrike	Sushicë-Badovc	11	Në Lokalet e SHF S.Sava	150	37	56	10	10
20	Shkolla Bujqësore	Lipljan (Gushtericë e ultë)	18	Në Lokalet e SHF.V.Kar adzic	250	96	74	6	15
21	Arsimimi veçantë	Llapnaselë		250	27	7	4	1	2
TOTAL			262	33,370	4,357	949	751	82	188

Komuna e Graçanicës përfshin njëzet (20) institucione arsimore brenda territorit të saj, nga të cilat katër (4) kopshte-institucione parashkollore, tetë (8) shkolla fillore dhe tetë (8) shkolla të mesme. Të gjitha shkollat fillore ofrojnë arsimim në mjediset e tyre, ndërsa shkolla të mesme përdorin lokalet e shkollave fillore gjatë ndërrimit të mëngjesit për procesin arsimor.

Shumica e shkollave punojnë në tri ndërrime: Shkollat e mesme nga 06.30-11.00h, shkollat fillore nga 11.00-14.00h (klasa 1-rë deri në të 4-ën) dhe 14.00-18.30h (klasat e 5-të deri në klasën e 8-të).

Të gjitha objektet e shkollave fillore janë të vjetra, dmth ka një mungesë të ndërtesave të ndërtuara rishtazi, me përjashtim të disa anekseve shkollore (palestra), të cilat janë modernizuar në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 1999.

Në fund të vitit 2010, janë ndërtuar dy objekte parashkollore, objekti kryesor në Llapnasellë dhe paralelja e e saj ndarë në Dobratin.

Numri i objekteve të shkollave fillore, aranzhimi dhe distanca e tyre është brenda tërësisë së kriterëve standarde.

Ndërtimi dhe pajisja e shkollave të mesme do të krijonte kushte për funksionim të plotë dhe të duhur edhe të fakulteteve.



Figura 9- Objekti parashkollor, Llapnaselë



Figura 10- Objekti parashkollor, Dobrocin



Figura 11- Shkolla fillore "Kralj Milutin", Gračanica



Figure 12- SHF "Miladin Mitic", Llapnaselë



Figure 13- SHF, P. e ndarë "Ditet e Minatorit", Sushicë



Figure 14- SHF "Knez Lazar", Dobrocin



Figure15- SHF "Ditët e Minatorit", Kishnicë

2.2.15. Institucionet Kulturore

Përkujdesja e traditës kulturore dhe kombëtare dhe ruajtja e objekteve kulturore dhe fetare - të manastireve dhe kishave përgjatë gjithë shekujve, është një pjesë e trashëgimisë kulturore të popullatës së Kosovës.

Tipari më i rëndësishëm i vendbanimit të Graçanicës është Manastiri i Graçanicës, ku përgjatë shekujve popullata lokale është mbledhur, e cila po ashtu ishte qendër e arsimit dhe ngjarjeve kulturore.

Duke pasur parasysh se deri në themelimin e komunës së Graçanicës, Graçanica ishte rurale, prej të gjitha objekteve kulturore ajo kishte vetëm Shtëpinë e Kulturës, e cila me dekada, që nga 1948 paraqet një qendër të ngjarjeve kulturore, si në shumicën e fshatrave në komunë. Këto janë hapësira që shfrytëzohen për shumë qëllime, ndodhet një sallë për ngjarje kulturore dhe argëtuese, bibliotekë për dhomë për lexim, vendi për komunitet lokale, galeria dhe hapësirat publike.



Figura 16- Shtëpia e Kulturës në Graçanicë

Aktualisht, shtëpitë kulturore janë funksionale në fshatrat e mëposhtme: Graçanicë, Lapnasellë, Gushtericë e poshtme, Dobratin dhe Batushë. Në shtëpinë e kulturës në Graçanicë vepron një galeri, e cila përdoret përgjatë vitit për ekspozita, promovime dhe ngjarje letrare.

Shtëpia e Kulturës është shtëpia e ansamblit profesional dhe amatore "Venac", i cili është funksional për më shumë se 30 vjet.

Pas themelimit të Komunës së Graçanicës, janë ndërtuar qendrat kulturore në Badovc dhe Batushë, si dhe Qendrën Rinore në Preoc. Në të kaluarën në të gjithë këto fshatra mungonin objektet kulturore.

2.2.16. Hapësirat Publike (Sheshet dhe Memorialët)

Para themelimit të komunës së re, shumica e zonave të gjelbra kanë qenë të parregulluara dhe të lënë pas dore. Nuk kishte as sheshe e as vende lojërash për fëmijë, përmendoret ishin të lënë pas dore. Pas themelimit të komunës së Graçanicës, një numër i projekteve është zbatuar, duke përfshirë ndërtimin dhe rregullimin e parqeve publike, rregullimi i terreneve sportive të fëmijëve, rregullimi i memorialëve, ndërtimi dhe rregullimi i shesheve.

Ende ka zona të gjelbra që duhet ende të rregullohen, të mbjellën për tu bërë funksionale. Zhvillimet e ardhshme dhe përmirësimet në zbatim do të krijojnë mundësitë për rritjen e numrit të projekteve për renovim dhe rregullimin e parqeve të reja.

Parqet:



Figura 17- Parku i qytetit, Llapnasellë



Figura 18- Parku Përkujtimor dhe vendi lojërave të Fëmijëve, Livadje



Figura 19- Parku memorial, Graçanicë

Sheshet publike:



Figura 20- Sheshi Simonida, Graçanicë



Figure 21- Rrethi, Dobratın

2.2.17. Rekreacioni dhe Sporti

Në fushën e aktiviteteve sportive, menjëherë pas themelimit të komunës, rehabilitimi dhe rindërtimi i fushave sportive është kryer në të gjitha vendbanimet, si dhe ndërtimi i të reja, me instalimin e pajisjeve të ndriçimit.

Në Graçanicë ka filluar ndërtimi i qendrës sportive që përfshin fushaën e tenisit që është ndërtuar tashmë dhe fusha për basketboll dhe volejball. Ndërtimi i fushës së futbollit ka filluar, e cila përfshin shtegun e atletikës, ulëse për spektatorët, fushën ndihmës dhe objektet për atletët.

Tashmë është themeluar bashkëpunimi me shoqatat sportive me mbështetjen organizative dhe financiare, çka ka rezultuar me organizimin e parë të "Olimpiadës Sportive". Gjithashtu janë hapur shkolla e tenisit, shkolla e basketbollit, shkolla e futbollit dhe shkolla e karatesë. Aktualisht në të gjitha fshatrat në komunë, me përjashtim të fshatit Radevë, ekzistojnë fusha sportive si komplekse të pavarura ose brenda objekteve shkollore.



Figure 22- Fushat e tenisit në Graçanicë



Figure 23- Objekti i administratës së hapësirës sportive

Në mënyrë që të arrihet nivel më i lartë i arsimit, kulturës dhe jetës së shëndetshme, sfidat reale për të ardhmen janë ndërtimi i objekteve dhe investimi në burimet njerëzore.

Stafi ekzistues arsimor dhe kulturor dhe punëtorët sportive duhet të plotësohen me staf të ri, të arsimuar dhe perspektiv. Gjithashtu, përmirësimi i vazhdueshëm nëpërmjet seminareve, trajnimeve dhe takimeve duhet të mundësohet për të gjithë, duke përfshirë edhe nëpërmjet krijimit të qendrës arsimore si një shtyllë e aktiviteteve të tilla.

2.3. Zhvillimi Ekonomik

Sipas Planit të miratuar Hapësinor të Kosovës, komuna e Graçanicës është e vendosur në zonën e kaltër. Sipas strategjisë për zhvillimin rajonal, komuna e Graçanicës i takon Zonës Ekonomike Qendër (ZEQ). ZEQ zë vend qendror në raport me zonat e tjera ekonomike. Kapitali i Kosovës është i vendosur në këtë zonë dhe përfaqëson qendrën e administratës shtetërore, të biznesit privat dhe të shërbimeve, si dhe qendër kulturore dhe arsimore. Autostrada që do të lidhë Kosovën dhe Shqipërinë do të kalojë nëpër këtë zonë (ZEQ), që përfshin rrugët e tjera kryesore të trafikut që lidh kryeqytetin me pjesët e tjera të Kosovës.

Pozita gjeografike është potenciali më i madh i komunës, dhe më e rëndësishmja natyrisht që është toka bujqësore.

Rrugët kryesore hekurudhore që lidhin Prishtinën- Fushë Kosovën- Pejë dhe Prishtinën- Shkup dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, janë pjesë e ZEQ-së. Ekzistojnë dy centrale të energjisë elektrike Kosova A dhe Kosova B në këtë zonë, si dhe minierat e hapura; Bardhi i Madh dhe Dobrosella. Për shkak të faktit se komuna e Graçanicës zë vendin qendror brenda këtij rajoni, të gjitha parametrat e lartpërmendura ndikojnë në zhvillimin ekonomik komunal (Burimi: Agjencia për Zhvillimin Rajonal).

2.3.1. Gjendja ekonomisë lokale

Janë 496 kompani të regjistruara në territorin e Komunës së Graçanicës. Aktivitetet e kryera nga këto kompani të paraqitura në përqindje janë si më poshtë:




Figura 24- Llojet e aktiviteteve përbrenda komunës së Graçanicës

Aktualisht, shumica e aktiviteteve biznesore në komunë përfshijnë ndërmarrjet mikro dhe të vogla që merren me tregti, shërbime dhe prodhim.

Tabela 11- Aktivitetet e bizneseve në Komunën e Graçanicës

Nr.	Lokacioni	Prodhim	Shërbime	Tregti	Totali
1	Graçanicë	2	52	120	174
2	Llapnasellë	6	30	63	99
3	Çagllavicë	2	7	39	48
4	Preocë	4	8	23	35
5	Livagjë	2	6	10	18
6	Gushtericë e Ultë	5	8	25	38
7	Gushtericë e Sipërme		3	3	6
8	Dobrotin	4	7	27	38
9	Sushicë	1		4	5
10	Badovc	1		5	6
11	Kishnicë			2	2
12	Lepinë		2	5	7
13	Radevë		1	3	4
14	Skullanjevë			2	2
15	Suvi Do	1	2	8	11
16	Batushë			3	3
	Totali	28	126	332	496

Burimi: Njësia për zhvillim ekonomik, komuna e Graçanicës

Tabela 12- Aktivitetet e Biznesit në Sektorin Privat

Nr.	Lokacioni	Banka	Spitale	Hotele ²
1	Graçanicë	6		2
2	Llapnasellë	3	1	4
3	Gushtericë e Sipërme			1
4	Dobrotin			2
5	Livagjë			1
6	Çagllavicë		1	1
7	Preocë		2	3
8	Totali	9	4	14

Burimi: Njësia për Zhvillim Ekonomik, Komuna e Graçanicës




Figura 18- Aktivitetet e Biznesit të Shërbimeve

² Motelet, Restorantet po ashtu janë të përfshira

2.3.2. Industria

Miniera më e madhe e plumbit dhe zinkut miniera e Kishnicës e cili nuk është funksionale që nga viti 1999. Megjithatë, në vitet e fundit kjo minierë përpunon mineralet e plumbit dhe zinkut nga miniera e Marecit dhe Novobërdës. Miniera e Kishnicës përfaqëson asete industriale, por ajo duhet të rishikohet tërësisht.

Tabela 13- Prodhimtaria

Nr.	Kompania	Aktiviteti	Lokacioni
1	"MILLENUM GROUP"	Prodhimi i miellit	Llapnasellë
2	"ELNOR" SH.P.K	Prodhim i tavolinave dhe karrigeve	Llapnasellë
3	"MIQESIA"	Prodhimi i Betonit	Llapnasellë
4	"KEMA COMPANY"	Prodhime të betonit dhe çimentos	Llapnasellë
5	"EUROBETON COMPANY"	Prodhimi i elementeve nga betoni për sisteme të kanalizimit	Preocë
6	"SOLID"	Prodhimi i ullukëve	Preocë
7	"YLLITERM"	Prodhimi i bojlerëve	Dobrotin
8	"CONCEZUS"	Prodhimi i elementeve të betonit	Dobrotin
9	"KRYEZIU 2"	Prodhimi i elementeve të betonit	Dobrotin
10	"LAS PALMAS"	Prodhimi i perimeve dhe luleve	Dobrotin
11	"XELLA"	Prodhimi i tullave të silikonit	Dobrotin
12	"MENTORI COM"	Riciklimi i mbetjeve metalore	Dobrotin
13	"INTER QADRA"	Prodhimi i ceradave dhe tendave	Livagjë
14	"SCAMPA"	Prodhimi i qeseve të plastikës	Livagjë
15	"FRATELO TRADE"	Prodhimi i keksëve	Badovc
16	"FITORJA"	Prodhimi i betonit	Çagllavicë
17	"RELUX"	Prodhimi i ngjyrave dhe llakave	Llapnasellë




Figure 25- Lokacioni i zonës se biznesit

2.3.3. Punësimi (Sektori Privat)

Sipas bizneseve të regjistruara dhe të certifikuara, numri i të punësuarve në sektorin privat është 992-1488. Tabela më poshtë paraqet 10 kompanitë me 196 punëtorët e punësuar plotësisht dhe 25 punëtorëve sezonalë, edhe pse numri real duhet të jetë edhe më i lartë. Zyrtarisht numri i regjistruar i të punësuarve nuk është real dhe objektiv.

Tabela 14- Punëdhënësit më të mëdhenj në komunë:

Nr.	Kompania	Aktiviteti	Lokacioni	Nr. i të Punësuarve
1.	"ANTON" SH.P.K	Shitja me shumicë e xhamit dhe ngjyrave	Llapnasellë	20+Punëtorë sezonal
2.	"RELUX" SH.P.K	Prodhimi i ngjyrave dhe llaqeve	Llapnasellë	10
3.	"KOSOVA KOLOR" SH.PK	Shitja me shumicë e ngjyrave dhe llaqeve	Llapnasellë	5
4.	"ELNOR" SH.P.K	Prodhim i tavolinave dhe karrigeve	Llapnasellë	39+9 Punëtorë sezonal
5.	"HIB" SH.P.K	Pompë e derivateve, restorant dhe shitore	Llapnasellë	26
6.	"INTER QADRA" SH.P.K	Prodhimi i ceradave dhe tendave	Livagjë	7+7 Punëtorë sezonal
7.	"KEMA" SH.P.K	Prodhime të betonit dhe çimentos	Llapnasellë	21
8.	"ORBICO" SH.P.K	Shtija me shumicë e ushqimit dhe kozmetikës	Llapnasellë	17
9.	"EBC COMPANY" SH.P.K	Shitja me shumicë	Llapnasellë	19
10.	"PORSHE" SH.P.K	Auto Sallon	Llapnasellë	32




Figura 15- Prezantimi grafik i punëdhënësve të mëdhenj

2.3.4. Organizatat Joqeveritare (OJQ)

Ekzistojnë njëzet e dy (22) organizata joqeveritare përbrenda territorit të komunës së Graçanicës.

Tabela 16- Organizatat joqeveritare në Komunën e Graçanicës

Nr.	OJQ	Aktiviteti	Lokacioni
1	OJQ "CSD"	Komunikim për zhvillimin e shoqërisë	Graçanicë
2	"CRT/KPA"	Qendra për paqe dhe tolerancë	Graçanicë
3	OJQ "Nënë Tereza"	Bashkëpunim për ndërtimin e çerdhes ndëretnike në Kishnicë	Kishnicë
4	"AVENIJA"	Fuqizimi ekonomik i grave	Llapnasellë
5	"SUZ"	Aleanca e asociacionit të grave	Llapnasellë
6	"FUTURE"	Të drejtat e njeriut dhe fuqizimi	Graçanicë
7	"PUTEVIMA SUNCA"	Organizata e fëmijëve dhe të rinjve	Graçanicë
8	OJQ "Ruka ruci"	Fuqizimi i grave nga komunitetet minoritare	Ugljar
9	OJQ	Qendra për dialog dhe reconciliation	Llapnasellë
10	OJQ	Do të jetë më mirë	Graçanicë
11	"OČI BUDUĆNOSTI"	Organizatë e romëve	Graçanicë
12	"POKRETAČ"	Organizatë e sporteve	Sushicë
13	OJQ "GETO"	Në bashkëpunim me CSD	Graçanicë
14	"SAVEZ SLEPIH"	Asociacioni i personave të verbër	Graçanicë
15	OJQ	Organizatë e personave me aftësi të kufizuara	Graçanicë
16	OJQ "Moja inicijativa"	Projekt dedikuar të rinjve (sport)	Kishnicë
17	"MINATORI I RI"	Asociacion kulturor artistik	Kishnicë
18	"REAL KLUB"	Klub i boksit	Graçanicë
19	"UGLJARE"	Klub i futbollit	Ugljare
20	"ZELENA AGENDA"	Agjendë e gjelbër	Graçanicë
21	OJQ "Kometa"	Të drejtat e njeriut, zhvillim ekonomik, rini etj.	Graçanicë
22	"QENDRA RINORE"	Afër përfundimit	Graçanicë

2.3.5. Bujqësia

Bujqësia është e renditur si e cilësisë së lartë. Bazuar në informatat e marra nga Drejtoria e Bujqësisë 76,93% e tokës është toka e punëshme kryesisht me të korra (gruri dhe misri). Ka edhe pemishte dhe kopshte të vogla me perime kryesisht vetëm për përdorim personal. Rreth 15.1% janë livadhe dhe kullota megjithatë ka një numër shumë të kufizuar të fermave (19 fermerë të regjistruar në të gjitha komuna).

Graçanica është kryesisht komunë rurale dhe ekonomia e saj është shumë e varur nga prodhimi bujqësor. Pjesa më e madhe e territorit të saj është e përbërë nga tokat e kategorisë së I dhe II.

Dy degët themelore bujqësore që mbizotërojnë në komunën e Graçanicës janë bujqësia dhe blegtoria. Komuna e Graçanicës përfshin rreth 8700 hektarë tokë bujqësore që përfaqëson rreth 71% të sipërfaqes totale. Kjo tokë përfshin livadhet dhe kullotat.

Komuna e Graçanicës, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë inkurajon zhvillimin e bujqësisë nëpërmjet subvencioneve për sezonin e pranverës dhe të vjeshtës, duke mbështetur në këtë mënyrë forcimin ekonomik të fermave, në mënyrë që të rrisin kapacitetet e tyre prodhuese.

Prodhimi bujqësor në kuadër të komunës përfshin prodhimin e ushqimit të kafshëve dhe perimeve nga burime të tilla si rritja e peshkut, bletaria, rritja e kërpudhave, rritja e kërmijve, prodhimin e erëzave dhe bimëve mjekësore si dhe produkteve të tjera të kultivuara në toka bujqësore, por ato nuk janë të përfaqësuara sa duhet në Komunë.

Bujqësia më së shumti bazohet në prodhimin e të lashtave vijuese:

Tabela 17- Të lashtat e rritura

Nr.	Të lashtat	Të kultivuar/hapësira/h	Të kultivuar/hapësira/%	Prodhimi kg/ha	Prodhimi Total /kg
1	Grurë	3,834.81	53.80%	6,000	23,008,860
2	Elb	653.34	7.50%	4,000	2,613,360
3	Misër	3,933.23	38.50%	4,000	15,732,920
4	Luledielli	83.11	1,4 %	2,200	182,842

Tabela e sipërme paraqet të lashtat dhe kuturat në vitin 2011. Mund të shihet se përqindja më e lartë e tokës bujqësore bie mbi grurin dhe misrin, dhe se këto të lashtat japin rendimentet më të larta.

Mund të konkludohet se bujqësia nuk është zhvilluar si një sektor ekonomik edhe pse ka potencial duke pasur parasysh cilësinë e bujqësisë dhe traditën e komunitetit lokal në bujqësi. Industria e mundshme ushqimore dhe krijimi i një tregu për produktet lokale mund të promovoj dhe të stimulojë zhvillimin.

2.3.6. Ujitja

Prodhimet nga të lashtat e lartpërmendura janë arritur në kushtet më të thjeshta të shfrytëzimit të tokës bujqësore, do të thotë se deri më tani në kuadër të territorit të komunës së Graçanicës nuk ekzistojnë sisteme të ujitjes së të mbjellurave. Ndërtimi i sistemeve të ujitjes do të rrisë rendimentin e kulturave bujqësore me 50%, çka do të krijojë kushte më të mira për plasim në treg të këtyre produkteve.

2.3.7. Mbarështimi i blegtorisë

Mbarështimi i blegtorisë është një nga sektorët më të përfaqësuara ekonomike në Komunën e Graçanicës. Janë 19 fermerë të regjistruara në Institutin e Ushqimit dhe Veterinarisë me rreth 160 lopë qumështore. Komuna e Graçanicës është duke u përpjekur për të dhënë stimuj për fermerët në mënyrë që të angazhohen në mbarështimin e blegtorisë dhe bujqësisë përmes kredive dhe të subvencioneve të dhëna nga Ministria e Bujqësisë.

Fermerët që prodhojnë qumësht dhe janë të angazhuar në mbarështimin blegtoral mbështeten nga ana e administratës lokale, si stimul shumë i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm të blegtorisë.

2.3.8. Potencialet turistike

Kosova është një thesar i pasur i trashëgimisë etnike, kulturore dhe shpirtërore të periudhave të ndryshme historike. Trashëgimia kulturore është e karakterizuar nga shumëllojshmëria, vlerave dhe rëndësisë e saj historike.

Atraksionet turistike në komunën e Graçanicës janë:

- Manastiri i Graçanicës, ndërtesë madhështore e shekullit XIV, ishte ndërtuar nga Mbreti Millutin në vitin 1321. Ai i përkushtohet Virgjëreshës Maria e bekuar;
- Lokaliteti arkeologjik Ulpiana me mbetjet e qytetit romak dhe periudhës së hershme bizantine, e themeluar në mes të shekullit të II pas Krishtit;
- Shumë kisha me stile të ndryshme pothuajse në çdo fshat;
- Liqeni i Graçanicës;
- Hurdha e peshqve në Radevë;
- Burimi natyror-Çeshmja.




Figura 26- Potencialet turistike të Komunes se Graçanicës

Komuna e Graçanicës ka potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit kulturor, fetar, rekreative, sportiv, të, turizmit fshatar dhe të gjuetisë. Turizmi është zhvilluar dobët. Megjithatë, organizata turistike komunale e Graçanicës është në zhvillim e sipër.

2.4. Infrastruktura dhe Shërbimet Publike

2.4.1. Transporti dhe rrugët

Territorin e komunës së Graçanicës e përshkojnë tre rrugë magjistrale:

- Rruga magjistrale Prishtinë- Gjilan (5.5 km nëpër komunë);
- Rruga magjistrale Prishtinë- Shkup (12.3 km nëpër komunë);
- Rruga magjistrale Prishtinë- Prizren (3.45 km nëpër komunë).




Figura 27- Rrjeti i rrugëve nëpër territorin e komunës

Përveç kësaj, autostrada që do ta lidh Kosovën, Shqipërinë dhe Serbinë (korridorin evropian 10) është në ndërtim e sipër dhe kalon nëpër komunën e Graçanicës.

Komuna e Graçanicës përfshinë 16 (gjashtëmbëdhjetë) fshatra dhe në përgjithësi janë të lidhura të gjitha me rrugë lokale rurale. Shumica e rrugëve në brendi të fshatrave janë me profil joadekuat, prej të cilave rrugët lokale që lidhin vendbanimet janë që nga themelimi i komunës së Graçanicës kryesisht të riparuar dhe të asfaltuara. Rrugët tjera brenda vendbanimeve pjesërisht janë të asfaltuara. Sipërfaqja e përgjithshme e të gjitha rrugëve në territorin e komunës së Graçanicës është 2,696.301.00 m².

Sipas të dhënave të stacionit policor në Graçanicë në vitin 2012 në territorin e komunës janë regjistruar gjithsej 197 aksidente komunikacioni dhe nuk ka pasur aksident me fatalitet.

Zona të zeza në territorin e komunës që janë evidentuar në periudhën e kaluar, janë:

- Rruga lokale Graçanicë– Badovc i Ri (kthesa para pishinës, 5 incidente);
- Rruga lokale Graçanicë– Lapnasellë (në kthesën e dyfishtë tek Çeshmja, 13 incidente);
- Rruga lokale në Lapnasellë (mes restorantit– Kod HRANE– dhe restorantit–VOŽD, 33 incidente).

(Burimi: Zyra për Kadastër në komunën e Graçanicës)

Tabela 18- Sipërfaqja e rrugëve lokale në territorin e Komunës së Graçanicës

Settlement	Area/m ²
Gracanica	105,930.00
Radevo	78,366.00
Laplje Selo	301,507.00
Preoce	174,823.00
Lepina	147,197.00
Suvi Do	293,842.00
Batuse	63,990.00
Ugljare	125,459.00
Susica	185,580.00
Badovac	77,417.00
Skulanevo	125,995.00
Gornja Gušterica	97,168.00
Donja Gušterica	301,465.00
Dobrotin	165,690.00
Livadje	266,301.00
Total	2,696,301.00

	Ugljare	Gračanica	Badovac	Laplje selo	Preoce	Sušica	Gornja Gušterica	Donja Gušterica	Dobrotin	Lepina	Livadje	Radevo	Skulanevo	Suvi Do	Čaglavica	Batuse
Ugljare	x	10.1	12.1	5	4.3	13.3	14.8	13	15.1	10.1	10.5	11.6	11.6	14.3	8.3	13
Gračanica	10.1	x	2.1	5.1	6.6	3.3	7	9.2	11.3	12.4	8.7	13.9	13.9	16.6	8.1	14.7
Badovac	12.1	2.1	x	7.1	8.6	1.2	4.9	6.7	8.8	14.4	10.9	15.9	15.9	18.6	10.1	16.7
Laplje selo	5	5.1	7.1	x	1.5	8.3	9.8	8	10.1	7.3	5	8.8	8.8	11.5	3	9.6
Preoce	4.3	6.6	8.6	1.5	x	9.8	11.3	9.5	11.6	5.8	6.6	7.3	7.3	10	4	8.1
Sušica	13.3	3.3	1.2	8.3	9.8	x	3.7	5.5	7.6	15.6	10.5	17.1	17.1	19.8	11.3	17.9
Gornja Gušterica	14.8	7	4.9	9.8	11.3	3.7	x	1.8	3.9	17.1	5.3	18.6	15.6	12.9	12.8	19.4
Donja Gušterica	13	9.2	6.7	8	9.5	5.5	1.8	x	2.1	15.3	3	16.8	13.8	11.1	11	17.6
Dobrotin	15.1	11.3	8.8	10.1	11.6	7.6	3.9	2.1	x	17.4	4.8	18.9	11.7	9	13.1	19.7
Lepina	10.1	12.4	14.4	7.3	5.8	15.6	17.1	15.3	17.4	x	12	1.5	1.5	4.2	9.8	2.3
Livadje	10.5	8.7	10.9	5	6.6	10.5	5.3	3	4.8	12	x	13.5	13.1	9	13.4	14.2
Radevo	11.6	13.9	15.9	8.8	7.3	17.1	18.6	16.8	18.9	1.5	13.5	x	3	5.7	11.3	3.8
Skulanevo	11.6	13.9	15.9	8.8	7.3	17.1	15.6	13.8	11.7	1.5	13.1	3	x	2.7	11.3	3.8
Suvi Do	14.3	16.6	18.6	11.5	10	19.8	12.9	11.1	9	4.2	9	5.7	2.7	x	13.7	6.5
Čaglavica	8.3	8.1	10.1	3	4	11.3	12.8	11	13.1	9.8	13.4	11.3	11.3	13.7	x	11.8
Batuse	13	14.7	16.7	9.6	8.1	17.9	19.4	17.6	19.7	2.3	14.2	3.8	3.8	6.5	11.8	x

Tabela 19- Distanca e rrugës (në km) mes fshatrave dhe komunës me një tolerancë prej ±5% (Komuna e Graçanicës)

2.4.2. Transporti Hekurudhor

Nëpër hapësirën e komunës së Graçanicës kalojnë dy linja hekurudhore:

- linja ndërkombëtare Prishtinë- Shkup- Athinë;
- linja lokale hekurudhore që lidh vendbanimet Kishnicë, Graçanicë, Lapnasellë dhe Lepinë deri tek nyja kryesore hekurudhore në Fushë Kosovë.

Kjo hekurudhë është shfrytëzuar për nevojat e minierës në Kishnicë për transportin e xehes, dhe kjo ka qenë në përdorim deri në vitin 2003, e cila është përdorur edhe për transportin e udhëtarëve.



2.4.3. Transporti ajror

Aeroporti i Prishtinës është aeroport ndërkombëtar, që gjendet 22 km larg Graçanicës. Ky aeroport është më i madhi në territorin e Kosovës dhe ka pozitë strategjike, që gjendet në pjesën qendrore të regjionit të Ballkanit, kështu që është lidhje e mirë për qendrat tjera në regjion. Në aeroportin e Prishtinës zhvillohet transporti mallrave dhe ai i udhëtarëve. Në periudhën e mëhershme krahas shfrytëzimit për nevojat civile është përdorur edhe për nevoja ushtarake.

2.4.4. Transporti publik

Në komunën e Graçanicës ekzistojnë dy lloje të transportit publik dhe ato janë transporti urban dhe ai ndër-urban. Sa i përket transportit publik në komunën e Graçanicës më së shumti bazohet në agjencitë e vogla që bëjnë transportin e udhëtarëve me minibus, e që në agjencitë e tyre kanë një, eventualisht dy minibus.

Ky lloj transporti zhvillohet nga ora 06:30 deri në 15:00, e pas kësaj kohe mund të shfrytëzohen vetëm shërbimi i taksive. Ky problem në komunikimin e qytetarëve mes fshatrave është edhe pengesë në zhvillimin e këtyre lokaliteteve, ndërsa banorët e kësaj komune janë të detyruar që çdo ditë të përdorin auto-stop që të arrijnë në punë, shkollë dhe shtëpi shëndeti.

Drejtorja e shërbimeve publike në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturë kanë organizuar transport humanitar për të gjithë banorët komunës së Graçanicës. Transportin urban tre herë në javë në tërë komunën e bën “Arsa prevoz”, derisa transportin ndër-urban, tre herë në javë e bën “Selo Tours”.

Përveç kësaj, nëpër vendbanim kalon edhe autobusi i linjës Prishtinë- Gjilan, Prishtinë-Janjevë dhe Prishtinë-Sushicë. Autobusi Prishtinë- Gjilan kalon çdo 20 minuta gjatë ditës prej orës 07:45 në mëngjes, deri në 6:30 pasdite. Autobusi Prishtinë-Janjevë kalon nëpër komunë tre herë në ditë. Megjithatë, tërë ky transport nuk plotëson nevojat e banorëve. Përveç kësaj, nuk ka linja në orët e mbrëmjes që të lidhin vendbanimet e as linja direkt me autobus që lidh me Prishtinën. Mungesë e madhe është edhe mos-ekzistimi i një stacioni të autobusëve, prej nga do të bëhej nisja nëpër këto linja dhe, linjat që përshkojnë komunën të kenë vend për të mbledhur udhëtarët nga komuna.

Sa i përket shërbimit të taksive, ekziston vetëm një auto taksi.

Shërbimet komunale i ofron ndërmarrja regjionale për shërbime publike në Prishtinë. Si në vendet tjera rurale në Kosovë, shërbimet komunale janë shumë të dobëta.

2.4.5. Ujësjellësi

Komuna e Graçanicës furnizohet me ujë të pijshëm nga “Kompania e Ujësjellësit Regjional” nga Prishtina. Regjioni i Prishtinës, si dhe një pjesë e vendbanimeve të komunës së Graçanicës: Graçanica, Kishnica, Badovci, Sushica, Lapnasella, Preoca dhe Çagllavica, furnizohen me ujë të pijshëm nga rezervari artificial, gjegjësisht nga liqeni i Graçanicës. Liqeni artificial është ndërtuar në vitin 1966, e në shtator të atij viti është lëshuar në funksion. Kapaciteti i liqenit të Graçanicës është rreth 26,000.000.00 litra. Përkaj liqenit është ndërtuar pika e ujësjellësit për prodhimin e ujit të pijshëm. Ekziston zona e mbrojtur rreth liqenit të Graçanicës.



Figura 28- Stacioni i ujësjellësit regjional të Prishtinës në Graçanicë

Numri i konsumatorëve/familjeve të vendbanimeve të cekura në komunën e Graçanicës që furnizohen me ujë të pijshëm është 2723. Gjithashtu, kompania rajonale e ujësjellësit, me njësinë saj punuese në Lipjan, furnizon me ujë të pijshëm fshatrat e komunës së Graçanicës si: Dobratinin, Gushtericën e Poshtme, Gushtericën e Epërme dhe Livaden. Këto vendbanime furnizohen me ujë të pijshëm nga stacioni për përpunimin e ujit në Lipjan, por edhe nga pusët në afërsi.

Tabela 20- Gjatësia, numri i shfrytëzuesve dhe kapaciteti i rrjetit

Nr.	Linja e rrjetit	Gjatësia e rrjetit/m	Numri i shfrytëzuesve	Kapaciteti l/s
1	Lipjan- Gushtericë e Epërme	L = 7,300	257	12 l/s
2	Lipjan - Gushtericë e Poshtme	L=4,200	112	2 l/s
3	Lipjan -Livade	L=8,100	165	2-3 l/s
4	Lipjan -Dobratini	L=7,300	145	2-2,5 l/s
	Gjithsej	L=26,900	679	

Janë gjithsej 3402 familje që kanë furnizim me ujë të pijshëm që do të thotë se nga numri i përgjithshëm i familjeve 1098 familje janë pa ujë.

Vendbanimet Lepinë, Batushë, Skulanevë, Radevë dhe pjesërisht Suvido nuk kanë sistem të rregulluar të ujësjellësit, por furnizohen nga pusët private. Për fat të keq, askush nga autoritetet institucionale nuk e kontrollon kualitetin e ujit nga pusët private.

2.4.6. Kanalizimi

Komuna e Graçanicës është komunë e cila përbëhet nga vendbanimet rurale, ashtu që mbulimi me rrjet të kanalizimit para themelimit të komunës së Graçanicës ka qenë i dobët. Në periudhën e themelimit, komuna e Graçanicës ka ndërtuar sistemin e kanalizimit nëpër tërë lagjet e komunës. Mbulimi është i dobët në vendbanimet si Lepina, Batusha, Radeva. Të gjitha ujërat nga sistemi i kanalizimit, si ujërat atmosferike si dhe ujërat e zeza derdhen në lumenj, pa filtrim paraprak (nuk ka sisteme për pastrimin e ujërave të zeza).

Me analizimin e përbërjes së ujërave të zeza është konstatuar se gjendja e cilësisë së ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësorë, e me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve si dhe masat bazë për parandalim dhe mbrojtje janë ndërmarrë masa në zvogëlimin e shkallës së ndotjes së ujit. Kuvendi i Komunës së Graçanicës me realizimin e projekteve kapitale (ndërtimin e kolektorëve publikë për ujërat e zeza), përkohësisht ka eliminuar ndotësit artificialë të ujërave sipërfaqësorë dhe atyre nëntokësor.

Përfshirja e përgjithshme në kolektorin publik të ujërave të zeza në territorin e komunës së Graçanicës është 30,173 m.

Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në vet vendbanimin e Graçanicës në vitin 2011 dhe 2012 është rreth 2,500 m. Kompania rajonale e ujësjellësit PRISHTINA nga Prishtina, kujdeset për funksionimin e rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe atij të ujërave të zeza, edhe pse ato rrjete janë të vjetra dhe nuk kanë kapacitete për tu zgjeruar.

2.4.7. Menaxhimi i mbeturinave

Graçanica ende nuk ka plan për menaxhimin e mbeturinave. Mirëpo, pas formimit të komunës së Graçanicës, komuna së bashku me kompaninë rajonale për menaxhimin e mbeturinave "Pastrimi" ka marrë kompetencat për grumbullimin dhe deponimin e mbeturinave. Por, kapaciteti i kompanisë "Pastrimi" konsiderohet i pamjaftueshëm dhe nuk ka numër të mjaftueshëm të kontejnerëve brenda territorit të komunës. Mbeturinat mblidhen dy herë në javë në tërë territorin e komunës (dy herë në Graçanicë dhe një herë në javë në vendbanimet tjera). Me mbeturina në zonën e biznesit menaxhojnë vetë pronarët e bizneseve. Sasia e mbeturinave të grumbulluara në tërë komunën është rreth 140 m³ në javë. Mbeturinat nuk selektohen (gjitha mbeturinat organike dhe të tjera janë të përziera). Problem të madh paraqet deponimi i mbeturinave mjekësore të cilat deponohet së bashku me mbeturinat tjera. Njëra ndër deponitë kryesore është penda e mbeturinave minerare të minierës së Kishinicës. Kjo deponi është sfida kryesore për ambientin me të cilën përballet komuna.

2.4.8. Rrjeti elektrik

Territori i komunës së Graçanicës është pothuajse i mbuluar krejtësisht me rrjetin elektrik, furnizimi me energji elektrike bëhet nga KEK-u. Energjia elektrike prodhohet në termoelektranën në Obiliq. Për prodhimin e energjisë elektrike shfrytëzohet xehja e linjitit e cila eksploatohet nga mihja sipërfaqësore (në Bellqevc, Dobrosellë, etj.).

Restriktionet e shpeshta gjatë periudhës së dimrit, vështirësojnë funksionimin normal si të amvisërive e poashtu edhe të kompanive afariste. Edhe pse çdo herë e më shumë shfrytëzuesit e rrjetit elektrik rregullisht paguajnë obligimet e tyre ndaj KEK–ut, ndërprerja e rrymës në periudhën e dimrit është pjesë përbërëse e banorëve të komunës së Graçanicës.

Për shkak të mungesës (mos-dorëzimit) të të dhënave nga institucionet relevante, nuk ka informata për numrin dhe kapacitetin e rrjetit për furnizimin me energji elektrike.

2.4.9. Komunikimet (telekomunikimet dhe interneti)

Në territorin e komunës së Graçanicës funksionojnë disa firma që merren me këtë veprimtari. Sipas informatave të mbledhura ka mbi 15 kompani që ofrojnë shërbime interneti, televizion kabllor, telefoni mobile dhe fikse. Duhet përmendur se Telekom i Serbisë sipas vlerësimit tonë mbulon rreth 95% të territorit të komunës së Graçanicës me telefoni fikse, si dhe me sinjal të telefonisë mobile. Përveç kësaj, ofrohen edhe shërbime të ADSL-së dhe IPTV-së por vetëm për territorin e Graçanicës dhe Sushicës. Këto të dhëna janë fituar në bazë të vlerësimeve nga terreni pasi që informata zyrtare nuk kemi. Ofertuesit tjerë për shërbime të telekomunikacionit, janë të paraqitura në tabelat në vijim.

Telefonia mobile dhe fikse, përveç telekomit të lartcekur, ofrohet edhe nga IPKO dhe PTK. Kur bëhet fjalë për numrin e shfrytëzuesve të telefonisë fikse në IPKO është dy shfrytëzues, ndërsa PTK ka vetëm një. Sa i përket numrit të shfrytëzuesve të telefonisë mobile nuk kemi të dhëna zyrtare.

Është e nevojshme që të përmendet se secila lagje në komunë ka televizion kabllor ka por nuk ka të dhëna zyrtare. IPKO ka televizionin e vet kabllor që emiton rreth 70 programe, dhe jepen në gjuhën shqipe, serbe, angleze dhe turke.

2.5. Mjedisi, Resurset Natyror dhe Trashëgimia Kulturore

2.5.1. Resurset natyrore

Për komunën e Graçanicës mund të thuhet se është mjaft e pasur me resurse natyrore.

Liqeni i Graçanicës është akumulim artificial i ujit në lumin Graçanka, dy kilometra mbi Graçanicë, i ndërtuar që të furnizojë Prishtinën dhe rrethinën e saj me ujë. Një pjesë e liqenit të Graçanicës i takon komunës. Ndërtimi i liqenit të Graçanicës ka filluar në vitin 1963, ndërsa uji nga ai për në Prishtinë ka rrjedhur në verën e vitit 1966. Penda me një lartësi prej 52 m, gjerësi 246 m, është ndërtuar në ngushticën e Badovcit, nën malin e Androvaçës, në afërsi të minierës së Kishnicës. Liqeni është i gjatë 3,5 km, i gjerë deri 500 m, thellësia më e madhe është deri në 30 m, ndërsa vëllimi total i tij është 26 milion m³ ujë. Është i pasur me lloje të ndryshme të peshkut, kryesisht me krap dhe bërcak (klen).

Gjatë ndërtimit të tij janë shpërngulur banorët e fshatit serb Novosellë, në brezin e ujërave të liqenit dhe Badovci i Vjetër, nën pendë.



Figura 29- Liqeni Badovcit

Njëri ndër resurset e rëndësishme është edhe toka bujqësore e cila paraqet një peizazh të mrekullueshëm të komunës së Graçanicës.



Figura 30- Peizazhi bujqësor

2.5.2. Lumenjtë në territorin e komunës

Komuna e Graçanicës është e pasur me resurse ujore dhe përmes komunës kalojnë katër lumenj dhe një përrua: Graçanka, Sitnica, Prishtevka, Janjevka dhe përroi i Zhegovës.

Lumi **Graçanka** është lum në Kosovë i cila rrjedh afër manastirit të Graçanicës, Lapnasellës, Preocës, Dobrevës së Poshtme dhe derdhet në Sitnicë në dalje të Dobrevës së Poshtme. Buron krejt afër pendës së liqenit të Graçanicës dhe rrjedh afër deponisë minerare të minierës së Kishnicës. Kur nuk ka ekzistuar liqeni, Graçanka ka qenë më e pasur me ujë, si dhe janë derdhur në të lumenj të vegjël dhe përrenj nën fshatin Llabjan dhe Mramor. Gjatësia e këtij lumi është 18,50 km. Është rregulluar edhe një pjesë e shtratit të lumit Graçanka.



Figura 31- Lumi Graçanka



Figura 32- Lumi Sitnica

Lumi **Sitnica** është njëri ndër lumenjtë më të mëdhenj në Kosovë. Buron në pjesën juglindore të Kosovës në malin Zhegavc. Gjatësia e lumit është 90 km, derisa rrjedhja e tij në grykë është 9,5 m²/sek. Edhe pse lartësia mbidetare e pellgut është 1.000 m, Sitnica, duke rrjedhur përgjatë luginës së fushës së Kosovës, ka të gjitha vetitë e lumit fushor: rënie të vogël (0,76%) dhe shtrat të cekët dhe gjarpëror e në rastet e ngritjes së nivelit çdoherë del nga shtrati duke ndryshuar edhe shtratin e lumit.



Figura 33- Lumi Prishtevka në Uglarë

Lumi Prishtevka para 30 vitesh ka qenë lum i pastër. Sot, në gjithë rrjedhën e saj prej 15.43 km, është kolektor i ujërave të zeza i qytetit të Prishtinës, e cila kalon kah Uglari dhe derdhet në Sitnicë. Brigjet e lumit Prishtevka janë të parregulluara, me kaçuba të mëdha, shkurre dhe shelgje. Shtrati i lumit është plot me llum dhe përmbajtje të ujërave të zeza. Mbi lumin Prishtevka, në Uglar, është ndërtuar ura e cila ndalon rrjedhën u ujit, kështu që vërshime të shpeshta marrin objektet e banimit që gjenden në afërsi të urës.

Lumi Janjevka rrjedh nëpër Gushtericën e Epërme dhe të Poshtme. Janjevka gjatë periudhës së verës thahet, sidomos kur mbretërojnë temperaturat e larta, kështu që në shtratin e saj ujë ka vetëm në periudhën e dimrit.

Rrjedhat ujore:

Gjendja e cilësisë së ujit në komunën e Graçanicës është në gjendje të rëndë dhe kërkon intervenime të urgjente si dhe investime të konsiderueshme në infrastrukturë. Trashëgimia e industrisë së ndotur e cila nuk ka qenë e bazuar në zhvillim të qëndrueshëm por vetëm ka keqpërdorur pamëshirshëm resurset dhe drejtpërdrejt ka ndotur brutalisht dhe ka bërë degradimin e rrjedhave ujore në territorin e komunës së Graçanicës. Gjithashtu, shumica e amvisërive ujërat e zeza i derdhin në lum, derisa një numër i caktuar i tyre edhe në ujëra nëntokësore. Me rastin hartimit të kadastrit të ndotësve të komunës së Graçanicës, është e nevojshme që të bëhet pikë së pari kategorizimi i ndotësve, në ata kolektivë dhe individualë.

(Burimi: “Agjenda e gjelbër”, dokument nga komuna e Graçanicës)




Figura 34-Ndjeshmëria nëntokësore ndaj ndotjes (burimi: EULUP)

2.5.3. Pylltaria

Potenciali pyjor, në nivel të vendit është 41.8% përafërsisht rreth 455 000 ha. Pyjet në komunën e Graçanicës mbulojnë sipërfaqen prej 1300 ha, që përbën rreth 9.9% sipërfaqes së përgjithshme të territorit të komunës së Graçanicës. Lloji më i shpeshtë i drurit pyjor është pisha e bardhë dhe e zezë si dhe ahu.



Figura 35- Zona pyjore

2.5.4. Situata në mjedis

Gjendja në mjedisin e komunës së Graçanicës përcaktohet nga kushtet natyrore, struktura rurale, aktivitetet ekonomike, transporti dhe proceset e vazhdueshme socio-ekonomike.

Mesataren vjetore të përqendrimit të gazrave ndotës në ajër për vitin 2011 e kemi siguruar nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Stacioni për hulumtimin e cilësisë së ajrit gjendet në Prishtinë i cili mbulon sipërfaqen me diametër prej 10 km² (të dhënat: PM 10 -57,83 ng/m³; 3- 49,41 ng/m³; SO₂ – 19,6 ng/m³; CO 3784,55 ng/m³; NO₂- nuk ka të dhëna). Hulumtimet mbi ndotjen e ajrit dhe tokës në territorin e komunës nuk ka, por nga përvoja mund të konstatohet se ajri në Graçanicë është i ndotur nga deponia e mbeturinave nga minerare në Kishnicë. Gjithashtu, ndotësi më i madh i ajrit në tërë territorin e komunës vjen nga zhurma që shkaktohet nga trafiku që rrezikon banorët në zonat qendrore si dhe në brezat afër rrugëve magjistrale.

2.5.5. Ndotja

Ndotësit kolektiv- Sipas definicionit, janë të gjithë ata ndotës apo vendbanime që kanë më se 50 (pesëdhjetë) amvisëri, që kanë qasje të përbashkët në kanalizim apo gropë septike.

Numri më i madh i vendbanimeve me ujë të pijshëm furnizohen nga liqeni i Graçanicës, mirëpo fshatrat (Batusha, Radeva, Suvido, Skullaneva, Lepina), që gjithashtu gjenden në territorin e komunës së Graçanicës, me vjet të tëra furnizohen nga pusët si dhe burimet e afërta natyrore. Pusët në fshatra janë të lidhur me hidroforë, përmes së cilëve banorët përdorin ujin për qëllime të shumta. Hidroforët punojnë me energji elektrike, e pasi që janë shpeshuar edhe ndërprerjet e energjisë elektrike, banorët e këtyre vendbanimeve shpesh mbesin edhe pa ujë. Ky ujë, në përbërjen e tij ka edhe gëlqere, e në disa vende është edhe i papërshtatshëm për tu pirë, me çka edhe rrezikohet shëndeti i njerëzve. Në shumë fshatra ende ka gropa septike, të cilat rrezikojnë edhe ujin i dedikuar për nevojat e përditshme.

2.5.5.1. Ndotja e ujit

Ujërat e zeza të Graçanicës derdhen në gjashtë pranues të ndryshëm të ujërave. Më së shumti ujëra të zeza derdhen në Graçankë, Zhegovkë, përroi e Sushicës, Prishtevkë e në këtë mënyrë edhe në Sitnicë.

Vendbanimi	Lumi ku derdhen ujërat e zeza	A ekzistojnë kolektorë për pastrimin e ujërave të zeza?
Graçanicë, Lapnasellë, Preocë, Kishnicë	Graçankë	NO
Dobraqtin	Zhegovka	NO
Gushterica e Poshtme dhe e Epërme	Janjevkë	NO
Livadje	Përroi i Sushicës	NO
Uglar	PRISHTEVKË	NO
Lepinë, Radevë, Skulanevë, Suvido	Sitnicë	NO
Çagllavicë	Kanalet për ujitje, gropat septike	NO

Tabela 21- Paraqitja tabelore e ndotësve nga ujërat e zeza që derdhen në shtretër të lumenjve

Ndotësi më i madh individual i lumit Graçankë është miniera në Kishnicë. Deri në fund të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, seriozisht është kërcënuar cilësia e ujit të lumit Graçanka, gjatë derdhjes së pandërprerë të ujërave të mbetjeve industriale nga flotacioni i kësaj miniere. Sot, puna në këtë ndotës të madh momentalisht është ndërprerë.

Burim tjetër serioz i ndotjes është flotacioni i mbetjeve minerare që gjendet shumë afër shtratis të lumit dhe me shpëlarjen erozive një pjesë e madhe e llumit derdhet në lum.

Miniera në Kishnicë është pikë e zezë e rrjedhjes së ujërave që derdhen në Detin e Zi, që përmes lumit Sitnicë, Ibër dhe Moravë, sasi serioze të metaleve të rënda arrijnë në lumin Danub dhe në këtë mënyrë edhe në Detin e Zi. Për këtë gjë flet edhe një studim, i bërë në vitin jo të largët 1996, me titullin "Rimëkëmbja dhe rikuperimi i lumit Graçankë".

Tabela 22- Parametrat e cilësisë së ujit në lumenj që kalojnë nëpër komunën e Graçanicës (Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës)

Parametri	Lumi	SITNICA					PRISHTEVK A	GRAÇANKA
	Sampling Location	Babljak	Lipljan	Vragolija	Plemetina	Mitrovica	Bresje	Vragolija
SHBO ₅		2.695	1.43	4.34	3.8	4.49	18.43	6.92
Nitrates		1.091	2.289	3.545	4.93	11.0	10.84	2.9
Nitrite		0.057	0.445	0.296	0.37	0.681	0.279	0.167
Ammonia		0.58	3.834	1.474	4.46	2.124	22.473	2.416
P _{total} (poli+orto)		0.133	0.621	0.397	0.51	0.435	0.670	0.400

Sipas këtij studimi, i punuar me kërkesën e Ministrinë për mbrojtjen e ambientit të Republikës së Serbisë, konstatohet, në mes tjerash, se edhe lumi Ibër vazhdimisht ndotet me lëndë mbeturinash nga Kosova.

Si lumi PRISHTEVKË, ashtu edhe lumi Janjevkë, Zhegorovkë (i gjatë 14,28 km) dhe përroi i Sushicës përdoret si sistem kanalizimi për ujërat e zeza si dhe deponi për mbeturina për vendbanimet në Gushtericë të Epërme dhe të Poshtme si dhe Livaxhës, ashtu që si në fshat ashtu edhe përreth, gjatë ditëve të pranverës, verës dhe vjeshtës, ndjehet era e pakëndshme të ujërave nga kanalizimi. Parametrat e cilësisë së ujit në lumenj që rrjedhin nëpër komunën e Graçanicës në vitin 2008 dhe 2009.

Matjet e bëra nga Enti Hidrometeorologjik i Kosovës në 50 vendet ku janë bërë matjet në gjithë lumenjtë, janë shfrytëzuar që të fitohen parametrat fizikë dhe kimikë si në vijim: sipas rezultateve, asnjëri nga lumenjtë në Kosovë nuk plotësojnë standardet e BE-së kur vjen fjala për ngjyrën e ujit, sidomos në zonat rreth mesit dhe fundit, si rezultat i ujërave të mbeturinave industriale dhe derdhjes së kanalizimit (rreth 1500 l/s janë derdhur vetëm në pjesën lindore të Kosovës). Në bazë të matjeve, parametrat kimikë të cianidit, nitratis, zinkut dhe fenolit, kohë pas kohe janë të pranishëm në masë të madhe në krahasim me standardet e BE-së. Në bazë të këtyre analizave të bëra në lumenjtë në Kosovë, është konstatuar se vetëm lumi Sitnicë ka vlera që janë në nivel të rrezikshmërisë.

Ndotja e ujit është rritur për shkak të kanalizimit i cili derdhet në ujëra, hedhjes së mbeturinave, por edhe për shkak të shfrytëzimit të zallit dhe zhavorrit ku shpëlahet toka. Pajisje për përpunimin e ujërave të zeza të qytetit nuk ekziston në asnjërin prej vendbanimeve.

(Burimi: VSM për PZHK-në e Graçanicës)

2.5.5.2. Ndotja e ajrit dhe tokës

Përveç analizave të cilësisë së ajrit në stacionin në Prishtinë e cila mbulon sipërfaqen prej 10km², analizat mbi ndotjen e ajrit dhe tokës në territorin e komunës nuk ka, por nga përvoja e përditshme mund të konstatohet se edhe ajri edhe toka janë të ndotur nga mbeturinat e minierës në Kishnicë në pjesën qendrore, derisa në pjesën veriperëndimore nga mihjet sipërfaqësore të thëngjillit. Është e mundur që ka ndotje edhe gjatë kohës së bombardimeve, por komuna nuk ka të dhëna apo nuk ka qasje në këto të dhëna.

Problem i madh është edhe deponimi i mbeturinave mjekësore së bashku me mbeturinat tjera. Njëra ndër deponitë është edhe penda e mbeturinave minerare të xehe në Kishnicë. Kjo deponi është sfida kryesore e ambientit me të cilën komuna është duke u përballuar.

Tabela 23- Cilësia e ajrit nga të dhënat e stacionit në Prishtinë (Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës)

Periudha në vitin	PM ₁₀	3	SO ₂	CO	NO ₂
2011	µg/m ³	µg/m ³	µg/m ³	µg/m ³	µg/m ³
Janar					
Shkurt					
Mars	56	43,2	23,8	5049	
Prill	45,2	50,9	25	4834	
Maj	37,2	51,5	23,8	5049	
Qeshor	38,9	54,6	23,6	4889	
Korrik	78,6	53,3	26	5009	
Gusht	41,7	50,8	28,9	5249	
Shtator	52,3	64,7	10,7	1581	
Tetor	58,1	42,9	5,3	830	
Nëntor	112,5	32,8	9,3	1571	
Dhjetor	/	/	/	/	
Vlera mesatare vjetore	57,83	49,41	19,6	3784.55	Nr Të dhënat

2.5.6. Deponitë ilegale

Në rajonin e komunës së Graçanicës, ka shumë deponi ilegale, të cilat janë krijuar nga moskujdesja e njerëzve. Njëra ndër deponitë më të mëdha ilegale, është ajo afër mbetjeve minerare në Graçanicë. Edhe kjo, sikur edhe deponitë tjera të egra, rrezikojnë ambientin, pasi ndodhen afër vendbanimeve, kopshteve për fëmijë, shkollave, brigjeve të lumenjve, afër rrugëve etj. Drejtoria e shërbime publike, e cila është e autorizuar për të larguar deponitë të mbeturinave dhe bërllokut, gjegjësisht mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbra në territorin e komunës.



Figura 36- Deponitë ilegale

Drejtoria për urbanizëm, planifikim, kadastër dhe mbrojtje të ambientit të komunës së Graçanicës gjatë prillit, majit dhe gushtit të vitit 2011 ka bërë evidentimin e deponive të egra të mbeturinave dhe plehrave. Është konstatuar se vetëm në territorin e komunës janë njëzet e pesë (25) deponi të egra të cilat ndikojnë negativisht në shëndetin e banorëve të komunës së Graçanicës. Me qëllim të zgjidhjes së problemit të deponive të egra, shërbimi profesional ka përgatitur një plan detal veprimi për largimin e deponive ilegale.

Tabela 24- Lokacionet e deponive ilegale

Numri dhe emri i vendit në të cilën ndodhet deponia (1)	Madhësia e vlerësuar në m ² (2)	Mbeturinat e vlerësuara në m ³ (3)
1. Graçanicë a. Padalishtë	Përafërsisht 600 m²	180 m³
2. Lapnasellë a. Rruga për spital –tek hekurudha b. Tek SHF ”Miladin Mitić“		24 m³
3. Livaxhë a. Afër shkollës fillore b. Në hyrje të Livaxhës kah Gushterica e Poshtme		21,00 m³
4. Gushterica e Poshtme a. Përgjatë lumit, afër varrezave b. Jo larg fshatit, rrugës për Sllovi		100 m³
5. Dobratin a. Jashtë fshatit tek vendi i quajtur “rupe (gropat)”		35 m³
6. Gushterica e Epërme a. Rrugës për në Akllap b. Në hyrje të Gushtericës së Epërme drejt Gushtericës së Poshtme		56 m³
7. Çagllavicë a. Rrugës për Hajvali		28 m³
8. Preocë a. Tek qendra rinore		28 m³
9. Uglar a. Tek varrezat e reja b. Tek antena		40 m³
10. Batushë a. Në afërsi të varrezave		21,00 m³
11. Lepinë a. Tek hekurudha mes Lepinës dhe Preocës b. Në afërsi të SHF “Vuk Karadžić”	10,00 x 4,00 x 0,20 m 20,00 x 10,00 x ,030 m	28,00 m³
12. Skullanevë a. Tek terreni futbollistik afër lumit b. Nga ana e majtë e rrugës Skulanevë-Suhodoll	40,00 x 20 m x 0,40 m	35,00 m³
13. Suhodoll a. Tek varrezat b. Lagja e Re (tek hekurudha)	20,00 x 4,00 x 0,50 m 40 x 3,00 x 0,40	56,00 m³
14. Kishnicë Tre (3) deponi		100 m³
15. Radevë		14,00 m³
16. Deponia tek mbeturinat minerare në Graçanicë	100 m x 150 m x 2.5 m	37.500 m³

2.5.6.1. Deponia e hapur industriale e mbetjeve nga objekti për përpunimin e mineraleve



Figura 37- Lokaliteti i mbeturinave minerare në komunë

Mbeturinat minerare të Kishnicës paraqesin një katastrofë ekologjike në komunë dhe regjion si dhe kërcënim të vazhdueshëm të degradimit të ambientit jetësor. Kërcënimi për mjedisin reflektohet me ndotjen e rrjedhjes së ujërave, ajrit dhe tokës përreth.

Që nga vitit 1965, ndotja paraqet rrezik për rrjedhat ujore me erozionin e mbeturinave minerare, si dhe për ajrin nëpërmjet erërave që shpërndajnë pluhurit e mbeturinave minerare, por edhe tokës bujqësore në afërsi aty ku mblidhet pluhuri i hedhur. Erozioni është fenomen që shpesh haset tek mbeturinat minerare.

Në mesin e aksidenteve të përshkuara në raportin e komisionit ndërkombëtar mbi pendat e mëdha si dhe në programin të Kombeve të Bashkuara mbi mjedisin, janë regjistruar vetëm në dy aksidente në territorin e ish Jugosllavisë, dështimi i pendës së deponisë së mbeturinave minerare të minierës Brskovo të plumbit dhe të zinkut në Mojkovc (Mali i Zi) si dhe çrregullimin në shpatin e mbeturinave minerare të minierës në Kishnicë. Aksidenti është paraqitur në shtator të vitit 1988. godine, kur është bërë derdhja e ujit me vëllim prej 10.000 m³ sipër pendës së mbeturinave minerare. Ujërat e ndotura i kanë vërshuar arat dhe diku dhjetë shtëpi. Tej-shkarkimi ka ardhur si pasojë e pakujdesisë gjatë eksploatimit të mbeturinave minerare, ndërsa aksidenti në masë të madhe ka qenë i politizuar (RI, 1988).

2.5.7. Menaxhimi i vlerësimit të rrezikut të katastrofave (MVRK)

Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm është shumë e rëndësishme që të njihet niveli i rrezikut në bazë të rrezikshmërisë dhe ndjeshmërisë së zonës.

Vërshimet:

Në bazë të studimeve, Graçanica është pjesërisht e rrezikuar nga vërshimet, tërmetet, zjarret, erozioni, breshri si dhe transporti i materieve të rrezikshme. Zonat të cilat janë të rrezikuara nga vërshimet janë ato përgjatë lumit Sitnicë. Mbrojtëset e lumit janë të ngritura në të dy anët e lumit, megjithatë, kur bien shi i rreptë dhe gjatë si dhe kur shkrihet bora gjatë dimrit, uji kalon mbrojtëset. Lumenjtë e tjerë dhe përrrenjtë janë të ngushtë dhe kur hedhen mbeturinat shkaktohet vërshim. Uji atmosferik gjithashtu shkakton vërshime të rreptë në disa zona të rrafshëta.

Tërmetet:

Kosova gjendet në një zonë sizmike të lartë e cila është goditur nga tërmetet në të kaluarën, zonë e cila është goditur me tërmete autoktone që janë shkaktuar në thellësinë 15-20 km nën tokë. Struktura tektonike dhe epiqendrat e tërmeteve me fuqi prej $M > 4.0$ që kanë goditur Kosovën deri më 2009 janë të paraqitura në hartën e mëposhtme.




Figure 38- Harta sizmike-tektonike e Kosovës

Në bazë të hartave ekzistuese sizmike, tektonike dhe gjeologjike, Kosova është e ndarë në 6 zona sizmike. Prishtina është njëra nga këto zona dhe me një fuqi ($M_{max}=3.8$). Kësaj zone i takon edhe komuna e Graçanicës. Këto zona sizmike kanë shkaktuar edhe në kaluarën dhe mund të shkaktohen tërmete të fuqishme. Pa marrë parasysh faktin që Kosova gjendet në zonën sizmike, ndërtimi nuk është kontrolluar si duhet nëse ishte përfillur kodi sismik. Graçanica është afër lokalitetit arkeologjik Ulpiana dhe në bazë të informatave, Ulpiana është shkatërruar në vitin 515 të erës së re. Ky është fakti tjetër që tregon për ndjeshmërinë nga tërmetet (Burimi: Ulpiana (vendbanim antik) Prishtinë - Kosovë/UNMIK 2006).

Transporti i materieve të rrezikshme:

Territori i Graçanicës gjendet në zonën ku korridoret kryesore kalojnë nëpër territorin e saj. Transportimi i materieve të rrezikshme mund të shpie në katastrofë. Kontrollimi i drejtë me standardet gjegjëse do të shqyrtohet për t'i ofruar siguri qytetarëve.

Zjarret e pakontrolluara:

Zona pyjore është e rrezikuar nga zjarri gjatë sezonit të verës. Gjithashtu, fushat pas korjes së grurit, në shumë raste, digjen nga bujqit. Ky aktivitet gjatë sezonit të verës, në shumë raste, shkakton zjarr në afërsi të arave.

Erozioni:

Në bazë të vëzhgimeve nga analizat në terren si dhe hartave të marra nga EULUP-i, zona pyjore është e rrezikuar nga erozioni. Shkaktarët e erozionit janë shpyllëzimi dhe minierat në zonën e Jallovinës.

Stuhitë me breshër:

Gjatë sezonit të verës, stuhitë me breshër kanë shkaktuar dëme bujqësisë, kopshtarisë dhe shpesh edhe pemëtarisë. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e tokave bujqësore si dhe pemishteve në Graçanicë, breshëri konsiderohet si rrezik i cili mund të iu shkaktoj humbje të madhe ekonomike bujqve lokalë.

Bora e madhe:

Moti në Kosovë gjatë dimrit është shpesh i ashpër. Bora e madhe dhe dimri i ftohtë shkaktojnë probleme në lëvizjen e qytetarëve. Shtëpitë e punuara pa kullm të duhur, si dhe shtëpitë e vjetra u ekspozohen këtyre rreziqeve.

2.5.8. Frekutnetimi dhe zhurma në trafik

Ruga magjistrale Prishtinë- Gjilan në gjatësi prej 48 km ndikon pikë së pari në vendbanimet afër rrugës ku gjendet edhe manastiri i Graçanicës me emetime të vazhdueshme të vibrimeve, smogut dhe pluhurit, tymit, zhurmës. Matjet e bëra në periudhën 26 gusht- 05 shtator 2011 është konstatuar se niveli mesatar i zhurmës gjatë ditës është 78 dB, që për 13 dB është mbi nivelin e lejuar)

Tabela 25- Niveli i ngarkesës akustike në rrugën magjistrale Prishtinë- Gjilan i cili kalon në afërsi të manastirit

Vendi i matjes	Niveli mesatar i zhurmës/ ditën	Tejkalimi i nivelit të lejuar të zhurmës / ditën	Maja më e lartë e matjes së zhurmës	Niveli mesatar i zhurmës / natën	Tejkalimi i nivelit të lejuar të zhurmës / natën
Sheshi i Simonidës Vendi krejtësisht afër manastirit në Graçanicë	78 dB	13 dB	98 dB	67 dB	12 dB

Niveli i lejuar i zhurmës ditën- 65 dB

Niveli i lejuar i zhurmës natën- 55 dB, për zonën e vendbanimeve 45 dB

Vërejtje: mesatarja është fituar në bazë të 90 mostrave, ku vlerat e ditës janë sjellë prej 55 deri 98 dB derisa intervali më i shpejtë ka qenë prej 65 deri 84 dB, dhe tregon në nivel të lartë të tejkalimit të gjatë ditës.

Tabela 26- Frekuentimi në trafik në vendet relevante të matjes

Vendi i matjes	Automjetet	Autobusët	Traktorët	Kamionët	Motoçikletat
Sheshi i Simonidës	209	5	2	18	3
Vendi krejtësisht afër manastirit në Graçanicë	63	1	0	3	0

Lloji i automjetit– numri i automjeteve të kaluara gjatë intervalit prej 15 minutash (vlerat janë të shfaqura si mesatare e matjes gjatë ditës dhe natës)

2.5.9. Trashëgimia kulturore dhe natyrore

Komuna e Graçanicës është mjaft e pasur me trashëgimi kulturore- historike, e që janë arritjet e trashëguara nga të parët tanë dhe të cilat duhet t'i ruajmë dhe t'ia lejmë pasardhësve tanë. Në territor të komunës gjendet edhe një numër i konsiderueshëm i kishave dhe manastireve ortodokse serbe, e disa nga ato janë të ndërtuara nga sundësit serbë të mesjetës (manastiri Graçanica), e pastaj, këtu janë ndërtuar edhe shumë monumente kulturore- historike, e në territorin e saj gjendet edhe lokacioni i njohur arkeologjik Ulpiana.

Për shkak të numrit të madh të kishave dhe manastireve, monumenteve kulturore-historike, lokacioneve arkeologjike, që gjenden në zonën e komunës së Graçanicës, momentalisht vetëm manastiri i Graçanicës është i mbrojtur me zonat e veçanta të mbrojtura.

Kur është në pyetje mbrojtja e trashëgimisë kulturore, komuna e Graçanicës është duke punuar në atë që zonat rreth kishave, monumenteve historike dhe lokacioneve arkeologjike të jenë të mbrojtura.

Zona e veçantë e mbrojtur Graçanica

Në bazë të Ligjit mbi zonat e veçanta të mbrojtura, nr .03/L – 039 nga viti 2008, përveç rregullimit të rolit të kishës ortodokse serbe, aty theksohet se zona rreth manastirit të Graçanicës është njëra ndër zonat e mbrojtura. Gjithashtu, me ligj është definuar se çfarë janë zonat e mbrojtura dhe cilat aktivitete nuk janë të lejuara në këto zona.

Burimi: Ligji mbi Zonat e veçanta të mbrojtura nr. 03/L-039 nga viti 2008.

Neni 2. Zonat e veçanta të mbrojtura

“Zonë e Veçantë e Mbrojtur” do të jetë një zonë e përcaktuar me hartë, ose me një zonë të përcaktuar që rrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, tërësi, fshat, ose qendër historike të qytetit që mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historik, kulturor, arkitektural apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik.

Neni 3. Objektivat

Objektivat e Zonave të Veçanta të Mbrojtura janë:

- a) të sigurojnë ekzistencën dhe funksionimin paqësor të vendeve që do të mbrohen dhe të ruajnë mënyrën monastike të jetesës së klerikëve;
- b) të ruajnë karakterin dhe pamjen e vendeve që do të mbrohen, në veçanti, kontekstin historik, kulturor, arkitektural dhe arkeologjik, mjedisin natyror dhe kuadrin vizual estetik; dhe
- c) të parandalojnë zhvillimet e pafavorshme rreth vendeve që duhet të mbrohen, ndërkohë që sigurojnë kushtet më të mira të mundshme për zhvillimin e harmonizuar dhe të qëndrueshëm të komuniteteve që banojnë në zonat rreth këtyre vendeve duke rregulluar zhvillimin dhe aktivitetet e tjera.

Në numri të caktuar të manastireve, kishave dhe vendeve tjera fetare të kishës ortodokse serbe, si dhe vendeve tjera historike dhe kulturore me rëndësi të veçantë për bashkësinë e serbëve të Kosovës, me vendosjen e L Ligjit mbi zonat e veçanta të mbrojtura, do tu ofrohet mbrojtje e veçantë.

Gezimi i të drejtave pronësore në zonat e mbrojtura mund të jetë i kufizuar me ndalimin e çfarëdo lloj aktiviteti në këto zona:

- a) Ndërtimi apo zhvillimi industrial, siç është: mihja e resurseve minerare, ndërtimi i elektranave, rrjetit elektrike apo largpërçuesve, tjegullore apo fabrikë;
- b) Ndërtimi apo zhvillimi i strukturave tjera, siç janë ndërtimet që janë të nivelit më të lartë se manastiri, kisha apo ndonjë monumenti kulturor i cili duhet të mbrohet; përdorimi i materieve të rrezikshme gjatë çdo ndërtimi (përfshirë këtu edhe ndërtimi i objekteve të banimit); trasimi i rrugëve, pompave të benzinës dhe punëtori auto-mekanikësh; supermarkete, klube të natës e të tjera;
- c) Ndërtim publik apo zhvillim i cili shpie në prerjen e pyjeve në zonat pyjore.



Figura 39- Harta e zonës së veçantë të mbrojtur

2.5.10. Manastiri i Graçanicës

Manastiri i Graçanicës, është tempull i dedikuar Zonjës Mari (Assumption Mary), i cili gjendet në bregun e majtë të lumit Graçanka, në jug të Prishtinës. Është dhuratë nga mbreti Millutin, gruas së tij Simonidës dhe djalit Stefanit. I ngritur në vitin 1321 ka prona të dhuruara si dhe privilegje. Është ngritur në vendin e kishës së vjetër që dikur ka qenë selia e dioqezës së Lipjanit.



Figura 40.- Manastiri Gračanica shek. XIV

Gračanica është njëri ndër monumentet më të rëndësishme të kulturës së vjetër serbe. Njëri ndër margaritarët e artit serb të mesjetës, njëri ndër treguesit më të ndritshëm të kulturës së lartë të epokës së Nemanjiqëve si dhe mesjetës në përgjithësi.

Kisha e manastirit Gračanica është ndërtesë me pesë kupola, me bazë të një kryqi të formuar, dhe si e tillë i takon grupit të klasës së parë të krijimeve arkitektonike të kohës së vet. Narteksi është ndërtuar në fund të shekullit të 14-të në kohën e princ Lllazarit. Enterieri i manastirit është i zbukuruar me freska.

Manastiri gjendet në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s së bashku me tre kisha tjera të KOS-it³ i quajtur „Monumentet mesjetare në Kosovë“. UNESCO në vitin 2004 e ka përfshirë manastirin e Graçanicës në listën e trashëgimisë botërore të kulturës, ndërsa nga viti 2006 gjendet në listën e trashëgimisë së rrezikuar.

³ Kisha Ortodokse Serbe



Figura 41- Freska e mbretëreshës Simonida, shek. XIV



Figura 42- Freska e mbretit Millutin, shek. XIV

2.5.11. Ulpiana

Ulpiana (lat. *Ulpiana*) apo *Justiniana Sekunda* (lat. *Iustiana Secunda*) ka qenë qytet romak dhe i Bizantit të hershëm në krahinën Mezias së Epërme. Mbetjet e tij shtrihen në një sipërfaqe prej rreth 300 hektare perfshire tampon zonen prej 100 metrash; në zonën mes Prishtinës, Graçanicës dhe Lipjanit, me largësi prej vetëm 1 km nga manastiri i Graçanicës. Hulumtimet arkeologjike të lokalitetit kanë filluar në vitin 1954 dhe janë duke vazhduar, ndërsa gjetjet më të rëndësishme të deritashme janë koka e mermertë dhe stolitë e të ashtuquajturit *Varr gotik* të fibulës së praruar në formë kryqi.





Figura 43- Lokacioni arkeologjik brenda territorit të komunës së Graçanicës

Mbetjet nga Ulpiana romake dhe bizantine mbulojnë një sipërfaqe prej rreth 300 hektare përfshirë tamponen zonën prej 100 metrash; dhe gjendet në lokalitetin Gradina afër Graçanicës së sotme. Në këtë lokalitet shumë-shtresor është zbuluar shtresa kulturore prej 4t. Muret e qytetit romak formojnë një themel të një katërkëndëshi të parregullt. Në veri dhe perëndim të qytetit kanë ekzistuar edhe nekropolet, ndërsa në verilindje kastrumi me një bazë katrori. Themelimi i qytetit lidhet edhe me sundimin e Trajanit (98-118). Në fillim si vendbanim i vogël mineral që më vonë është rritur në qytet me statusin e municipiumit romak. Ulpiana herët është bërë seli e dioqezës- në tubimin në Serdicë në vitin 343 ka marrë pjesë edhe peshkopi i saj Makedonijus. Pas rimëkëmbjes së Justinianit kah mesi i shekullit VI, qyteti është quajtur Justiniana Secunda. Qyteti ishte shkatërruar në kohën e sulmeve avare-sllave në fund të shekullit VI dhe fillimin e shekullit VII. Me gërmimet arkeologjike me sondë, të filluara në vitin 1953 (të përcjella edhe me punët konservuese), janë zbuluar pjesët e Ulpianës antike: bazilikë nefi me kript në pjesën veriperëndimore të vendbanimit; mbetjet e dy termeve; pjesët e dyshemesë me mozaik të një ndërtese; pjesë nga stilobati i tempullit antik; porta e qytetit me kulla dhe fillimi i rrugës kryesore (cardo). Në nekropolin verior janë zbuluar muret e një varreze, përkujtim me një sarkofag të mermertë si dhe mbetjet e mozaikut të dyshemesë me nënshkrimin e donatorit.

(Burimi: Instituti i Arkeologjise i Kosoves)

Përveç Ulpianës e cili shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 300 ha, për rreth zonën e mbrojtur, në distancë prej 100 m, ekziston zona mbrojtëse (bazuar në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore br.02/L-88 nga viti 2006). Në zonën mbrojtëse dhe brenda perimetrit mbrojtës të qytetit të lashtë- lokacionit arkeologjik Ulpiana (Justiniana Secunda) është e sanksionuar me ligj, perkatesisht ndermerren masa ligjore të mbrojtjes (si edhe më parë deri me tani) për veprimtaritë e mëposhtme: gjate ndertimit të objekteve infrastrukturore (minierave) dhe ndermarrjeve të tjera të karakterit fizik. Çdo kompani duhet të ketë miratimin paraprak të lëshuar nga institucionet përgjegjëse IAK- MKRS, në bazë të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore.

Brenda territorit të Komunës së Graçanicës ekzistojnë edhe disa lokalitete potenciale dhe të evidentuara arkeologjike. Këto lokalitete gjenden në:

- Badoc, gjetje rasti të periudhës neolitike tek këmbët e digës (pendës) të liqenit të Badocit;
- Badoc, lokaliteti- Nekropoli Mesjetarë në Fushën e Badocit;
- Batusë, gjetje rasti e një mbishkrimi latin të periudhës romake;
- Dobratin, lokaliteti i periudhës romake 'Qeramidana';
- Graçanicë, lokaliteti neolitik, eneolitik dhe periudha e metaleve në 'Glladnicë';
- Llapllasellë, lokaliteti i periudhës romake 'Selishta';
- Livagjë, lokaliteti i periudhës romake 'Staraselishta';
- Gushtericë e Ulët, tek potesi 'çeshma romake' mendohet se gjenden gjurmë të ujësjellësit romak; Gushtericë e Ulët, në livadhet e këtij fshati mendohet se gjenden gjurmët e stacionit rrugor romak perandorak, Statio Herculana;
- Uglarë, pa u saktësuar se ku, në hapësirën në mes Uglarit dhe Çagllavicës mendohet se gjendet stacioni rrugor romak Viciano.

(Burimi: Instituti i Arkeologjise)

2.5.12. Ligatina e Hencit- Zone e Vecante e Mbrojtur e Zogjeve

Zona e Vecant e Zogjeve- Ligatina e Hencit, eshte marrur nen mbrojtje si teresi hapesine per shkak te vlerave dhe karakteristikave te vecanta natyrore si ornitologjike, ihtiologjike, hidrogeologjike, botanike dhe peisazhore.

Zona e vecant perfshine siperfaqen prej 109 ha 52 ari 35 m² dhe shtrihet ne territorin e komunave: Gracanice, Lipjan dhe Fushe Kosove.

(Burimi: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor)

2.5.13. Kishat dhe vendbanimet brenda Komunës së Graçanicës

Kisha e Shën Premtes, Llapnasellë: Fshat serb, 14 km në jug të Prishtinës në rrugën magjistrale Prishtinë-Shkup. Përmendet në Kartën e Graçanicës 1314-1316 si L'apov. Në fshat kanë ekzistuar mbetjet e kishës së vjetër mbi themelet e së cilës para Luftës së Dytë Botërore është ngritur kisha e re dhe e madhe e Shën Premtit (Premtes së Shenjtë), kushtuar asketes së krishterë Shën Premtit apo Parashqevisë

Kisha e Shën Lllazarit, Gushterice e Poshtme: Fshat serb, 5 km në verilindje të Lipjanit, është themeluar me ndarjen nga Gushterica e Epërme me dekret të të sulltan Mahmudit I (1729-1730).

Në vend të kishës së vjetër të Shën Jovanit nga viti 1901 deri në vitin 1910 është ndërtuar kisha e vjetër që iu ka dedikuar Shën Vitusit dhe princit Lllazarit. Në oborrin e kishës në atë kohë është ngritur shkolla e parë në këtë rajon, si njëra ndër ndërtesat më të bukura të asaj kohe të shkollave serbe.

Kisha e Shën Dhimitrit, Dobrotin: Në Dobrotin është tempulli i Shën Dhimitrit, i ngritur gjatë kohës së Turqisë. I futur nën dhë një metër e gjysmë dhe i rrethuar me rrethojë të larë , më shumë të përkujton në ndonjë shtëpi sesa në kishë.

Kisha e Shën Gregorit Hyjnorit, Livadje: Në gërmadhat e kishës së vjetër, fshatarët e kishës së vjetër në vitin 1935 kanë ngritur kishën që i dedikohet Shën Gregorit Hyjnorit.

Kisha e Shën Dhimitrit, Sushicë: Kisha ndodhet në fund të fshatit. Kisha e Shën Dhimitrit, e njohur me emrin „Manastiri i Markut“, është ngritur nga mbreti Vukashin (1366-1371), babai i princit Mark, me të bijtë, e cila i dedikohet Shën Dhimitrit. Për kishën e vjetër në Shushicë nuk ka shumë të dhëna të shkruara. Mbi themelet e vjetra në vitin 1992-1993 është ndërtuar dhe restauruar kisha.

Kisha e Tre Shenjtorëve, Skullanevë: Në Kartën e Graçanicës 1314-1316, përmendet si “mulliri i Skullanevës”. Në fshat ekziston edhe kisha e vjetër dhe varrezat e vjetra serbe.

Kisha e Dieles se Shenjtë, Batushë: Në fshat ka ekzistuar kisha e vjetër mbi themelet e së cilës është e ndërtuar e reja në vitin 1932.

Kisha e Dieles se Shenjtë, Gushterice e Epërme: Në fshat, afër lumit, janë themelet e kishës dedikuar Shën Ilisë dhe gërmadhat e kishës së Shën Preçishtës e rrethuar me varrezat e vjetra. Mbi themele është ngritur kisha e vogël e E dielës së Shenjtë.

Kisha e Shën Panteleut, Lepinë: Në katastrohun e Deviçit janë të shënuara vitet 1761, 1763, 1772 dhe 1776. Dhuruesit serbë nga “Lepena apo Lepina” në “Nurija e priftit Janko”. Në fshat ndodhet themelet e kishës së vogël dhe varrezat e vjetra të serbëve.

(Burimi: “Fondacioni Kosova, monumentet dhe tiparet e popullit serb”, Atanasije Jevtiq)




Figura 44- Kisha e Shën Llazarit, Gushterica e Poshtme



Figura 45- Kisha e Shën Dhimitrit, Sushice



Figura 46- Shën Panteleu, Lepinë



Figura 47- Kisha Tre Shenjëtorëve, Skulanëvë



Figura 48- Kisha e Javes se Shenjte, Batushe



Figura 49- Kisha e Dieles se Shenjtë, Gushterice e Eperme



Figura 50- Kisha e Shën Premtes, Lapnasellë



Figura 51- Kisha e Shën Gligorit Teologut, Livagje



Figura 52- Kisha Shën Dhimitri, Dobratin

2.6. Vlerësimi i Gjendjes Aktuale

Vlerësimi i komunës i bërë gjatë një takimi njëditor i ekipit komunal për planifikim me shoqërinë civile. Vlerësimi është bërë në fushat tematike të përcaktuara në profil. Janë përdorur teknika e SWOT analizës. Në vazhdim i'u paraqesim vlerësimin sipas fushave tematike, të përcjellë me analizë.

2.6.1. Infrastruktura Sociale, Strehimi dhe Demografia

PËRPARËSITË	DOBËSITË
<ol style="list-style-type: none"> 1. Popullata e re 2. Personel profesional 3. Popullatë multi-etnike, multi-kulturore 4. E mbuluar mirë me institucione shëndetësore, arsimore 5. Afria me kryeqytetin 6. Zona e biznesit 7. Terrene të hapura sportive 8. Zona të planifikuara banesore 9. Trashëgimi e pasur kulturore 10. Pozita gjeografike e komunës 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mungesa e kapaciteteve për akomodim 2. Mungesa e hapësirës për shërbime shëndetësore 3. Mungesa e hapësirës për shkollë të mesme 4. Mungesa e akomodimit për fëmijët pa përkujdesje 5. Mungesa e shtëpisë së sigurt 6. Mungesa e kapaciteteve hoteliere 7. Mungesa e institucioneve kulturore (Biblioteka, teatri, salla e filmit, qendra rinore) 8. Ekzistenca e vendbanimeve joformale
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i biznesit 2. Fondet dhe donacionet 3. Universiteti 4. Sektori i OJQ-ve 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Migrimi

2.6.2. Infrastruktura, Shërbimet Publike dhe Transporti

PËRPARËSITË	DOBËSITË
<ol style="list-style-type: none"> 1. Infrastruktura e re rrugore 2. Rregullimi i shtretërve të lumenjve 3. Sistemi i ujësjellësit në pjesën më të madhe të komunës 4. Rrjeti elektrik dhe i telefonisë në pjesën më të madhe të territorit 5. Afërsia e rrugëve kryesore (magjistrale dhe regjionale), hekurudhën dhe aeroportet 6. Bashkëpunim i mirë ndër-komunal 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Transporti nëpër qendrën e Graçanicës 2. Rrugët e pa-asfaltuara të qasjes në disa vendbanime 3. Furnizim i dobët me rrymë elektrike në periudhën e dimrit 4. Nuk ka regjistër të kadastrit nëntokësor 5. Mos mbulueshmëria e të gjitha vendbanimeve me rrjetin e ujësjellësit 6. Planifikimi dhe ndërtimi pa standarde 7. Mungesa e ndërmarrjeve publike 8. Mungesa e stacionit të autobusëve dhe jo-funksionimi i transportit publik në komunë 9. Mungesa e hapësirës për parking
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ol style="list-style-type: none"> 1. Rrafshinë (kushte të mira morfologjike) 2. Qasje në aeroport 3. Afërsia e kryeqytetit 4. Hekurudha 5. Shfrytëzimi gjegjësisht prodhimi i rrymës elektrike nga burimet e ripërtërishme 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Penda e rrezikuar për shkak të afërsisë me gurthyesin 2. Vërshimi i lumenjve gjatë periudhës së dimrit 3. Ngarkesa e tepruar mbi automjete të rrugë

2.6.3. Zhvillimi Ekonomik

PËRPARËSITË	DOBËSITË
<ol style="list-style-type: none"> 1. Zona industriale 2. Shpirti ndërmarrës (kooperativat e bujqve, blegtoria, pemëtaria) 3. Shpirti i ndërmarrësve të rinj është në nivel të lartë 4. Pasuria minerare (afatgjate) 5. Potenciali për zhvillimin e turizmit - arkeologjik, fetar, kulturor, rekreativ 6. Cilësia e tokës bujqësore 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Papunësia 2. Aktivitet prodhues (tregtia) 3. Mungesa e tregut për plasmanin e prodhimeve 4. Mungesa e kuadrit të kualifikuar në sektorin e arsimit dhe atij shëndetësor 5. Mosekzistimi i një parku biznesi 6. Investim i huaj i pamjaftueshëm
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i turizmit 2. Prodhimi dhe plasmani i prodhimeve bujqësore (rendimentit) 3. Rritja e shkallës së punësimit në turizëm, bujqësi etj. 4. Punëtori zejtare (suvenirë, argjendarë, këpucëtarë, punëdore...) 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Migrimi

2.6.4. Mjedi, Resurset Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore

PËRPARËSITË	DOBËSITË
<ol style="list-style-type: none"> 1. Pozita gjeografike 2. Manastiri i Graçanicës dhe kishat përreth 3. Ulpiana 4. Burimet natyrore - Çezmat 5. Liqeni 6. Monumentet kulturore 7. Lumenjtë 8. Hurdhë 9. Toka bujqësore 10. Mulliri i ujit? 11. Kuzhina tradicionale 12. Gjuetia dhe peshkataria 13. Pusi i Tinës 14. Miniera e Kishnicës 15. Kodra Veletin dhe Stezhavci 16. Afërsia e qytetit 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbrojtje e pamjaftueshme e trashëgimisë kulturore dhe natyrore 2. Deponitë e egra 3. Ndotja e ujit nga ujërat e zeza 4. Ndotja e ajrit, ujit, tokës nga mbeturinat minerare 5. Rrjedhat e parregulluara të ujit
MUNDËSITË	KËRCËNIMET
<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i turizmit kulturor, rural dhe atij rekreativ 2. Trashëgimia kulturore dhe natyrore 3. Pastrimi i deponive 4. Zhvillimi i bujqësisë 5. Riciklimi i mbeturinave 6. Sistemi për pastrimin e ujërave të zeza 7. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore 8. Prodhimi i ushqimit natyral dhe shtëpiak 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërtimi ilegal 2. Mungesa e mirëkuptimit mes përfaqësuesve të komunitetit rreth rëndësisë së ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore 3. Penda- çarjet në pendë 4. Mbetjet minerare 5. Deponitë ilegale 6. Vërshimet 7. Humbja e tokës bujqësore

2.7. Sfidat e Zhvillimore

Janë përcaktuar sfidat më prioritare sipas grupeve tematike në punëtori në të cilën kanë marrë pjesë ekipi komunal për planifikim, shoqëria civile dhe UN-Habitat-i. Ky kapitull shqyrton materialin nga punëtorja si dhe analizën e profilit.



2.7.1. Infrastruktura Sociale, Strehimi dhe Demografia

Komuna e sapoformuar pa infrastrukturë të trashëguar sociale, me numër të madh të popullatës së re si dhe kuadrit profesional në të gjitha fushat, ka nevojë që t'i zgjidh sfidat si në vazhdim:

Sfida 1: Është i nevojshëm sigurimi dhe avancimi i infrastrukturës shoqërore.

Si mundet që të kontribuohet në sigurimin e hapësirës për sektorët e: shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes sociale, kulturës dhe sportit dhe me atë edhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike në përmirësimin e shërbimeve në këto fusha?

Sfida 2: Kërkesa për kapacitete për banim është e lartë.

Si të sigurohen kapacitete për banim me qëllim të përmirësimit të standardit jetësor, duke pasur parasysh edhe për ambientin dhe trashëgiminë kulturore?

2.7.2. Infrastruktura, Transporti dhe Shërbimet Publike

Sfida 3: Kushtet për lëvizshmëri nuk janë në nivelin e kënaqshëm. Nuk ka transport publik dhe rrjedha e trafikut nëpërmes Graçanicës krijon zhurmë dhe shqetëson banorët.

Si mund të përmirësohet plani për lëvizshmëri?

Sfida 4: Të përshpejtohet zhvillimi i sistemit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike

Si mund të përmirësohet rrjeti ekzistues i infrastrukturës dhe shërbimeve dhe ofrimi i shërbimeve të reja aty ku është e nevojshme?

2.7.3. Zhvillim Ekonomik

Sfida 5: Niveli i ultë i aktivitetit prodhues:

- Ekonomi dhe bujqësi e zhvilluar jo sa duhet;
- Prodhim bujqësor joadekuat;
- Treg i pamjaftueshëm për plasmanin e prodhimeve;
- Shfrytëzimi jo i duhur i resurseve natyrore;
- Infrastrukturë jo sa duhet e zhvilluar (rrugë, ujësjellës, kanalizim, rrymë, internet);
- Nuk ekziston transporti publik.

Si mundemi që të rrisim nivelin e prodhimit në komunën tonë që të jetë i qëndrueshëm?

Komuna Graçanica është komunë rurale me kualitet të lartë të tokës bujqësore, dhe për këtë arsye duhet realisht që të bëhet planifikimi dhe shfrytëzimi sa më i mirë i tokës bujqësore.

Sfida 6: Zhvillimi i turizmit

Si mund ta zhvillojmë turizmin në komunën tonë?




Figura 53- Diagrami i zhvillimit të qëndrueshëm

2.7.4. Mjedisi, Resurset Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore

Sfida 7: Mbrojtje jo e duhur e të mirave kulturore dhe resurseve natyrore

Si mund të mbrohet me këtë plan, trashëgimia kulturore si dhe trashëgimia natyrore, e në të njëjtën kohë të shfrytëzohen për zhvillim ekonomik?

Sfida 8: Mbeturinat minerale dhe deponite ilegale- sipërfaqet e degraduara- nivel i lartë i ndotjes së ujit, tokës dhe ajrit

Si mundet që me plan zhvillimor të zgjidhen çështjet që kanë të bëjnë me ambientin jetësor?

2.8. Vlerësimi i Kapaciteteve të Komunës për Investime

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Graçanicës për vitin 2012 ka qenë 4,538,780.00 €, dhe nga kjo shumë 4,138,780.00€ financim përmes graveve qeveritare, derisa 400,000.00 € nga të ardhurat vetanake të planifikuara.

BUXHETI I PËRGJITHSHËM NDAHET NË:

- GRANTIN E PËRGJITHSHËM PËR ADMINISTRATË NË VLERË PREJ 1,746,282.00 €;
- GRANTI SPECIFIK PËR SHËNDETËSI NË VLERË PREJ 1,587,667.00 €;
- GRANTI SPECIFIK PËR ARSIM NË VLERË PREJ 1,204,830.00 €.




Figura 54- Buxheti i KK të Graçanicës për vitin 2011

Raporti për ekzekutimin e buxhetit për vitin 2011

Komuna me mjete të mira, të suksesshme dhe të menaxhuara mirë ka arritur që t'i shpenzojë të gjitha mjetet në dispozicion, si nga buxheti i planifikuar, ashtu edhe nga donacionet. Me menaxhim të duhur të buxhetit, janë realizuar të gjitha projektet e planifikuar të infrastrukturës, të gjitha obligimet e parashikuara me buxhet dhe me këtë u janë mundësuar qytetarëve të komunës kushte më të mira dhe më cilësore për jetë.

Na tabelat e bashkëngjitura mund të shihet se Komuna e Graçanicës ka pasur buxhetin e aprovuar prej 4,538,780.00 € dhe ai ekzekutiv është 5,671,059.27 €.

Tabela 27- Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit për vitin 2011

Pagesa				
Ndertesa	248,250.86	99,439.41	263,245.26	610,935.53
Ndërtim I Rrugeve	105,948.43	145,694.80		251,643.23
Sistemi I Kanalizimit	-	-		-
Furnizimi me Uje	-	-		-
Energjia Elektrike, Prodhimi, Transmetimi dhe Furnizimi	-	-		-
Pajisje me e shtrenjte se 1000 Euro	172,299.00	26,350.00		198,649.00
Automjete Transportuese	34,930.00	14,995.00		49,925.00
Makineri- Automjete	-	-		-
Tjera Kapitale	612,720.14	438,639.92	26,364.45	1,077,724.51
Toke	-	-		-
Asete te Paprekeshme	-	-		-
Tranferë Kapitale per Entitete Publike	-	-		-
Tranferë Kapitale per Entitete Jo-Publike	-	-		-
Vendime Gjyqesore	1,830.90	-		1,830.90
Total Pagesa	1,175,979.33	725,119.13	289,609.71	2,190,708.17

Nga tabela e bashkëngjitur mund të shihet se Komuna e Graçanicës për investime kapitale (ndërtim të rrugëve, pajisje, mjete transporti dhe kapitale tjera) ka shpenzuar 1,175,979.33 € nga grantet qeveritare dhe 725,119.13 € nga të hyrat vetanake.

Shuma prej 289,609.71 € është shumë që komuna e Graçanicës e ka fituar si donacion nga Qeveria e Shqipërisë dhe ajo shumë është shpenzuar për investime kapitale për realizimin e disa projekteve. Kështu që nga tabela e bashkëngjitur shihet se komuna e Graçanicës për vitin 2011 për investime kapitale ka shpenzuar në total 2,190,708.17 €.

Komuna e Graçanicës gjithashtu ka fituar donacione në kategorinë mallra dhe shërbime:

- Donacioni i Bankës Botërore në shumë prej 10,000.00 € për furnizim me pajisje shkollore;
- Donacioni i UNOPS-it në shumë prej 2,340.00 € për regjistrim të popullsisë.

Donacionet

Komuna e Graçanicës ka nënshkruar disa memorandume bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim si dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Komuna e Graçanicës në vitin 2010 ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me qeverinë e Shqipërisë dhe ka marrë një donacion prej 400,000.00 eurosh. Këto mjete kanë qenë të destinuara për realizimin e projekteve kapitale.

Komuna e Graçanicës përveç mjeteve të rregullta buxhetore ka fituar edhe disa grande dhe donacione tjera nga MPMS-ja dhe MKK⁴, ZKM⁵, MAPL, me një shumë totale prej 4.774.458,00 euro, të cilat janë shpenzuar për më se 50 projekte nga infrastruktura, realizimi i të cilave ka kontribuar në zhvillimin e një imazhi pozitiv të komunës.

Tabela 28- Buxheti sipas programeve 2011-2013

Buxheti 2011			
Programe –Donacionet (Grande)	Donacione qeveritare (Grande)	Të ardhura personale	Gjithsej
Administrata e përgjithshme *	1,346,282.00	400,000.00	1,746,282.00
Arsim	1,204,830.00	0	1,204,830.00
Shëndetësi	1,587,667.00	0	1,587,667.00
Gjithsej	4,138,779.00	0	4,538,779.00
Buxheti 2012			
Administrata e përgjithshme *	1,468,867.00	537,000.00	2,005,867.00
Arsim	1,562,103.00	0	1,562,103.00
Shëndetësi	1,410,500.00	0	1,410,500.00
Gjithsej	4,441,470.00	537,000.00	4,978,470.00
Buxheti 2013			
Administrata e përgjithshme *	1,468,867.00	537,000.00	2,005,867.00
Arsim	1,562,103.00	0	1,562,103.00
Shëndetësi	1,410,500.00	0	1,410,500.00
Gjithsej	4,441,470.00	537,000.00	4,978,470.00

⁴Ministria për Kthim dhe Komunitete

⁵Zyra për çështje të komuniteteve pranë kabinetit të Kryeministrit

Në bazë të të dhënave të paraqitura në tabelën 14, mund të vlerësohet vetëm buxheti komunal, derisa sektori privat apo ai publik si dhe donacionet mund të vlerësohen vetëm si përqindje e pjesëmarrjes mesatare në Kosovë (25%, 75%, 5%).

Për vitin 2012, Komuna e Graçanicës ka aprovuar një buxhet prej 4,978,470,00 €. Financim qeveritar (grandi) ka 4,441,470,00 €, derisa të hyrat vetanake të planifikuara janë 537,000.00€.




Figure 55- Grandet Qeveritare

Komuna e Graçanicës ka punësuar 529 punëtorë, për të gjitha programet.

Komuna grumbullon dhe merr të ardhura personale, duke përfshirë gjokat e trafikut, taksat administrative, taksat komunale, lëshimi i lejeve dhe tatimi në pronë. Grumbullimi i mjeteve nga këto të ardhura deri më tani ka qenë i kënaqshëm. Ka ekzistuar vetëm një rritje e kufizuar të të ardhurave personale, në krahasim me llojet tjera të të ardhurave, kështu që komuna ka qenë shumë e varur nga donacionet (grandet) nga niveli qendror. Punë e rëndësishme është bërë me zbatimin e sistemit të tatimit në pronë në komunë dhe kjo ka bërë që të rriten të ardhurat personale të komunës. Komuna pandërprerë ka kërkuar mënyra se si të i zgjeroj bazën e të ardhurave personale dhe të përmirësojë vjeljen e tyre. Burimi kryesor i të ardhurave personale të komunës është tatimi në pronë.

Tabela 29- Të ardhurat e KK në Graçanicë

Br.	Opis	Budzet 2009	Plan 2010	2011 Procena	2012 Procena	2013 Procena
618	Gračanica					
1	UKUPNI OPŠTINSKI PRIHODI	-	-	400,000	537,000	537,000
1.1	SOPSTVENI PRIHODI	-	-	400,000	537,000	537,000
1.1.1	Porez na imovinu			200,000	251,000	251,000
1.1.2	Opštinske takse	-	-	200,000	286,000	286,000
	Licence i dozvole			84,000	119,880	119,880
	Sertifikati i službena dokumenta			28,000	63,000	63,000
	Takse za motorne opreme			10,000	13,000	13,000
	Dozvole za izgradnju			8,000	15,120	15,120
	Ostale opštinske takse			70,000	75,000	75,000

Komuna e Graçanicës ka tejkaluar realizimin e planifikuar të të ardhurave për vitin 2011, nga 400,000.00 € sa ishin planifikuar, ka realizuar 1,121,553.64 €, e prej shumës së përgjithshme, vetëm 11,985.00 € është shuma e realizuar nga gjokat në trafik.

3. VIZIONI, PARIMET DHE OBJEKTIVAT

3.1. Vizioni për të Ardhmen e Komunës

Logoja e përbashkët mbi vizionin:



Deklarata e integruar mbi vizionin:

„Komuna e Graçanicës, e pasur me pasuri antike dhe mesjetare dhe bukuri natyrore me mjedis modern me ekonomi dhe infrastrukturë, ku çdokush gëzon liritë dhe të drejtat e barabarta.“

Me qëllim të integrimit të aspiratave dhe mendimit të shoqërisë civile si dhe personelit komunal në proces të planifikimit, kjo deklaratë për vizionin e cila ka ardhur nga punëtorja mbi vizionin i cili është mbajtur në Ohër, Maqedoni 25-29 nëntor 2010, që të bashku dhe me qasje pjesëmarrëse të zhvillohet vizioni i ardhshëm i zhvillimit komunal.



Gjatë punëtorisë së vizionimit, secili grup tematik është paraqitur me vizionin e saj të përcjell me moto, duke përfshirë edhe kartën dhe deklaratën e versionit të tyre. Motot e ardhshme janë:

- Komuna e Graçanicës e gjelbër- më e gjelbër, e vjetër-moderne, e shëndoshë dhe atraktive;
- Komuna e Graçanicës, e arritshme, atraktive dhe tradicionale;
- Komunë moderne me infrastrukturë dhe ekonomi të zhvilluar;
- Secila familje në shtëpinë e vet në kuadër të ambientit socio-urban.

Të gjitha motot e përmendura kanë rezultuar me një moto të përgjithshme dhe me një deklaratë të përbashkët ashtu siç është cekur më lart. Motoja e përbashkët është:

Moto:

“Manastiri i Graçanicës thesar botëror dhe perla jonë”

Rezultatet e punëtorisë së vizionimit do të përdoren si udhëzime për hartimin e PZHK-së dhe implementimin e procesit, ashtu që të transformohet ky vizion në realitet.



Vizioni i përfundimtar dhe i përbashkët paraqet komunën si moderne, urbane, ekonomikisht të fortë me një ambient të shëndoshë, me ekonomi të zhvilluar dhe trashëgimi të ruajtur kulturore.

3.2. Parimet e Përgjithshme për Zhvillim

Parimet e përgjithshme për zhvillim sigurojnë një kornizë të gjerë të udhëzimeve, që rrjedhin nga dokumenteve relevante dhe zhvillimore lokale, nacionale, evropiane dhe ndërkombëtare për planifikim:

- Ligji mbi planifikimin hapësinor;
- Parimet për zhvillimin e qëndrueshëm hapësinor nga perspektiva evropiane e zhvillimit hapësinor EU-ESDP;
- Parimet për zhvillim të qëndrueshëm- Agjenda 21;
- Parimet e menaxhimit të duhur urban- Programi i UN HABITAT-it;
- Parimet e vetëqeverisjes lokale dhe decentralizimit- Plani i Ahtisaarit.

Parimet dhe vlerat duhet të respektohen në të ardhmen. Parimet që plani zhvillimor i komunës së Graçanicës i ka përcaktuar si më të rëndësishmet që duhet të merren parasysh gjatë hartimit por edhe pas miratimit të planit janë:

- PZHK mbështet parimin e qasjes së integruar, duke përfshirë edhe elementet e infrastrukturës dhe transportit, zhvillimit ekonomik, social, elementet ekologjik si dhe politikat tjera strategjike për komunën;
- PZHK promovon interesat e përbashkëta të banorëve të Graçanicës me qëllim të rritjes së cilësisë së jetës dhe mirëqenies social.
- Plani bazohet në parimin e ofrimit të qasjes për të gjithë banorët në shkollë, shëndetësi dhe shërbime tjera shoqërore
- Promovimi dhe mbështetja e një zhvillimi të qëndrueshëm duke treguar kujdes gjatë shfrytëzimit të vlerave natyrore, historike dhe kulturore për zhvillim; ashtu që këto vlera të promovohen, por edhe të ruhen për gjeneratat e ardhshme;
- Promovimi i një ekonomie stabile që do të krijojë vende të reja të punës me të drejta të barabarta për banorët e Graçanicës
- Menaxhim i duhur që promovon pjesëmarrjen e publikut dhe përfshirjen në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, duke përfshirë grupe të ndryshme të interesit duke mos përjashtuar edhe kërkesat e grupeve të caktuara gjatë procesit; promovimin e transparencës gjatë planifikimit dhe barazisë duke marrë parasysh edhe barazinë gjinore dhe zgjidhjen e kërkesave të personave me nevoja të veçanta, të rinjve, grave, fëmijëve, pleqve, etj.
- Parimi i zëvendësimit, sipas të cilit plan duhet fokusuar në probleme lokale, por nuk do të duhej që të jetë në kundërshtim me çështjet e nivelit të lartë, komuna merr përgjegjësinë për realizimin e vendimit nga niveli qendror por edhe të merr vendime që mund të aplikohen lehtë edhe në nivelin lokal.
- PZHK-ja e Graçanicës i jep theks parimit të zhvillimit kompakt, sidomos në mjediset urbane, që hapësira të shfrytëzohet sa më racionalisht, por duke insistuar në ndarjen e barabartë të funksioneve themelore të zhvillimit të zonave rurale ashtu që të zhduken dallimet mes zonave rurale dhe atyre urbane;
- Zhvillimet e parapara në Planin Zhvillimor Komunal duhet që të kontribuojnë në procesin e integrimi evropiane.

3.3. Objektivat Afatgjata të Zhvillimit

Pjesë e përcaktimit të objektivave dhe detyrave, paraqet vazhdimi i vizionit. Në bazë të përparësive dhe të metave, si dhe duke marrë parasysh mundësinë dhe potencialin për zhvillim dhe sfidave zhvillimore, Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) për periudhën për të cilën hartohet ka përcaktuar objektivat sipas fushave tematike.

Plani Zhvillimor Komunal ka marrë parasysh edhe rekomandimet e përcaktuara në Planin Hapësinor të Kosovës Zona e Kaltër. Në qendër të zonës së kaltër parashihet Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës (TZhEK), e ashtuquajtura shtyllë e zhvillimit ekonomik me interes nacional, burim i të ardhurave për ekonominë e Kosovës, si dhe vend i përshtatshëm për investitorë të kompanive multinacionale. Arsyet për këtë orientim të zhvillimit të ardhshëm hapësinor të TZhEK-ut janë: 1) afërsia me qytetin e Prishtinës, si qendra më e madhe administrative, arsimore-shkencore dhe shërbyese në Kosovë, si vend atraktiv për investitorë vendorë dhe të huaj, por edhe për turizëm e kongreseve, 2) korridoret kryesore të infrastrukturës së rrugëve, hekurudhës, ajrit, telekomunikimit dhe energjetike, 3) aeroporti ndërkombëtar Prishtina, si pikë e ardhshme strategjike për lidhje me botën në fushën e transportit të udhëtarëve dhe mallrave, i dëshmuar si një e rëndësishme për zhvillim ekonomik, 4) afërsia e pozitës me korridoret regjionalë.

Dokumenti mbi vizionin e komunës së Graçanicës i cili është hartuar në vitin 2010, u jep rëndësi zhvillimit të bujqësisë dhe ekonomisë, zhvillimit të një komune moderne me infrastrukturë, ofrim të shërbimeve cilësore në kuadër të ambientit socio-urban menaxhim i duhur me mjedisin dhe resurset natyrore, si dhe zhvillim të resurseve njerëzore, duke përfshirë arsimin, trajnimin etj.

Moto e dokumentit „Hartimi i deklaratës mbi vizionin për Graçanicën“, sipas grupeve tematike është:

- Komuna e Graçanicës e gjelbër -më e gjelbër, e vjetër-moderne, shëndetshme dhe tërheqëse;
- Komuna e Graçanicës, e arritshme, atraktive dhe tradicionale;
- Komunë moderne me infrastrukturë dhe ekonomi të zhvilluar;
- Secila familje në shtëpinë e vet në kuadër të mjedisit socio-urban.

Objektivet dhe detyrat e caktuara me PZHK, përmes një procesi gjithëpërfshirës konsultativ, paraqesin një grumbull objektivash të caktuara në dokumentet e lartpërmendur dhe të theksuar nëpër zonat tematike të lartpërmendura dhe kanë urdhra nga zonat tematike: infrastruktura sociale, akomodimi dhe demografia; zhvillimi ekonomik; shërbimet publike, infrastruktura dhe transporti si dhe ambienti, resurset natyror dhe trashëgimia kulturore.

Në bazë të objektivave të përcaktuar gjatë vizionimit, në bazë të planeve zhvillimore të dala nga analiza e situatës, objektivat e caktuara janë përcaktuar për zhvillimin e komunës së Graçanicës sipas grupeve tematike:

3.3.1. Infrastruktura Sociale, Strehimi dhe Demografia (A)

AC1- Zgjerimi dhe ngritja e kapaciteteve për banim në nivel më të lartë në fushat e shëndetësisë, arsimit, shërbimeve shoqërore, kulturës, sportit dhe rekreacionit:

- AO1.1- Ngritja e kapaciteteve në fushën e shëndetësisë, arsimit, shërbimit social, kulturës dhe rekreacionit;
- AO1.2- Ofrimi i shërbimeve adekuate dhe cilësore.

AC2 - Përmirësimi i standardit jetësor të banorëve me planifikim të vendbanimeve të rregulluara dhe kapaciteteve për akomodim:

- AO2.1- Krijimi dhe trajtimi i vendbanimit duke respektuar ligjet relevante;
- AO2.2- Zgjerimi i kapaciteteve të banimit përmes ndërtimit të banesave kolektive dhe individuale.

3.3.2. Zhvillimi Ekonomik (B)

BC1- Avancimi i zhvillimit ekonomik përmes zhvillimit ekonomik, bujqësisë dhe turizmit:

- BO1.1- Arritja e prodhimit të qëndrueshëm në bujqësi;
- BO1.2- Sigurimi i tregut dhe qasja në plasman të prodhimit;
- BO1.3- Ngritja e vetëdijes për një bujqësi të qëndrueshme;
- BO1.4- Nxitja dhe hapja e bizneseve familjare;
- BO1.5- Parandalimi i shfrytëzimit të paligjshëm dhe eksploatimi i tokës bujqësore shoqërore;
- BO1.6- Zhvillimi dhe promovimi i turizmit lokal (atij kulturor, fetar, rural, dhe sportiv-rekreativ);
- BO1.7- Nxitja dhe zhvillimi i biznesit.

3.3.3. Shërbimet Publike, Infrastruktura dhe Transporti (C)

CC1-Përmirësimi i shërbimeve komunale:

- CO1.1- Mbulueshmëria e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit në tërë territorin e komunës;
- CO1.2- Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike si dhe furnizimin me energji elektrike;
- CO1.3- Mbulueshmëria e rrjetit të telekomunikacionit;
- CO1.4- Përmirësimi në menaxhim të mbeturinave të ngurta.

CC2-Përmirësimi i trafikut nëpër Komunën e Graçanicës:

- CO1.1- Të zvogëlohen ngecjet në trafik në qendrën e Graçanicës;
- CO1.2- Të përmirësohet trafiku për këmbësorë dhe biçikleta si dhe hapësirat publike;
- CO1.3- Formimi i korridoreve të gjelbra në komunë;
- CO1.4- Të përmirësohet rrjeti i rrugëve.

3.3.4. Mjedisi Jetësor, Resurset Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore (D)

DC1- Mbrojtja e ambientit jetësor dhe resurseve natyror:

- DO1.1- Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndikimet kimike (mjeteve agroteknike);
- DO1.2- Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimi jo i duhur;
- DO1.3- Pyllëzimi dhe parandalimi i prerjes ilegale të pyllit;
- DO1.4- Ngritja e vetëdijes mbi ekologjinë;
- DO1.5- Shfrytëzimi i burimeve me energji të ripërtërishme;
- DO1.6- Përmirësimi i cilësisë së ujit, ajrit dhe tokës përmes zgjidhjes së problemit të mbeturinave minerare dhe deponive jologjore.

DC2- Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore:

- DO2.1- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore (asaj arkitektonike, arkeologjike, peizazheve kulturore, trashëgimisë shpirtërore);
- DO2.2- Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore (materiale dhe jo-materiale).


DC3- Zvogëlimi i riskut dhe përmirësimi i menaxhimit të ndikimit negativ në mjedis dhe trashëgimia kulturore të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe aktivitetet njerëzore:

- DO3.1- Ngritja e vetëdijes dhe ngritja e kapaciteteve në trashëgiminë kulturore;
- DO3.2- Zvogëlimi i ndikimit negativ në mjedis në fushën e katastrofave të mundshme natyrore.


3.4. Prioritetet Strategjike

Ekipi komunal për planifikim, në bashkëpunim me Programin MuSPP, që zbatohen nga UN-Habitat-i dhe me qëllim të punës transparente dhe përfshirjes së qytetarëve në hartimin e PZHK-së, ka përgatitur anketën me titull „Objektivet për zhvillimin e komunës së Graçanicës“ me objektiva të lartpërmendur. Anketa është publikuar në ueb-faqet e komunës, si dhe në faqen e komunës në Facebook, nga maji deri në qershor 2012. Përveç qytetarëve, mundësinë për përcaktimin e prioriteteve e kanë shfrytëzuar edhe të punësuarit në komunën e Graçanicës, përfaqësuesit e sektorit civil, përfaqësuesit e biznesmenëve nga zona e biznesit dhe të tjerët.


Përcaktimi është bërë sipas fushave tematike prej më të lartës, në zonat e mesme dhe të ulëta. Rezultatet e kësaj ankete në detale janë paraqitur në grafikët si më poshtë.




A- Infrastruktura Sociale, Strehimi dhe Demografia



B- Zhvillimi Ekonomik



C- Shërbimet Publike, Infrastruktura dhe Transporti



D- Mjedisi, Resurset Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore

4. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL

PZHK ka kaluar nëpërmes një procesi interaktiv në të cilin profesionistët dhe personeli në komunë kanë zhvilluar tre alternative të mundshme të zhvillimit. Në këto sesione, pjesëmarrësit kanë punuar në hartat duke paraqitur gjendjen aktuale dhe zhvillimin e mëvonshëm.

4.1. Karakteristikat e skenarit të zhvillimit

4.1.1. Skenari i zhvillimit sipas trendit

- Zona shumë të mëdha të rrezikuara nga zgjerimi urban;
- Zona shumë të mëdha për zhvillim në tokën e cila nuk është e përshtatshme për ndërtim, apo mbi tokën cilësore bujqësore;
- Shfrytëzimi i tokës, promovimi i shfrytëzimit të përzier në kuadër të "qasjes realiste" e cila përmban trendin aktual;
- Inkurajon shfrytëzimin maksimal të rrugëve ekzistuese kryesore dhe rrugëve transitore;
- Sa i përket shfrytëzimit të tokës, zhvillimi do të jetë intensiv, që do të bëjë të mundur që investimet në transportin publik dhe hapësirën për banim të jenë të realizueshme;
- Kujdes i është kushtuar rritjes së prodhimtarisë dhe shpenzimit;
- Kujdes i është kushtuar edhe mbrojtjes së mjedisit;
- Shërbimet të orientuara kryesisht përgjatë korridorit (drejtimeve rrugore);

Përshkrim i skenarit të zhvillimit sipas trendit

Është propozuar:

- Në bazë të trendëve ekzistuese të zhvillimit, konsiderohet se në të ardhmen vendbanimet fqinje do të bashkohen;
- Të vërtetohet mundësia e zvogëlimit të madhësisë së lokalitetit Ulpiana në të ardhmen;
- Kryesisht janë propozuar objekte individuale banesore, përveç në Graçanicë ku janë propozuar objekte kolektive banesore;
- Planifikimi dhe ndërtimi i një rruge transite që të anashkalohen ngecjet dhe zhurma në qendër të Graçanicës në periudhën e caktuar;
- Duke pasur parasysh që në pjesën perëndimore, aktivitet kryesor i fshatit është blegtoria dhe bujqësia, është propozuar që ata të vazhdojnë aktivitetin e tyre dhe të zhvillohen edhe më tutje;
- Zhvillimi i transportit publik i cili lidh të gjitha vendbanimet;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në pjesën perëndimore të komunës, pasi që qytetarët furnizohen nga puset private. Sistemi i furnizimit me ujë pjesërisht do të furnizohej nga liqeni i Graçanicës;
- Studimi i kapacitetit të ujërave nëntokësore për furnizim të 5 fshatrave -pjesa perëndimore (SuviDo, Radevë, Skullanevë, Lepinë dhe Batushë)
- Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë dhe biçiklistë aty ku është e mundur;
- Ndërtimi i deponisë së mbeturinave të ngurta në afërsi të deponisë së minierës në Kishnicë;
- Ndërtimi i stacioneve hekurudhore (në Lepinë, Llapnasellë dhe Kishnicë) si dhe rihapja e linjës hekurudhore për udhëtarët si dhe vizitës së lokacioneve me vlerë kulturore;
- Ndërtimi i stacioneve pritëse për autobusë në Preocë;
- Ndërtimi i stacionit për riciklim dhe ndarjen e mbeturinave
- Ndërtimi i varrezës së kafshëve në Gushtericë e Poshtme
- Ndërtimi i sistemit për ujëra të zeza në mbarime të rrjedhjes së lumenjve– kolektorë kanalizimi;
- Ndërtimi i xhamisë në Kishnicë
- Zonat e mbrojtura speciale rreth kishës në Dobratin, Llapnasellë, Gushtericë e Poshtme;
- Deponia (e përkohshme) e planifikuar për deponimin e mbeturinave medicinale në afërsi të spitalit.



Vërejtjet:

- Skenari i trendeve është skenar ku nuk punohet asgjë në aspektin e planifikimit. Prapëseprapë, ky skenar përmban disa elemente planifikimit që mundësojnë mbrojtjen e tokave bujqësore.
- Përcaktimi i zonës urbane të vendbanimit Marigona, që në të ardhmen synon që të zgjerohet dhe shkurtimi i rrugës deri tek aeroporti, pasi që zhvillimi veçse ka filluar
- Zgjerimi i mëtutjeshëm i vendbanimit Marigona duhet parandaluar në të ardhmen
- Gjithashtu, trendi i blerjes së tokës së fshatrave parëndimore nga ana e Aeroportit Prishtina mund të paraqet rrezik në të ardhmen
- Është iniciuar çështja e konsolidimit /ri-parcelizimit të tokës
- Pas bisedimeve me ekspertin e VSM-së, është paraqitur ideja që prapë të aktivizohet linja hekurudhore dhe të ndërtohen stacionet pritëse për autobusë dhe hekurudhë dhe të gjithë vizitorëve të sigurohen biçikletat për vozitje dhe shijimin e peizazhit të komunës.
- Shtigjet e planifikuara për këmbësorë dhe biçikleta do të ndikojnë në zvogëlimin e emetimit të CO2
- Është planifikuar sistemi i ri për menaxhimin e mbeturinave të ngurta
- Respektimi i baseneve të lumit dhe fshatrave si dhe sistemet e planifikuara për përpunimin e ujërave të zeza.
- Toka dhe infrastruktura- koncentrimi i zonave të reja, zvogëlimi i shfrytëzimit të tokës
- Kultura dhe ekonomia- ngritja e vetëdijes mbi rëndësinë e zhvillimit ekonomik dhe kulturës.

Përparësitë:	Konfliktet:
<ul style="list-style-type: none"> • Shfrytëzimi i përzier i tokës, stacionet e autobusëve, shtigjet për biçikletë (pjesa që ka të bëjë me transportin publik, shumë pozitiv) 	<ul style="list-style-type: none"> • Shfrytëzimi i tokës dhe Banesave (Si një zgjidhje e mundshme për përqendrimin e zonave të reja të banimit, ndërtesat shumëkatëshe) • Kultura dhe ekonomia

4.1.2. Skenari i zhvillimit të koncentruar

- Inkurajimi i rehabilitimit dhe /apo ripërdorimit të strukturave ekzistuese
- Përqendrimi në mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese (rrugët, furnizimi me ujë, kanalizimi, etj.)
- Promovimi i zhvillimit të ri në zonat ka veçse ekziston infrastruktura rrugore dhe shërbimet publike
- Ruajtja e tokës bujqësore dhe ndërmarrjeve bujqësore, sidomos në rajonet rurale
- Rritja e mundësisë për transport publik dhe lëvizshmëri (ecje, vozitje, biçiklizëm, tren, autobus etj.), por edhe për transport individual;
- Inkurajimi i zhvillimit rreth ndërtesave ekzistuese që janë të rëndësishme për komunën
- Inkurajimi i rehabilitimit të hapësirave boshe /të pashfrytëzuara dhe zonave të braktisura industriale
- Inkurajimi për të përdorur energji eficiente nëpër ndërtesa
- Mirëmbajtja dhe zgjerimi i parqeve, zonave natyrore dhe shërbimeve rekreative
- Inkurajimi i banimit cilësor dhe real
- Qytetet/qendrat të mbështeten me funksionin e tyre sikur motorë të zhvillimit ekonomik dhe kulturor
- Infrastruktura është e përqendruar dhe e shfrytëzuar optimalisht
- Ekzistimi i kontrastit të zhvillimit të peizazhit mes zonave të qytetit dhe atyre të fshatit

Përshkrimi i skenarit sipas zhvillimit të koncentruar

Është propozuar:

- Mbrojtja e tokës bujqësore
- Ruajtja e kontekstit rural
- Ruajtja e peizazheve rurale (turizmi)
- Futja e linjës hekurudhore (krijimi i korridoreve të gjelbra)
- Drejtimi i ri i transportit në drejtim të aeroportit
- Rajoni për zgjerimin e vendbanimeve
- Definimi i zonës së vendbanimeve
- Turizmi (etno hoteli-sinergji me trashëgimi kulturore)
- Promovimi i ushqimit organik
- Rruga transit rreth Graçanicës (duhet pasur parasysh rrezikun potencial për zonën urbane)
- Hoteli turistik -në afërsi të pusit tek lokacioni arkeologjik Ulpiana
- Theksimi në bujqësinë ekstensive, konservimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore
- Ndërtimi i brezit të gjelbër dhe shtigjeve për biçikleta përgjatë rrugës së re dhe futja në funksion e linjës hekurudhore
- Deponia në Preocë
- Këshilli për hulumtimin e qëndrueshmërisë financiare, gjegjësisht jo-qëndrueshmërisë së rrugës së re.



Vërejtjet:

- Rruga e re afër linjës hekurudhore paraqet rrezik potencial që të fillohet ndërtimi i objekteve komerciale përgjatë rrugës.
- Kur bie fjala për Preocën, kjo tokë komunale është planifikuar për ndërtimin e një inkubatori të biznesit për shkak të terrenit të rrafshët dhe tokës së mirë, do të ishte dëm që aty të deponohen mbeturinat, me çka edhe do të rrezikohet edhe vetë vendbanimi.
- Nuk duhet planifikuar asgjë në afërsi të kufijve komunalë
- Në ushtrimin e raporteve ndër-sektoriale, anëtarët e grupeve tjera kanë konsideruar se marrëdhënia mes shfrytëzimit të tokës dhe banorëve nuk është edhe aq negative ashtu siç e ka etiketuar ky grup, por do të duhej të jetë i mesëm. Raporti në mes të mjedisit dhe resurseve natyrore sipas infrastrukturës, transportit dhe mobilitetit duhet të jetë negativ.

Përparësitë:	Konfliktet:
<ul style="list-style-type: none"> • Shfrytëzimi i përzier i tokës, stacionet e autobusëve, shtigjet për biçikletë (pjesa që ka të bëjë me transportin publik, shumë pozitiv) • Mbrojtja e tokës së mirë bujqësore • Prezantimi dhe rimëkëmbja e linjës hekurudhore • Rrugët e transportit publik • Zgjerimi i vendbanimeve • Zona e Etno- Hotelit • Promovimi i bujqësisë organike • Transiti (të marrë parasysh rrezikun për zonën urbane) 	<ul style="list-style-type: none"> • Rruga e cila është planifikuar të lidhë Graçanicën me Aeroportin duhet të zhvillohet vetëm si një rrugë lokale me bimësi përgjatë saj, sepse në të kundërtën ajo mund të zgjerohet dhe kështu toka bujqësore në të cilën është vënë theksi në këtë skenar nuk do të ruhet.

4.1.3. Skenari i zhvillimit të decentralizuar

- Zhvillimi i decentralizimit dobëson qendrën ekzistuese të qytetit
- Zhvillimi fokusohet në shumë pika të shfrytëzimit efikas të tokës dhe resurseve tjera
- Qyteti dhe shumica e pjesëve të fshatrave janë të furnizuar me shërbime,
- Pjesë të mëdha të rrafshëve mund të shfrytëzohen për bujqësi,
- Distanca të shkurtra brenda komunës,
- Trafiku ndër urban është ç'vendosur jashtë qytetit të Graçanicës
- Pjesët e largëta të fshatrave nuk janë të zhvilluara

Përshkrimi i skenarit të zhvillimit të decentralizimit

Është propozuar:

- Qendra të mbetet lagje e Graçanicës
- Nën-qendrat:
 - Gushterica e Poshtme (mini qendra Dobrotin, Livaxhë, Gushterica e Epërme)
 - Lepinë-Skulanevë (për fshatrat Suhodoll, Radevë, Batushë)
- Zgjerimi i fshatit Graçanicë deri tek Sushica dhe në drejtim të veriut (ndërtimi i objekteve kolektive).
- Ndërtimi i një rruge transit rreth Graçanicës. Nga drejtimi i Prishtinës që ndahet nga Hajvalia dhe prapë kthehet në fshatin Mramor.
- Rruga e re: drejtimi nga rruga magjistrale (i cili të dërgon në Lipjan) në drejtim të rrugës Lepinë-Preocë.
- Lidhja më e shpejtë deri tek aeroporti, rruga ekzistuese bujqësore.
- Vënia në funksion e linjës ekzistuese hekurudhore Lepinë-Preocë e cila mund të shfrytëzohet edhe për qëllime turistike (Ulpiana, vend-pikniku „Kroi“).
- Ndërtimi i tregut për plasmanin e prodhimeve në fshat si dhe në Llapnasellë dhe Lepinë.
- Ndërtimi i zonës për inkubator biznesi në zonën në drejtim të Uglarit.
- Ndërtimi i sedimentuesit në Preocë dhe Graçanicë.
- Ndërtimi i deponisë në drejtim të Gushtericës së Epërme në drejtim të Janjevës.
- Stacioni i autobusëve në rrugën Llapnasellë -Livaxhë (në hyrje të Llapnasellës).
- Stacioni hekurudhor në Suvido (aty ka pasur edhe më herët ndalesë treni).
- Ngushtimi i zonës së mbrojtur rreth vendit arkeologjik Ulpiana, por me mundësi të hulumtimit të mëtejshëm.
- Ngushtimi i zonës së mbrojtur speciale Graçanica.
- Gjelbërimi i minierës dhe krijimi i zonës për rekreacion.
- Zona sportive-rekreative në periferi të Llapnasellës kah Livaxha.
- Qendra e artizanateve në Graçanicë (rreth kroit të qytetit) dhe në Gushtericë të Poshtme.
- Krijimi i korridoreve të gjelbra përgjatë rrugëve aty ku ekziston mundësia.
- Planifikimi i zonës afariste në regjionin prej rrugës magjistrale deri tek rruga Llapnasellë -Livaxhë, afër vendit të quajtur „Potok“, i cili është duke u zgjeruar
- Zona e biznesit përgjatë rrugës magjistrale Prishtinë-Shkup dhe Prishtinë -Lipjan.
- Mundësia e ndërtimit të industrisë së lehtë në Suvido.
- Vendet turistike: vend-pikniku „Kroi“ dhe lokacioni arkeologjik "Ulpiana".
- Hurdha e Radevës.



Vërejtjet:

- Gjatë planifikimit dhe ndërtimit të rrugëve të reja kërkohet hartimi i vlerësimit strategjik të ndikimit në mjedis.
- Deponitë: zgjidhje më e mirë (për shkak të vëllimit të mbeturinave) është që të mbulohen me objekte riciklimi dhe secili vend të mbulohet me këtë lloj shërbimi. Pajisjet për riciklim duhet të kombinohet me sedimentim. Materiali i sedimentuar mund të shfrytëzohet edhe si burim energjie.
- Të i'u lehen inkubatorët e biznesit pronarëve privatë të tokave, ndërsa toka komunale (pasi që edhe nuk ka shumë) të shfrytëzohet për shërbime publike. Përveç asaj ata edhe do të paguajnë tatim komunës.
- Brezi rreth përroskës (Livadje) e cila ndikohet nga aktiviteti ekonomik, me synim që të ruhet (mos lejimi i zgjerimit) cilësia e mirë e tokës bujqësore.
- Kufizimi i zgjerimit të Graçanicës në drejtim të Sushicës nga të gjitha anët.
- Nëse inkubatori i biznesit ndërtohet në periferi të Preocës në drejtim të Uglarit, ekziston rrezik i madh që të humbet toka bujqësore (afërsia e Çagllavicës së zhvilluar).
- Për këtë skenar decentralizimi nevojitet kontrollim i zhvillimit, që të kufizohet në vetëm një vend.
- A mundet hekurudha të shfrytëzohet për qëllime turistike?
- Shikoni mundësinë e konsolidimit të tokës!
- Të merret parasysh rritja e numrit të banorëve /sa sipërfaqe toke nevojiten për planifikimin e vendbanimeve të reja.
- Në afërsi të zgjerimit të planifikuar të lagjeve në Graçanicë në drejtim të veriut, ekziston një gurthyes, ndërsa toka është e kryqëzuar me kanale të minierës. Që të parandalohen rrëshqitjet, është e nevojshme që të bëhet një studim fizibiliteti para se vendbanimi të zgjerohet.
- Rrugët e reja shkurtojnë distancën dhe kursejnë kohë, por varen nga vlerësimet e ndikimit strategjik në mjedis,
- Komuna duhet që të sigurojë përqindje të caktuar të hapësirës së gjelbër për secilën parcelë afariste.
- Ideja e mirë është që të shfrytëzohet toka komunale për rekreacion.

Përparësitë:	Konfliktet:
<ul style="list-style-type: none"> • Eko-rrjeti është më i zhvilluari • Dy zona kryesore të gjelbërimit, një në afërsi të liqenit në veri dhe një tjetër në pjesën jug-lindore 	<ul style="list-style-type: none"> • Rrugët e reja – subjekt i VNM-së • Parku i Biznesit- i mirë për zhvillimin, por mund të ndryshojë karakterin e mjedisit nga zona rurale në atë urbane

4.2. Vlerësimi i skenarëve të zhvillimit

Pas zhvillimit të skenarëve në mënyrë interaktive, EPK-ja së bashku me konsulentin për VSM-të ka zhvilluar një mini-punëtori. Në këtë punëtori, secili skenar është vlerësuar me metodën e matricës, në të cilën është vlerësuar marrëdhënia në mes të përcaktuesve të planifikimit dhe objektivave të VSM-së. Secili skenar krijon një kornizë të zhvillimit mbi modele të ndryshme të shfrytëzimit të tokës dhe mundësive të zhvillimit ekonomik. Në linjat vijuese këto skenarë janë përshkruar dhe testuar sa i përket zbatimit të parimeve të qëndrueshmërisë dhe objektivave mjedisore.

Komentet e skenarëve të trendit nga këndvështrimi i VSM-së janë prezantuar si vijojnë:

1. Bashkimi i vendbanimeve është realitet megjithëse mund të rezultojë me zgjerim, me humbje të tokës kualitative bujqësore dhe me mundësi të humbjes së biodiversitetit nuk mund të parandalohet. Zbutja e tij është e mundshme duke përcaktuar qartë kufijtë për zgjerimin e vendbanimeve dhe duke e mbajtur densitetin e popullsisë brenda niveleve ekzistuese si dhe duke vendosur kufijtë për lartësinë e shtëpive/ndërtesave dhe duke e përcaktuar një përqindje minimale të gjelbërimit në kuadër të bllokut urban.
2. Infrastruktura e transportit natyrisht se tërheq biznese pasi që ato kërkojnë furnizim dhe shpërndarje të mallrave, rrugë, furnizim me ujë, kanalizimin e ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike dhe sistemet e deponimit, si dhe energji. VSM-ja do të sugjeronte një mbulim të plotë të zonave të biznesit me infrastrukturën e nevojshme teknike (një sistem i brendshëm dhe sisteme të tjera të shpërndarjes së energjisë etj) infrastrukturën mjedisore (pellgjet e sendimentimit, brezave të gjelbër përgjatë rrugëve publike etj.) në zonat e lartpërmendura për të zbutur ndikimin e ndërlidhur me shëndetin dhe me mjedisin.
3. Kufizimi për përcaktimin e zonave të banimit në tokat bujqësore është në të njëjtën linjë me objektivat e VSM-së. Përcaktimi i zonave të banimit do të jetë i kufizuar, gjë që do të mbroj tokën bujqësore nga degradimi i mëtejshëm.
4. Rruga transite që dërgon jashtë Graçanicës mund të jetë tërheqëse për aktivitete afariste apo të banimit dhe mund të rezultojë me zgjerim. Planifikuesit duhet ta kenë parasysh gjatë përcaktimit të kufijve për zhvillimin e ardhshëm të qendrës komunale; përveç kësaj, çfarëdo zhvillimi i pakontrolluar i tokës, qoftë për aktivitete të afarizmit apo të banimit, duhet të jetë rreptësisht i ndaluar.
5. Transporti i propozuar urban mund të marr formën e një skeme ndër-modale. Përbëhet nga kombinimi i mënyrave të transportit të cilat janë në dispozicion (hekurudhor, autobusët) duke përfshirë gjithashtu përcaktimin e kryqëzimeve të transportit (kalimi nga një mënyrë e transportit publike tek një tjetër). Deri tani stacionet pritëse të hekurudhës të planifikuara në Lepinjë, Llapllasellë dhe Kishnicë mund të kombinohen me stacione pritëse për autobus. Si alternativë, stacionet e planifikuara të hekurudhës mund të mbeten në Lepinë dhe Kishnicë, ndërsa në vend të asaj në udhëkryqin në Llapllasell mund të planifikohet një ndërlidhje për kalim nga transporti hekurudhor në atë tokësor. Meqenëse shtigjet e çiklizmit gjithashtu janë të planifikuara në kuadër të këtij skenari, pikat për marrjen e biçikletave me qira mund të planifikohen në kryqëzimet e transportimit.
6. Me këtë VSM propozohet që të futen praktikat më të mira bujqësore (PMB) në parcelat e rregulluara të tokës. Përveç kësaj, për të mbrojtur përdorimin bujqësor të tokës janë paraparë teknika tradicionale të përdorimit të tokës.
7. Koncepti i propozuar i furnizimit me ujë është në përputhje me objektivat e VSM-së;
8. Deponia e propozuar për mbeturinat e ngurta duhet të jetë në përputhje me Direktivën 1999/31/EC dhe për këtë nuk duhet të pranoj mbeturina të cilat rrjedhin në tokë si rezultat i dekompozimit të ndonjë materiali;
9. Çelësi për veprime të shëndosha me mbeturinat mjekësore, përveç vendosjes së infrastrukturës së përshtatshme teknike, është edhe përmirësimi i kapaciteteve të veprimit (në ndarje të mbeturinave, paketimin dhe trajtimin brenda dhe jashtë premisave të spitalit – mbledhja, ruajtja e përkohshme, transportimi dhe trajtimi përfundimtar) si dhe mirëmbajtja e rregullt e objekteve.
10. Afër çfarëdo fabrike të biomasës, panelet foto-voltaike (PV) mund të instalohen që të përkrahin prodhimin e energjisë së ndërtesave publike (komunës, shkollave etj) dhe private (për ndërtesa të larta dhe shtëpi të veçanta si dhe qendra industriale) si dhe për ndriçim publik. Gjithashtu mund të realizohen mullinj të me erë në parcelat e konsoliduara të tokës. Integrimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë (BRE) në rrjetin ekzistues të elektricitetit është në linjë me qëllimin e BE-së për reduktimin e gazit që shkakton efektin e gazit serrë; megjithatë, mund të ketë pengesa ligjore, institucionale dhe teknike që kërkojnë vështrime të detajuara.
11. Plani i rregullt për Trajtimin e Ujërave të Zeza mund të jetë një zgjidhje e kushtueshme për komunën e Graçanicës. Prandaj propozohet që të analizohet mundësia e përdorimit të lagunave inxhinierike për trajtimin e ujërave të zeza komunale. Për qendrat industriale procedurat e Parandalimit dhe Kontrollimi i Integruar i Ndotjes (IPPC) duhet të zbatohen në mënyrë që të parandaloj çfarëdo shkarkimi të ujit të ndotur në rrjedha ujore.
12. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore është plotësisht në linjë me objektivat e VSM-së;

Komentet për skenarin e përqendruar nga këndvështrimi i VSM-së janë prezantuar si vijon:

1. Përqendrimi i shërbimeve publike në pjesën qendrore të komunës nuk e favorizon një zhvillim të balancuar. Shpërndarja e arsimit primar, shëndetësisë, sportit, telekomunikimit dhe shërbimeve komunale (ujit dhe mbeturinave) do të parandalonte shpopullimin e fshatrave aktualisht të pazhvilluar. Duhet të krijohet një pamje krejtësisht e re e vendbanimeve për të siguruar cilësi të barabartë të jetës në secilën pjesë të komunës.
2. Komentimet në lidhje me transportin publik të shprehura për skenarin “trendi” janë të vlefshme;
3. E njëjta vlen për rrugën transite;
4. Restaurimi i planifikuar i rrjeteve ekologjike është duke e fuqizuar biodiversitetin dhe peizazhin, prandaj mund të zbatohen dhe zhvillohen skenarë si masa lehtësuese që e shoqërojnë infrastrukturën e transportit dhe /apo rregullimin e lumenjve.
5. Në lidhje me kornizën e re kombëtare të transportit sipas të cilës autostrada kalon në territorin e komunës së Graçanicës, proceset e VNM-së duhet të zbatohen në mënyrë që të parandalojnë apo lehtësojnë ndikimet e ndërlidhura mjedisore dhe rreziqet të cilat sigurisht se do të dalin dhe do të kenë përmasa më të mëdha se çfarëdo aktiviteti afarist lokal.
6. Bujqësia organike mund të zbatohet vetëm aty ku plehrat minerale dhe pesticidet janë përdorur në sasi të limituara. Certifikatat dhe stimulimet e tjera do të duhet të prezantohen për t'i kompensuar prodhuesit bujqësor të cilët vendosin të aplikojnë praktikën më të mira bujqësore. Eko-turizmi është një aktivitet i ri turistik dhe ndërmarrësit e interesuar duhet të trajnohen në mënyrë që të projektojnë produktet e tyre dhe marketingun.
7. Zona turistike e planifikuar për shumë-qëllime (duke përfshirë një Etno-hotel) në afërsi të Ulpianës mund të ketë një efekt të mirë ekonomik. Megjithatë, ky projekt duhet të dizajnohet me kujdes dhe të shoqërohet me një VNM.
8. Deponia për mbeturinat komunale nuk është e nevojshme për komunën e Graçanicës. Mund të planifikohet vetëm një deponi për mbeturinat inerte. Mbeturinat e mbledhura komunale në këtë territor duhet të ndahen në artikujt (letra, plastika, metali dhe qelqi) që duhet të përgatiten për riciklim. Në këtë mënyrë mund të arrihet reduktimi i sasisë së mbeturinave për transport në deponit regjionale.
9. Furnizimi i përmirësuar me ujë dhe sanitari është në përputhje me objektivat e VSM-së;

Komentet e të përgjithshme më poshtë rrjedhin nga vlerësimi mjedisor i planifikimit të skenarëve alternativë:

1. Të gjitha planet pasuese dhe projektet e veçanta të investimit duhet të priorizohen dhe të testohen me objektivat mjedisore përgjatë proceseve të VSM-së dhe VNM-së;
2. Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të jetë i nevojshëm gjatë zhvillimit të planeve urbane të nivelit më të ulët; Kjo mundësi duhet të shqyrtohet nga stafi komunal në konsultim me MASHT-in para se të iniciojnë çfarëdo dokumenti të planifikimit urban; Kjo është pjesërisht e vërtetë për planifikimin e ndonjë zgjerimi të vendbanimeve dhe organizimi të zonave të reja të biznesit në mënyrë që të parandalojë konvertimin e tokës së kualitetit të lartë bujqësor, të intensifikojë erozionin, të rrezikojë cilësinë e mjedisit dhe stabilitetin e tokës, si dhe të shkaktojë rreziqe të padëshiruara mjedisore, sociale dhe të shëndetit publik.
3. Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor duhet të ndërmerret për korridoret e reja të transportit dhe industrisë, në përputhje me Direktivat e VNM-së dhe anekset e sajë;
4. Zonat e dedikuara për zhvillim të biznesit duhet të jenë të organizuara afër vendbanimeve që të përdorin infrastrukturën ekzistuese dhe të përdorin tokën bujqësore; shtrirja e zonës afariste përgjatë korridoreve të transportit e bënë zhvillimin e infrastrukturës jo-efikas dhe për këtë arsye të shtrenjtë; Tokat e pakta në pronësi publike nuk duhet të përdoren për përdorim komercial – duhet të shndërrohen në lehtësi publike dhe në shërbime të tjera për përfitim të gjithë komunitetit;
5. Një rrjet i fuqishëm ekologjik do të përparojë biodiversitetin, të mirëmbajë cilësinë e ujit dhe të kontribuojë pozitivisht në të dyja – në zbutjen dhe adaptimin e ndryshimit të klimës.

Pikat kryesore te forta dhe të dobëta për te gjitha skenaret e zhvillimit

Si zona për studim të mëtejshëm të përbashkëta për të gjithë skenarët janë identifikuar të jenë:

- Menaxhimi i mbeturinave
- Kapacitetet e ujit

Pas këtij vlerësimi, skenari i trendit u zgjodh që të zhvillohet në kombinim me disa elemente nga secili skenar.

Skenari i integruar (i propozuar) morri në konsideratë fuqizimin e tre skenarëve, analizoi konfliktet në mes të sektorëve, dhe u mundua të fuqizoi marrëdhëniet e mesme si dhe për të zbutur konfliktet.

4.3. Koncepti i skenarit të integruar

Bazuar në skenarët e zhvilluar (trendi, të koncentruar dhe të decentralizuar), u arrit në përfundimi që të mbahet skenari i trendit me disa pjesë nga skenari i koncentruar dhe ai i decentralizuar. Skenari i integruar (propozuar) do të jetë bazë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor në komunë.

Skenari i koncentruar përbëhet nga:

Qendra kryesore:

- Graçanica- të gjitha vendbanimet gravitojnë në atë drejtim;

Nën-qendrat:

- Llaplasellë (për vendbanimet Preovcë dhe Çagllavicë)
- Gushterica e Poshtme (për vendbanimet Livadje, Gushterica e Epërme dhe Dobratin)
- Lepinë (për vendbanimet Skulalnevë, Suvido, Radevë, Batushë)

Bazuar në trendët ekzistues të zhvillimit konsiderohet se në të ardhmen vendbanimet do të zgjerohen në mënyrë qendrore (siç ka qenë rasti në të kaluarën) dhe se disa vendbanime do të bashkohen me njëra-tjetrën. Zgjerimi i vendbanimit të Graçanicës shkon në drejtim të vendbanimit të Badovcit dhe Shushicës (banim individual) dhe në drejtim të veriut ku kompleksi i banimit kolektiv tashmë është zhvilluar. Bashkimi i këtyre vendbanimeve është i planifikuar, megjithëse mund të thuhet se këto vendbanime tashmë janë të bashkuara.




Figure 56- Harta e Skenarit të Integruar

Zgjerimi i Llapnasellës është planifikuar të jetë qendror, dhe kryesisht është planifikuar banimi individual. Gjithashtu, në Llapnasellë ekziston kompleksi i ndërtuar i banimit kolektiv, ku është e mundur të parashihen ndërtesat kolektive, varësisht nga hapësira në dispozicion. Ky vendbanim është i lidhur me vendbanimin e Çagllavicës në veri dhe me vendbanimin e Prekovcit në Perëndim.

Zgjerimi i vendbanimit të Çagllavicës është planifikuar të jetë qendror dhe vetëm për banim individual. Vendbanimet Gushterica e Poshtme dhe Gushterica e Epërme zgjerohen në mënyrë qendrore, por gjithashtu në linjë me rrugën Lipjan- Gushterica e Poshtme- Janjevë. Mund të thuhet se këto dy vendbanime tashmë janë të bashkuara. Banimi individual është i planifikuar.

Zgjerimi i vendimeve Lepina dhe Skulanevo është planifikuar të zhvillohet në mënyrë qendrore. Është planifikuar banimi individual dhe këto vendbanime gravitojnë në drejtim të bashkimit në të ardhmen. Vendbanimet për të cilat është paraparë zgjerimi qendror dhe të cilat nuk janë të bashkuara me njëra tjetrën janë vendbanimet e Batusës, Radevosë, Livadjes, Dobrotinit dhe Uglarit.

- Transiti i ri është planifikuar në mënyrë që të bëhet:
 - Reduktimi i bllokimeve të trafikut në vendbanimin Graçanicës,
 - Krijimi i zonës së këmbësorëve që do të jetë periodikisht e mbyllur për trafikun në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e jetës shoqërore dhe të inkurajoj zhvillimin e turizmit,
 - Të krijoj sheshin linear,
 - Mbrojtja e manastirit mesjetar të Graçanicës.
- Zhvillimi i transportit publik që lidh të gjitha vendbanimet.
- Përmirësimi i rrugëve me profil adekuat, shtigjeve të këmbësorëve, dhe ku është e mundur ndërtimi i shtigjeve të çiklizmit.
- Krijimi i korridoreve të gjelbra përgjatë shtretërve të lumenjve dhe rrugëve, aty ku është e mundur.
- Ndërtimi i sistemit për furnizim me ujë dhe sistemit të kanalizimit për pjesën perëndimore të Komunës në mënyrë që të parandaloj furnizimin me ujë nga pusët private.
- Është e nevojshme të shtjellohet Studimi i ujërave nëntokësore për 5 vendbanimet - pjesën perëndimore (Suhadolli, Skulaneva, Lepina dhe Batusha).
- Ndërtimi i sistemit të trajtimit të ujërave të zeza – kolektorët e kanalizimeve;
- Ndërtimi i ujitësve në Prekoc dhe Graçanicë.
- Stacioni i autobusëve është planifikuar në Graçanicë, dhe stacionet e autobusëve janë planifikuar në të gjitha vendbanimet.
- Ndërtimi i satcionit hekurudhorë në Suvido (që ka ekzistuar para luftës).
- Zona komunale afariste është krijuar përgjatë autostradës Prishtinë-Shkup dhe Prishtinë-Lipjan. Zgjerimi i zonës së biznesit është planifikuar vetëm përgjatë rrugës, siç edhe ishte rasti. Në pjesën perëndimore të komunës me vendbanimet si Lepina, Radeva, Skulaneva, Batusha, Suvido dhe Lagja e re, ku kryesisht ekzistojnë blegtoria dhe bujqësia, është sugjeruar të vazhdohet me këto aktivitetet dhe të siguroj ndihmë për zhvillimin e mëtejshëm.
- Ekziston mundësia të ndërtohet një zonë e re afariste në Suvido- industria e lehtë e bujqësisë dhe prodhimet ushqimore.
- Ndërtimi i inkubatorit afarist është planifikuar në periferi të Prekocit dhe në drejtim të Uglarit.
- Tregu për plasim të prodhimeve duhet të planifikohet.
- Është e nevojshme të zhvillohet një studim kërkues për zonën arkeologjike të Ulpianës në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Institutit Arkeologjik dhe për të shqyrtuar nëse ekziston mundësia për të zvogëluar zonën mbrojtëse që rrethon zonën arkeologjike Ulpiana.
- Ndërtimi i hotelit turistik Etno në afërsi të fontanës pranë zonës arkeologjike Ulpiana
- Ndërtimi i varrezave të reja në Graçanicë
- Ndërtimi i xhamisë në Shushicë
- Ndërtimi i tregut të gjelbër në Graçanicë
- Plani / ofrimi i një vendi për depozitimin e mbetjeve të ndërtimit
- Ndërtimi i varrezave të bagëtisë në Gushtericën e poshtme
- Rigjallërimi dhe mbrojtja e hurdhavetë peshkut në Radevë
- Depot për depozitimin e përkohshëm të mbeturinave mjekësore janë planifikuar në Badoc, ku ndërtimi i spitalit ka filluar
- Shkolla fillore në Graçanicë -Renovimi apo ndërtimi i shkollës së re të mesme
- Përmirësimi i shkollës në Llaplasellë apo ndërtimi i shkollës së re të mesme
- Ndërtimi i stacionit të zjarrfikësve në Llaplasellë ose Lepinë
- Ndërtimi i stacionit policor në Lepinë
- Rindërtimi i shtëpisë së kulturës, zhvendosja e shtëpisë së shëndetit dhe ndërtimin e shtëpisë së re shëndetësore në Llapnasellë
- Ndërtimi i objekteve sportive në mes Llapnasellë dhe Livadijes
- Zhvillimi i gjuetisë dhe peshkatarisë
- Ndërtimi i fabrikës së biomasës në Suvido (përdorimi i burimeve të energjisë së ripërtërishme)
- Zhvillimi i pemishteve
- Zhvillimi i bletarisë
- Zhvillimi i turizmit rural
- Rehabilitimi i mbetjeve nga gërmimet përmes mbjelljeve dhe pyllëzimit

4.4. Struktura e Kornizes Zhvillimore

4.4.1. Infrastruktura Sociale, Banimi dhe Demografia

4.4.1.1. Banimi dhe vendbanimet

Analizat e gjendjes aktuale në lidhje me zgjerimin tregojnë se vendbanimet kryesisht zgjerohen në mënyrë qendrore. Lëvizjet e ndryshme të popullsisë të shkaktuara në mënyra të ndryshme të zhvillimit të vendbanimeve.

Për qendrën kryesore komunale dhe për nën-qendrën, zhvillimi i planeve rregulluese urbane është propozuar. Para se të zhvillohet PRrU-ja, duhet të përdoren harta e zonimit dhe tabela e rregullimit.

Kufijtë e zgjerimit të vendbanimeve dhe qëllimet e shfrytëzimit të tokës (zonimi)

Kur përcaktoi kufijtë ardhshëm, grupi kyç i EPK-së është udhëhequr nga Plani i Rregullimit i vitit 1987 dhe trendët zhvillimorë të vendbanimeve në vitet e fundit. Gjithashtu, faktorë të rëndësishëm ishin migrimi si edhe rritja natyrore e popullsisë së komunës.

Vendbanimi i Graçanicës:

Që nga themelimi i Komunës dhe emërtimi si qendër komunale, janë përballur me problemin e mundësive për zgjerimin e vendbanimit.

Pjesa më e madhe e vendbanimeve gjenden në zonën e veçantë të mbrojtur nën mbrojtjen e UNESCO-së të Manastirit të Graçanicës, që edhe ka kushtëzuar lartësinë dhe mënyrën e ndërtimit të ndërtesave të ardhshme. Në përfundim, shtrirja është e kufizuar për shkak të ekzistencës së zonës arkeologjike Ulpiana. Në kushte të tilla, shtrirja e vendbanimit spontanisht ka marrë drejtimin drejt Badovcit dhe Shushicës (banim individual) dhe në drejtim të Padalishtës (banim kolektiv).

Në bazë të trendëve ekzistuese të zgjerimit, zgjerim në të ardhmen në drejtim të Badovcit dhe Shushicës ishte planifikuar, si dhe bashkimi i tyre.

Vendbanimi i Llapnasellës:

Ka lokacion shumë të mirë për banim, si në aspektin shoqëror edhe në atë ekonomik. Aty është autostrada Prishtinë-Shkup në afërsi të vendbanimit ku ndërtimi i objekteve të afarizmit dhe zhvillimi i biznesit janë të lejuar.

Ky vendbanim zgjerohet në mënyrë qendrore në drejtim të Çagllavicës në veri, në drejtim të Prekovcit në përfundim dhe në drejtim të Livadjesë në juglindje.

Zgjerimi në drejtim të Graçanicës në lindje është e kufizuar për shkak të ekzistencës së zonës arkeologjike Ulpiana. Në pjesën e vendbanimit në drejtim të Çagllavicës, zona e biznesit është në zhvillim e sipër dhe bashkimi i ardhshëm i këtyre vendbanimeve është planifikuar.

Duke marrë parasysh ekzistimin e autostradës Prishtinë- Shkup, në drejtim të fshatit Prekoc është planifikuar banimi individual derisa të përcaktohen perimetri dhe objektet afariste përgjatë rrugës. Vendbanimet tashmë janë të bashkuara.

Në juglindje, në drejtim të fshatit Livadje, salla e sporteve është në ndërtim e sipër, që edhe e ka kushtëzuar shtrirjen e vendbanimit në këtë drejtim (banimi individual dhe lokalet afariste). Në kuadër të vendbanimeve ka disa ndërtesa kolektive ku, varësisht nga hapësira në dispozicion, mund të planifikohen ndërtesa të reja kolektive.

Për shkak të vendndodhjes dhe mundësisë për zhvillim, është planifikuar që Llapnasella të bëhet nën-qendër për vendbanimet Prekoc, Çagllavicë dhe Uglarë.

Vendbanim Çagllavicë:

Me territor pjesërisht i takon Komunës së Graçanicës, kryesisht pjesë e fshatit në pjesën lindore të autostradës Prishtinë- Shkup. Kjo pjesë e shtrirjes së vendbanimit në mënyrë qendrore, në veri në drejtim të Prishtinës, në lindje në drejtim të Ajvalisë, dhe në jug është e bashkuar me Llapllasellën.

Pjesa veriore e vendbanimit që zgjerohet në drejtim të Prishtinës me banim individual është përcaktuar të jetë vendbanim. Në pjesë të vendbanimit në drejtim të Llapllasellës ekziston një zonë afariste që është në zhvillim e sipër, dhe bashkimi i këtyre vendbanimeve është i planifikuar. Pjesë të vendbanimit përgjatë autostradës Prishtinë- Shkup ofron mundësi për zhvillim ekonomik.

Vendbanimi Preoc:

Ka gjithashtu një lokacion të mirë për zhvillim ekonomik. Ka afër autostradën Prishtinë-Shkup përgjatë të cilës ndërtimi i lokaleve afariste dhe zhvillimi i biznesit është i lejuar.

Kjo shtrirje e vendbanimeve është qendrore ashtu siç është planifikuar, ku banimi individual është i lejuar. Në veri shtrirja është duke u bërë në drejtim të Uglarit, por është e kufizuar, në mënyrë që të ruaj tokën e kualitetit të lartë. Në perëndim vendbanimi është i bashkuar me Llapnasellën përmes zonës afariste.

Në pjesën jugperëndimore të vendbanimit ekziston një vendbanim Marigona, ku mbizotëron banimi individual.

Vendbanimi i Uglarit:

Lokacioni i kushtëzon ndërtimin në drejtim të Fushë-Kosovës. Në pjesën lindore të këtij vendbanimit është një vendbanim- Emshiri me banim individual.

Në kuadër të qendrës së vendbanimit ekziston një strehim i përkohshëm që mund të mbyllet dhe banorëve të t`ju sigurohet banimi adekuat përmes ndërtimit të objekteve të banimit individual.

Vendbanimet Radevë, Skullanevë dhe Batushë:

Nuk kanë tendenca të shtrirjes. Ata përdorin shërbime nga Lepina e cila në mënyrë funksionale lidhë këto vendbanime. Nëse ka nevojë, ekziston mundësia e zgjerimit të banimit individual.

Vendbanimi Lepina:

Falë vendndodhjes së saj, është planifikuar si nën-qendër për vendbanimet në Radevë, Skullanevë, Batushë dhe Suvido. Aktualisht nuk ka tendenca për shtrirje. Nëse ka nevojë në të ardhmen, mënyra qendrore e shtrirjes është e planifikuar dhe ofrohet mundësia për banim individual.

Kur është themeluar komuna e Graçanicës, ka përfshirë vendbanimet si Suvido, pjesë të Lagjes së Re, dhe vendbanimin Ashani ku që të gjitha konsideroheshin si një vendbanim kryesisht me banim individual. Aktualisht nuk ka tendenca për shtrirje në kushte të banimit individual. Për shkak të vendndodhjes, afërsisë me autostradën dhe hekurudhën, struktura e vendbanimit dhe toka komunale në dispozicion, janë planifikuar ndërtimet e ardhshme të parkut industrial në mes të Suidos dhe Lagjës së Re, si dhe industria e produkteve bujqësore dhe produkteve ushqimore.

Vendbanimi i Livagjës:

Gjithashtu nuk ka tendenca për zgjerim. Nëse ngritët nevoja në të ardhmen, është planifikuar banimi individual përgjatë rrugës për në Llapnasellë dhe përgjatë rrugës së fshatit të lidhur me autostradën Prishtinë- Shkup. Nën-qendra Gushterica e Poshtme ofron shërbimet për këtë vendbanim.

Vendbanimi i Dobratinit:

Ka tendenca të shtrirjes lineare në drejtim të perëndimit përgjatë rrugës Janjev-Lipjan e cila është e lidhur me autostradën Prishtinë- Shkup. Ka tendenca për zhvillim të banimit individual dhe objekteve afariste përgjatë rrugës.

Gushterica e Epërme:

Ka tendencën e zgjerimit linear përmes banimit individual në drejtim të Gushtericës së Poshtme që do të dërgonte në bashkimin e tyre funksional.

Vendbanimi Gushterica e Ulët:

Për shkak të vendndodhjes së saj dhe madhësisë, si dhe për shkak të mundësisë për zgjerim, është planifikuar si nën-qendër për vendbanimet Livadje, Dobratin dhe Gushterica e Epërme. Zgjerimi linear i banimit individual është planifikuar në drejtim të Gushtericës së Epërme dhe Livadjes.

4.4.1.2. Shëndetësia

Disa shërbime primare dhe sekondare të shëndetësisë ofrohen në komunën e Graçanicës.

Kapacitetet aktuale të shëndetësisë nuk janë të mjaftueshme. Mungojnë objektet adekuate ku qytetarët do të mund të marrin shërbime adekuate shëndetësore pasi që objektet ekzistuese veprojnë në ndërtesa të parafabrikuara. Kapacitetet e objekteve ekzistuese nuk mund të plotësojnë nevojat e pacientëve, të cilën nuk janë vetëm banor të komunës, por gjithashtu ka banor të komunës së Novobërdës, Shtërpçës, Parteshit etj.

Kur spitali i ri me kapacitete të mjaftueshëm, që është në ndërtim e sipër, të bëhen funksional, do të ofroj shërbime të plota për të gjithë ata që kanë nevojë.

Prioritet i sektorit të shëndetësisë është sigurimi i shërbimeve adekuate shëndetësore për pacient pa marr parasysh racën apo religjionin, apo edhe banimin e përhershëm, 24 orë në ditë, duke përfshirë shërbimet e emergjencës dhe trajtimin në spital. Në mënyrë që të arrij këtë, është e nevojshme të sigurohen kushtet adekuate të punës, në këtë rast ambulancat e reja në vendbanime në të cilat nuk ekzistojnë si dhe gjithashtu dhomën e urgjencës për shëndetësinë primare.

Përveç se në spital, depot për deponim të përkohshëm të mbeturinave mjekësore gjithashtu janë planifikuar.

Mbeturinave mjekësore janë shumë të rrezikshme për mjedisin dhe nuk mund të hedhen në deponi para se të bëhet trajtimi adekuat. Tymi dhe avujt të cilët janë rezultat i shkatërrimit të mbeturinave mjekësore janë shumë kancerogjen dhe të rrezikshëm për tokën. Menaxhimi i mbeturinave përfshinë zbatimin e masave ligjore për menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë mbledhjen, ndarjen, transportin, trajtimin, riciklimin dhe asgjësimin përfundimtar, me mbikëqyrjen e përhershme të aktiviteteve të lartpërmendura. Menaxhimi i mbeturinave bëhet në atë mënyrë që të siguroj rrezik sa më të vogël për shëndetin dhe jetët e njerëzve dhe për mjedisin, përmes kontrollit të përhershëm dhe masave për reduktimin e ujit, ajrit dhe ndotjes së tokës dhe reduktimin e rreziqeve nga zjarri apo shpërthimi.

4.4.1.3. Shërbimet sociale

Menjëherë pas themelimit të komunës së Graçanicës, banorët morën edhe Qendrën për Mirëqenie Sociale (QMS) që është përgjegjëse për mbrojtjen shoqërore të banorëve të rrezikuar social. Qendra për mirëqenien sociale gjendet në të njëjtën ndërtesë me shërbimet e tjera publike (Zyrën e pensioneve, Zyrën për Punësim). PZHK-ja ka planifikuar si në vijim:

- Zgjerimin e ndërtesës ekzistuese;
- Furnizimin e dhomës së fëmijëve (QMS mundëson kontakt në mes të fëmijëve dhe prindërve të divorcuar);
- Mundësinë e këshillimit ekspert në lidhje me çështjet e rëndësishme në fushën e mirëqenies sociale.

Ekzistojnë katër shoqata të personave me aftësi të kufizuara në komunën e Graçanicës: Shoqata e personave me Distrofi Muskulore, Shoqata e personave me aftësi të kufizuara, Shoqata e personave të verbër dhe me shikim të dëmtuar dhe Shoqata e civilëve invalid të luftës. Shoqatave ju mungojnë objektet adekuate për aktivitetet e tyre. Personat në moshë gjithashtu nuk kanë vend adekuat për aktivitetet e tyre. Ndërtimi i qendrës shumë qëllimshme do t'a mundësoj:

- Qëndrimin ditor për personat me aftësi të kufizuara
- Përkujdesjen ditore për persona të moshuar të cilëve ju ofrohet mundësi për socializim, mësim dhe informim të bashkëqytetarëve të moshuar në përputhje me aktivitetet e ofruara
- Trajnim profesional i personelit të angazhuar për të punuar me këto kategori të personave.

Nuk ka objekte institucionale për viktimat e dhunës në familje dhe për fëmijët pa përkujdesje prindërore në komunën e Graçanicës. Janë planifikuar masat si në vijim:

- Ndërtimi i objekteve adekuate
- Ndihma për viktimat e dhunës në familje
- Risocializimi i viktimave të dhunës në familje
- Përkujdesja adekuate për fëmijët pa përkujdesje prindërore
- Trajnimi i personelit që ka të bëjë me kategoritë e rrezikuara të lartpërmendura.

4.4.1.4. Arsimimi

Kapacitetet ekzistuese të objekteve arsimore janë jo adekuatë dhe të pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat edukative. Sistemi arsimor ekziston në Komunën e Graçanicës duke mbuluar kështu fushat nga arsimi parashkollor deri të arsimimi universitar. Nuk ka objekte adekuate arsimore për arsimin e mesëm dhe universitar, me përjashtim të objekteve të arsimit primar dhe para-shkollor. Është e nevojshme të ngritën kapacitetet e objekteve parashkollore, të rindërtohen shkollat ekzistuese primare dhe të ndërtohen shkollat e mesme dhe objektet universitare.

Përveç objekteve ekzistuese parashkollore në Graçanicë me kapacitet të pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e një numri të madh të fëmijëve, është e nevojshme të ndërtohet një tjetër objekt më i madh se ai ekzistues. Gjithashtu ka nevojë për objektet para-shkollor në nën-qendër (Llapnasell, Lepinë, dhe Gushtericë e Poshtme).

Pas ndërtimit të shkollës së mesme në vendbanimin e Graçanicës dhe në nën-qendrat e lartpërmendura, është e nevojshme të rinovohen dhe rindërtohen objektet ekzistuese të shkollave fillore kur për shkak të numrit të madh të nxënësve, procesi arsimor mbahet në tri ndërrime dhe është e pamundur të sigurohet mirëmbajtja dhe pajisja sipas standardeve të kërkuara arsimore.

Objekti i shkollës fillore në Suvido është më i vjetër se 100 vjet dhe është në gjendje shumë të keqe. Është e nevojshme të ndërtohet objekti i ri.

Duke pasur parasysh faktin se disa fakultete në kuadër të Universitetit të Prishtinës nga Mitrovica kanë degë e tyre në Graçanicë dhe në mënyrë që të lehtësojë studimin e numrit të madh të studentëve nga Komuna e Graçanicës, është e nevojshme të ndërtohet një strukturë për arsimin universitar.

4.4.1.5. Kultura, Rinia, Sporti dhe Rekreacioni

Para themelimit të Komunës së Graçanicës, ka pasur një numër të vogël të institucioneve dhe objekteve kulturore. Objektet ekzistuese kulturore kanë qenë shtëpitë e kulturës në gati se secilin fshat, ku janë kryer të gjitha aktivitetet kulturore dhe shoqërore.

Duke pasur parasysh që numri i banorëve në të gjitha fshatrat, dhe veçanërisht në Graçanicë, është rritur ndjeshëm për shkak të krijimit të gjitha institucioneve brenda komunës së re të Graçanicës, kapacitetet ekzistuese janë të pamjaftueshme. Komuna ka ndarë një shumë të konsiderueshme të parave në mënyrë që të krijoj kushte të jetesës sa më të mira të mundshme për popullatën e në veçanti për rinin.

Në mënyrë që të përmirësoj gjendjen, shtëpia e kulturës në Graçanicë është zgjeruar dhe përmirësuar me të gjitha objektet e nevojshme: salla për shumë-qëllime (teatër dhe kinema), salla kryesore, galeria, biblioteka me një dhomë për lexim, pamja e jashtme si dhe zyrat. Shtëpia e kulturës është e rrethuar me një park të rregulluar. Shtëpitë ekzistuese të kulturës në fshatra gjithashtu janë rinovuar dhe pjesërisht të furnizuara. Qendrat e reja kulturore janë të ndërtuara dhe furnizuara në Badovc dhe Batushë si dhe në qendrën rinore në Prekoc dhe në ndërtesën e Radio Graçanicës

Nevojat komunale ende janë shumë të mëdha në krahasim me gjendjen ekzistues. Kur është fjala për kulturën, është e nevojshme të ndërtohen dhe furnizohen objektet kulturore aty ku ato nuk ekzistojnë, për shkak se fshatrat janë larg nga njëri tjetri dhe çështja e transportit në kuadër të komunës është ende e pazgjidhur plotësisht. Objektet shoqërore janë të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve sociale.

Për shkak të faktit se Komuna e Graçanicës është komune rurale, ka mungesë të zonave me parqe të rregulluara. Në disa fshatra brenda territorit komunal, parqet me objektet adekuate janë ndërtuar, duke ofruar argëtim për fëmijët dhe të rriturit.

Komunës gjithashtu i mungojnë objektet sportive me përjashtim të disa terreneve sportive të futbollit në disa fshatra.

Komuna ka rindërtuar terrenet sportive ekzistuese dhe ka ndërtuar komplekset e reja sportive për shumë qëllimesh dhe sallën e tenisit në Llapnasell.

Zbatimi aktual i projektit për objektin sportiv shumë-qëllimesh afër rrugës Llapnasell - Livadje përfshinë një sall të madhe, terrene të hapura sportive, objekte dytësore dhe furnizimin e tyre të plotë.

Përveç terreneve sportive për shumë qëllime është e nevojshëm të ndërtohen objekte më të vogla sportive apo fusha të lojërave për aktivitetet e përditshme dhe për rekreacion në të gjitha fshatrat, si dhe të rindërtohen fushë-lojërat e shkollave dhe sallat për aktivitetet sportive.

4.4.2. Zhvillimi Ekonomik

Komuna e Graçanicës i takon Zonës Ekonomike Qendrore (ZEQ) dhe ka vendndodhjen qendrore sa i përket zonave të tjera ekonomike. Sipas Planit të aprovuar Hapësinor të Kosovës, Komuna e Graçanicës gjendet në zonën e kaltër, që është një zonë me lëvizje dhe me prioritet.

Në qendër të Zonës së Kaltër, është planifikuar TZHEK-Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, i ashtuquajtur shtylla e zhvillimit ekonomik me interes kombëtar, burimi i të ardhurave për ekonomine e Kosovës dhe vend i mundshëm për investime nga kompanitë ndërkombëtare.

Ky është regjioni ku qeveria qendrore planifikon të ndërtoj impiantin e ri të energjisë elektrike "Kosova e Re" me kapacitetin e minierës së re të linjtit që do të jetë 830 milion tonë- fusha e Sibofcit.

Miniera më e madhe e plumbit dhe zinkut është miniera e Kishnicës e cila nuk është funksionale që nga viti 1999. Megjithatë, në disa vitet e fundit kjo minierë përpunon xehet e plumbit dhe zinkut nga minierat e Marevcit dhe Novobërdës. Miniera e Kishnicës paraqet një aset industrial por duhet të kontrollohet thellësisht.

Komuna e Graçanicës është komunë rurale me tokë bujqësore të cilësisë së lartë. Dy nga degët më të përfaqësuara janë agro-ekonomia dhe blegtoaria.

Territori i Komunës së Graçanicës ka zonën më të madhe të biznesit. Tregtia është aktiviteti kryesor në këtë zonë me 69%, e përcjell nga shërbimet me 26% dhe prodhimi me 5% të aktiviteteve në tërësi.

Duke pasur në mendje të gjitha këto që u përmendën më lartë, zhvillimi i komunës së Graçanicës duhet të përmirësohet. Zhvillimi ekonomik duhet të përmirësohet përmes zhvillimit të bujqësisë, ekonomisë dhe turizmit.

Aktivitetet e identifikuar nga EPK-ja si të nevojshme për të përmirësuar bujqësinë janë:

- Nxitja e prodhimit të qëndrueshëm bujqësor
- Rritja e prodhimit blegtoral
- Prodhimi i produkteve të veçanta bujqësore (bimëve mjekësore, barërave aromatike dhe erëzave) në saje të ekzistimit të kushteve të favorshme natyrore
- Rritja e prodhimit bujqësor nëpërmjet ujitjes
- Sigurimi i tregut për vendosjen e produkteve
- Zhvillimi i NVM-ve në fushën e përpunimit të produkteve bujqësore (ushqimi dimëror, produktet e thata).
- Vetëdijesimi në lidhje me përdorimin adekuat të mjeteve dhe masave agro-teknike
- Përmirësimi i tokës së degraduar
- Parandalimi i përdorimit dhe shfrytëzimit ilegal të tokës në pronësi shoqërore
- Përdorimi i makinerive moderne
- Arsimitimi për prodhimin e ushqimit organik
- Krijimi i grupimeve
- Laboratori për kontrollimin e kualitetit të prodhimit
- Stimulimi i prodhimit të qëndrueshëm Bujqësorë
- Certifikata dhe stimuj të tjerë në mënyrë që të bindin fermerët për përdorimin e prodhimeve më të mira bujqësore
- Promovimi i investimeve në përdorimin e burimeve lokale në mënyrë ekologjike, organizimin e tyre në zinxhir të vlerave dhe përmirësimin e kapaciteteve konkurruese me ruajtjen afat-gjate të mjedisit të qëndrueshëm, si dhe barazia shoqërore dhe gjinore.
- Zhvillimi i studimit të fizibilitetit për prodhimin e qëndrueshëm bujqësor.

Vetëm ekonomia konkurruese dhe atraktive me sektorë të zhvilluar të kompanive mikro, të vogla dhe të mesme si dhe me iniciativa për ndërmarrësi mund të jenë gjenerues të vendeve të reja të punës në Komunën e Graçanicës.

Aktivitetet e identifikuar nga EPK-ja si të nevojshme për të përmirësuar ekonomine janë:

- Mbështetje për biznese të reja dhe ekzistuese
- Nxitja dhe krijimi i bizneseve familjare
- Forcimi i infrastrukturës së nevojshme të biznesit
- Qendra e inkubatorit të Biznesit- Uglarë
- Zona industriale dhe biznes parku- Suvido
- Qendra e shërbimit të biznesit- Suvido
- Themelimi i Zyrës për Zhvillim ekonomik lokal (ZZHEL)
- Rritja e punësimit përmes stimulimit dhe investimeve në arsimin e përhershëm dhe zhvillimin e arsimit alternativë dhe përmirësimin e njohurive të cilat do të harmonizojnë vendet e punës në dispozicion me kërkesat e sektorit privat
- Krijimi i institucioneve të reja arsimore
- Zhvillimi i plan-programeve për ri-trajnim
- Shërbimi për orientim biznesi
- Panairë të punësimit
- Zona e bizneseve të avancuara – ZBA
- Nxitja e Partneritetit Privat-Publik
- Mjedisi atraktiv ekonomik dhe social për investitorët e huaj dhe ata vendor
- Krijimi dhe mirëmbajtja e bazës së dhënave të PMS-së
- Analiza e burimeve ekzistuese.

Turizmi paraqet një mundësinë për zhvillim, plotësuese me degë të tjera ekonomike. Problemet në zhvillimin e turizmit janë personeli i pakualifikuar mjaftueshëm, mungesa e projekteve dhe kapacitetet turistike.

Aktivitetet e identifikuar nga EPK-ja si të nevojshme për të përmirësuar turizmin janë:

- Zhvillimi dhe promovimi i turizmit lokal- Fetare, Kulturorë, Historikë, Rural, Sportiv- rekreativ.
- Zhvillimi i NVM-ve turistike
- Zhvillimi i strategjisë së zhvillimit të turizmit
- Rritja e ofertave turistike dhe promovimi më i mirë i burimeve ekzistuese
- Ngritja e vetëdijes së popullsisë mbi trashëgime religjioze, kulturore dhe natyrale
- Zonë turistike për shumë qëllime - Etno Hoteli në Zonën arkeologjike Ulpiana
- Sport - Qendra rekreative- Lapnasell
- Promovimi i vendeve të gjuetisë- Vendndodhja, Çeshma në drejtim të Lapnasellës, Livadjes, Gushterica e Epërme (thëllëza, lepur, a fazan, dhelpira dhe ujqër).
- Shenjat informuese për turist
- Organizimi i manifestimeve të ndryshme (festivale, panairë, karnavale etj)
- Promovimi dhe zhvillimi i Eko Rrjetit (stimulimi i habitateve ekologjiksht të shëndosha)
- Vendosija e Pikave të Interesit (PI) brenda territorit të komunës së Graçanicës
- Krijimi i qendrave informative turistike
- Krijimi i partneritetit publik-privat
- Edukimi i ciceronëve turistikë dhe menaxherëve.

4.4.3. Infrastruktura dhe Sherbimet Publike

4.4.3.1. Transporti publik

Krijimi i transportit publik do të zgjidhte këto probleme: të gjitha anët e komunës do të lidheshin me çka do të mundësohej një zhvillim i baraspeshuar i të gjithë komunës dhe do të parandaloheshin migrimi i banorëve nga vendbanimet e largëta.

Një nga parakushtet për krijimin e transportit publik është ndërtimi i stacionit të autobusëve dhe hapësirës së garazheve të mjeteve të transportit publik. Ky stacion do të ju shërbente mjeteve që operojnë linjat ndër urbane dhe ato ndërkombëtare.

- Stacioni i autobusëve është planifikuar në periferi të vendbanimit të Graçanicës në drejtim të Kishnicës për shkak të afërsisë së autostradës Prishtinë - Gjilan dhe mungesës së vendeve të përshatshme në Graçanicë për një qëllim të tillë. Stacionet e autobusëve janë planifikuar në të gjitha vendbanimet. Garazhet qendrore për automjetet e transportit publik janë planifikuar për në Llapnasellë

Hekurudha ndërkombëtare Prishtinë - Shkup kryqëzon territorin e komunës së Graçanicës, si dhe hekurudhën lokale për minierën e Kishnicës, Kishnicë – Lepinë. Pas luftës së vitit 1999, ndalesa hekurudhore në Suvido ishte e mbyllur dhe nuk kishte ndonjë ndalesë të vetme funksionale ose stacion hekurudhor brenda territorit të komunës.

- Rindërtimi dhe vënia në funksion e stacionit ekzistues hekurudhor në Suvido. Trafiku hekurudhor është një ndër mjetet më të lira të transportit dhe në mënyrë strategjike është i përshatshëm për transportin e sasive të mëdha të mallrave dhe produkteve, duke u influencuar direkt në zhvillim. Ndalesa e hekurudhës në Suvido është i përshatshëm për shkak të afërsisë së autostradës Prishtinë - Shkup, çka krijon parakushtet për themelimin e zonës së ardhshme industriale për ushqim dhe prodhime bujqësore.

4.4.3.2. Rrjeti rrugor

Infrastruktura e dobët rrugore është si rezultat i neglizhencës afatgjate dhe mungesës së investimeve. Mund të themi se sa i përket infrastrukturës rrugore, situatë e tanishme është më e keqe se përpara vitit 1999.

Situata politike ka qenë shakatare që për dhjetë vite ka pasur mungesë të investimeve dhe një nga pasojat është infrastruktura e dobët rrugore. Kryesisht, rrugët nuk kanë profil adekuat. Infrastruktura rrugore është në gjendjen më të dobët në pjesën perëndimore të komunës, ku banorët e kësaj pjese të komunës e quajnë veten “Të harruarit”.

Në mënyrë që të zgjidhen këto probleme, është e nevojshme që të bëhet:

- Rindërtimi i rrugëve ekzistuese dhe ndërtimi i rrugëve të reja në vendbanimet dhe rrugët ndërlidhëse.
- Të bëhet rregullimi i rrugëve me një profil të përshatshëm dhe ndërtimi i rrugëve për këmbësorë dhe ku është e mundur ndërtimi i shtigjeve cikliste
- Rindërtimi dhe ndërtimi i ndriçimit rrugor në vendbanimet përgjatë rrugës kryesore
- Ndërtimi i korridoreve të gjelbra, ku është e mundur.

4.4.3.3. Furnizimi me ujë

Banoret e komunës së Graçanicës, sidomos banoret e fshatrave të Radevës, Skullanvës, Lepinës, Batushës, Suvido dhe Uglarit kanë mungesë të kushteve themelore për jetë normale. Këto fshatra nuk kanë sistem të furnizimit me ujë. Ata përdorin puse që kryesisht kanë kualitet të dobët që nuk i lejon ata që t`a përdorin për ujë të pijshëm. Po ashtu ky problem ekziston përgjatë magjistrales Prishtinë-Shkup, ku ekzistojnë objekte të ndërtuar ilegalisht, të ashtuquajturat “Zona e Biznesit”.

Për shkak të ndërtimit të paplanifikuar dhe ilegale kësaj zone i mungon sistemi i furnizimit me ujë dhe kanalizim. Ky është një problem madhor që ekziston edhe që duhet të zgjidhet sa më shpejt. Ky problem mund të zgjidhet përmes:

- Ndërtimit të sistemeve për furnizim me ujë dhe kanalizim për pjesën perëndimore të komunës, meqë banoret përdorin puse private për furnizim me ujë.
- Përpunimi i studimeve hulumtuese për kualitetin dhe kuantitetin e ujërave nëntokësorë për furnizimin me ujë të pesë vendbanimeve në pjesën perëndimore të Komunës (Suha Dollit, Radevës, Skulanevo, Lepina dhe Batusha).

Problem madhor në furnizimin me ujë paraqet numri i shtuar i banorëve në vendbanimet përreth të cilët përdorin ujin nga Liqeni i Graçanicës, për shkak se sasia e ujit në liqen është e pamjaftueshme.

- Një zgjidhje e mundshme është ndërtimi i sistemit për furnizimi me ujë që do të lidhte Liqenin e Graçanicës me Liqenin e Gazivodës.
- Rregullimi i infrastrukturës në zonën e biznesit

4.4.3.4. Kanalizimi

Për shkak të karakterit rural të vendbanimeve në Komunën e Graçanicës, sistemi i kanalizimit nuk ekziston ose nuk ka ekzistuar në të kaluarën e afërt. Që nga krijimi i komunës së Graçanicës në vitin 2009, një pjesë e rëndësishme e komunës është e mbuluar me rrjet të kalarimit. Ka nevojë të arsyeshme për ndërtimin e objekteve për trajtimin e ujërave të zeza.

- Ndërtimi i objekteve për trajtimin e ujërave të zeza para se ujërat e zeza të derdhen në shtretërit e lumenjve (këto objekte duhet të ndërtohen në pajtueshmëri me Studimin për Vlerësimin e Ndikimeve Mjedisore)

4.4.4. Mbrojtja e Mjedisit

Situata mjedisore në Komunën e Graçanicës është e përcaktuar nga kushtet natyrore, struktura rurale, aktivitetet ekonomike, transporti dhe proceset vijuese socio-ekonomike.

4.4.4.1. Ndotja e ajrit dhe zhurma

Koncentrimi vjetor mesatar i gazrave ndotës në ajër në vitin 2011 është dhënë nga Instituti Hidrometeorologjik Kosovës. Stacion për matjen e kualiteti të ajrit ndodhet në Prishtinë dhe mbulon një hapësirë 10 km² (të dhënat PM₁₀ -57,83 ng/m³ ; 3- 49,41ng/m³; SO₂- 19,6 ng/m³; CO 3784,55 ng/m³; NO₂-nuk ka të dhëna).

Ata ofrojnë të dhëna matëse për ndotjen e ajrit dhe tokës brenda territorit komunal, por nga përvoja mund të themi se ajri në Graçanicë ndotet nga miniera e Kishnicës. Po ashtu ndotësi më i madh në territorin e komunës dhe burimi i zhurmës është trafiku. Paraqet kërcënim për banorët në zonat qendrore po ashtu edhe në vendet përgjatë magjistrales. Në mënyrë që të zgjidhen këto probleme, duhet të ndërmarrën këto hapa:

- Reduktimi i ndotjes së ajrit dhe nivelit të zhurmës në zonat qendrore
- Rehabilitimi i minierës përmes mbjelljes dhe pyllëzimit

4.4.4.2. Ndotja e ujit

Kualiteti i ujit në lumenj dhe kanale është jashtë normave për shkak të prezencës masive të ujërave të zeza . Burimi i lumit të Graçanka është liqeni i Graçanicës dhe që nga fillimi i tij është i ndotur për shkak të ndotësve nga miniera e Kishnicës. Kjo ndotje është e vazhdueshme dhe është si rezultat i drenazhimit dhe kullimit. Kjo ndotje ka karakter kimik çka do të thotë se uji është ngopur me metale të rënda të cilat parandalojnë ekzistencën e organizmave të gjallë me përjashtim të disa llojeve të algave. Lumenjtë e ndotur po ashtu ndikojnë në ujërat nëntokësor me çka shkaktohet ndotje intensive e tokës në pjesën e sipërme të lumit Graçanka. Lumenjtë; Graçanka, Janjevka, Zhegovka, Sitnica dhe Prishtivka janë të parregulluar dhe kanë prezencë të ujërave të zeza. Në disa vendbanime ku shtretërit e lumenjve janë të parregulluar , shirat e mëdha qojnë në vërshime duke shkaktuar dëme të mëdha për banorët . Duhet të ceket se korridoret e gjelbra që kanë ekzistuar përgjatë shtretërve të lumenjve janë prerë ilegalisht duke mos u kujdesur për rëndësinë e tyre. Kërkohen masat e poshtëshënuara:

- Ndërtimi i objekteve për trajtimin e ujërave të zeza-kolektorët e kanalizimit
- Ndërtimi i filtrave në Preoc dhe Graçanicë
- Krijimi i korridoreve të gjelbra përgjatë shtretërve të lumenjve
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve duke përdorur materiale natyrore në mënyrë që të parandalohen vërshimet

4.4.4.3. Ndotja e tokës

Ndotja dhe degradimi i tokës është dukshëm i ndikuar nga ndërtimet ilegale për shkak se ato janë ngritur në tokë pjellore bujqësore dhe rajone të gjelbra pa infrastrukturë adekuate. Ka një numër vendbanimesh të paplanifikuara të ndërtuar afër lumenjve brenda territorit komunal. Disa prej këtyre vendbanimeve ju mungon infrastruktura e rregulluar dhe ujërat e zeza shkarkohen në lumenj. Të gjitha këta lumenj janë degë të lumit Sitnica, që po ashtu bartin ujëra të ndotura. Një shembull tjetër është zona e biznesit e ndërtuar ilegalisht pa infrastrukturë adekuate ku ujërat e zeza shkarkohen në tokën bujqësore. Kërkohen masat e poshtëshënuara:

- Përdorimi racional dhe i kontrolluar i tokës ndërtimore
- Mbrojtja e tokës bujqësore ndaj ndërtimeve ilegale
- Përgatitja e infrastrukturës adekuate për zonën e biznesit

4.4.4.4. Mbeturinat e ngurta

Ekziston një numër i deponive ilegale që janë ngritur për shkak të neglizhencës nga njerëzit. Përpara se të krijohej komuna ekipet përgatitore të Graçanicës kanë vendosur kontejner për mbetje të ngurta të komunës. Qeveria e Republikës së Serbisë themeloi kompaninë publike të mbeturinave në këtë rajon. Hedhja e mbeturinave ka qenë e paplanifikuar që do të thotë se ato janë hedhur afër Minierës duke krijuar edhe një deponi ilegale. Pas krijimit të Komunës së Graçanicës, Komuna së bashku me kompaninë Pastrimi mori nën kontroll grumbullimin dhe hedhjen e mbeturinave. Sidoqoftë, konsiderohet se kapaciteti i kompanisë Pastrimi është i pamjaftueshëm dhe nuk ka numër të mjaftueshëm të kontejnerëve përbrenda territorit të komunës. Problem i dukshëm është edhe hedhja e mbeturinave mjekësore e cila hidhen së bashku me llojet e tjera të mbeturinave. Një prej deponive kryesore është edhe miniera e Kishnicës. Deponia është sfida kryesore mjedisore me të cilën përballlet komuna.

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave parashihet të zhvillohet një plan për menaxhimin e mbeturinave të ngurta, i cili do të përfshijë strategjitë për reduktimin, riciklimin dhe përzgjedhjen e mbetjeve. Sa i përket menaxhimit të mbeturinave mjekësore, deri sa të gjendet një zgjedhje e përhershme, planifikohet që të sigurohet një kontejner i përkohshëm afër spitalit të ri për hedhjen e herëpashershme të mbeturinave.

Qëllimet bazike të mbrojtjes mjedisore janë:

- Ndërtimi i stacionit për ndarjen e mbeturinave
- Ndërtimi i stacionit për riciklim
- Ndërtimi i vendeve për deponim të përkohshëm të mbeturinave mjekësore përbrenda hapësirave të ardhshëm të spitalit
- Përmirësimi i shërbimeve të largimit të mbeturinave
- Shtimi i numrit të kontejnerëve dhe vendosja e kontejnerëve për ndarjen e mbeturinave
- Zgjedhja e problemit të minierës në nivel regjional

4.4.4.5. Resurset natyrore

Një pjesë e liqenit të Graçanicës i takon komunës. Ky liqen ndodhet dy kilometra larg Graçanicës dhe është liqen artificial dhe është ndërtuar me qëllim për të furnizuar Prishtinën dhe vendbanimet përreth me ujë të pijshëm. Po ashtu në fshatin Radevë ndodhet edhe një hurdhë e peshqve që ka operuar para luftës dhe tash është e braktisur. Për tani hurdhja në Radevë është nën mbikëqyrjen e Agjencisë së Privatizimit, por komuna nuk është në favor të privatizimit.

Në afërsi të lokalitetit arkeologjik Ulpiana ndodhet një pus natyral. Vendi quhet Fontana e Piknikut dhe shfrytëzohet nga banorët si vend për piknik gjatë verës.

Planifikohen veprimet si në vijim:

- Zhvillimi i gjuetisë dhe peshkimit në liqenin e Graçanicës dhe lumin Sitinica
- Revitalizimi i hurdhës së Radevës
- Revitalizimi i vendit për piknik-Fontanës
- Ndërtimi i një etno hotelit turistik në afërsi të Fontanës

4.4.4.6. Zvogëlimi i rrezikut nga katastrofat

Duke u bazuar në informatat e marra, rreziqet potenciale në Graçanicë janë: vërshimet, tërmetet, zjarret e pa kontrolluara dhe aksidentet e shkaktuara nga transportimi i mallrave të rrezikshme. Për këtë arsye masat për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat duhet të konsiderohen që të sigurojnë një zhvillim të sigurt dhe të qëndrueshëm të komuniteteve.

Vërshimet:

Bazuar në hartën e vërshimeve komuna së Graçanicës është e prirur për vërshime. Rajonet e rrezikuara nga vërshimet gjenden përgjatë lumit Sitnica. Plani propozon masa përmes shfrytëzimit të tokës. Për këtë arsye propozohet që të ketë korridore të gjelbra përgjatë lumenjve për të minimizuar rrezikun potencial nga vërshimet. Sistemi i drenazhimit sipërfaqësor nuk duhet të pengohet në zonat e ndërtimeve të reja.

Tërmetet:

Ndërtimet e reja në Graçanicë duhet të ndërtohen sipas kodit në fuqi dhe duhet të bëhet një vlerësim për ndërtesat e vjetra publike, dhe mund të aplikohet meremetimi i ndërtesave sidomos për ndërtesat publike dhe ato të trashëgimisë.

Transporti i mallrave të rrezikshme:

Korridoret kryesore të transportit kalojnë përmes Komunës së Graçanicës. Për këtë arsye zvogëlimi i rrezikut dhe masat e zbutjes duhet të merren në konsideratë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme (Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave) dhe me Ministrinë e Infrastrukturës.

Zjarret e pakontrolluara:

Shumica e vendbanimeve në komunën e Graçanicës janë fusha të papjellëzuara . Sidoqoftë ka një pjesë të vendeve të pjellëzuara që duhet të mbrohet nga zjarri i maleve. Tampon zonat që do të ndanin mali në pjesë do të ndihmonin në kontrollimin e zjarreve të mundshme me ç`rast do të zvogëlonte rrezikun. Gjithashtu duhet të ndërmerren fushata, për ngritjen e vetëdijesimit të komunitetit , nga autoritet lokale.

Erozioni:

Për shkak të degradimit të pyjeve, erozioni është prezent. Plani propozon mbrojtje nga degradimi i mëtutjeshëm i pyjeve dhe aktivitete për ripjellëzim si një masë parandaluese për zvogëlimin e përqindjes së erozionit dhe përmirësimin e pyjeve.

Breshëri:

Masat për mbrojtje nga stuhia e breshrit dhe sistemi i paralajmërimit të hershëm duhen të ndërtohen në mënyrë që të mbrohen aktivitetet bujqësore në Graçanicë. Po ashtu sigurimet bujqësore duhet të merren në konsideratë në mënyrë që të mbrohen bujqit dhe produktet nga rreziqet potenciale atmosferike.

Bora e madhe:

Bora e madhe në Kosovë shpesh shkakton probleme dhe paralizon lëvizjen. Shtëpitë e vjetra dhe kulmet jo në rregull janë të cenushme. Ndërtimi i rregullt i kulmeve si dhe masat mbrojtëse kundër rrëshqitjes së borës nga kulmet duhet të kihen parasysh kur të ndërtohet shtëpia.

4.4.4.7. Trashëgimia kulturore

Mund të thuhet se komuna është e pasur me trashëgimi kulturo-historike. Përveç manastirit të Graçanicës që ndodhet brenda zonës së veçantë të mbrojtur , dhe e cila është nën mbrojtjen e UNESCO-ës. Kisha Ortodokse dhe shumë monumente kulturo-historike janë të ndërtuar thuajse në çdo fshat përbrenda territorit komunal. Lokaliteti arkeologjik Ulpiana po ashtu ndodhet brenda territorit të komunës.

- Respektimi i të gjitha dispozitave të relevante ligjore në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore
- Mirëmbajtja dhe konservimi i të gjitha kishave ortodokse dhe objekteve tjera fetare
- Zhvillimi i studimeve hulumtuese për lokalitetin arkeologjik Ulpiana në bashkëpunim me MKRS dhe Institutin Arkeologjik dhe të shihet se a mund të tkurret zona mbrojtëse përreth lokalitetit.

4.4.5. Vleresimi Socio-Ekonomik dhe Mjedisor ne Kornizen e Propozuar

Plani zhvillimor i komunës së Graçanicës si dokumenti i parë për tërë territorin e komunës, ka për synim që të përmirësoj kushtet e jetesës dhe të krijojë kushtet për zhvillim. Sidoqoftë, zhvillimi i ri përveç që duket pozitiv në shikim të parë zakonisht po ashtu mund të ketë efekte negative në aspektin socio-ekonomik dhe atë mjedisor. Për këtë arsye. Ekipi komunal për planifikim ka bërë një vlerësim të aspekteve të lartshënuara më kornizën e propozuar.

Elementi kryesor i konceptit të zhvilluar është marrë nga skenari që është në trend, me disa elemente të marra nga dy skenarët tjerë.

Nga këndvështrimi mjedisor, skenari që është në trend fillimisht është vlerësuar si jo i qëndrueshëm. Sidoqoftë Ekipi komunal për planifikim dhe pjesëmarrësit e tjerë sollën përpara një model të devijuar të shfrytëzimit të tokës, i cili përveç se përcjell trendët në zhvillim, ka inkorporuar disa elemente planifikuese të instrumenteve për shfrytëzimin e tokës me qëllim që të mbrohet mjedisi dhe të parandalohet shtrirja e mëturjeshme.

Koncepti i mëturjeshtëm decentralizues nga skenari i dytë është integruar në këtë kornizë. Koncepti propozon një zhvillim të decentralizuar me nën-qendra urban dhe qendrën kryesore administrative Graçanicën.

Përgjatë zhvillimit policentrit të propozuar në këtë kornizë, qëllimi është të krijohen vendbanime kompakte duke i bashkuar vendbanimet që janë afër njëra tjetrës e cila gjithë ndikon pozitivisht në mjedis duke e mbrojtur tokën bujqësore, i mundëson vendbanimeve kohezion social dhe mundëson shërbime të infrastrukturës fizike dhe transportit publik me një kosto më të ultë. Kjo do të reduktojë numrin e vajtjeve-ardhjeve me makina në Graçanicë dhe si pasojë e kësaj do të ketë ndikim pozitiv në reduktimin e emetimeve të CO2.

Për më shumë sistemi i planifikuar i transportit dhe sistemi i lëvizshmërisë në përgjithësi do të kenë ndikim pozitiv në jetën e banorëve dhe do të mundësojë lëvizjen dhe integrimin e të gjitha pjesëve të komunës. Më saktësisht, do të lehtësoj vajtjet-ardhjet për në punë dhe shkollë edhe do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik.

Sa i përket zhvillimit të parashikuar të Graçanicës në drejtim të Badovcit dhe Sushicës, mund të thuhet se në princip se nuk është e qëndrueshme që të zhvillohen vendbanimet në mënyrë lineare. Sidoqoftë, zhvillimi është tashmë duke ndodhur në atë drejtim dhe po ashtu duke marrë parasysh trendin, mungesa e tokës pjellore për shkak të zonës së veçantë të mbrojtur dhe kufizimeve përgjatë lokalitetit të Ulpianës dhe nxjerrja e mineraleve, zgjerimi i propozuar është mundësi e vetme për zhvillim. Si një masë lehtësues, propozohet të bëhet një zhvillim plotësues në këtë zonë ku kualiteti i tokës është më i dobët krahasuar më pjesët tjera. Ky propozim vlerësohet si ekonomikisht i arsyeshëm pasi që infrastruktura primare fizike në këtë zonë ekziston, pra nuk ka nevojë për investime të mëdha.

Mund të konkludojmë se me këtë zhvillim plotësues të propozuar, do të mbrohet toka më e mirë bujqësore dhe do të promovohet zhvillim kompakt, çka do të rezultojë në ndikim pozitiv socio-ekonomike dhe mjedisorë.

Propozohet që zona e biznesit përgjatë rrugës kombëtare Prishtinë-Shkup dhe Prishtinë-Prizren të kufizohet duke synuar që të mbrohet toka bujqësore në afërsi. Propozohet që zhvillimi i kësaj zone të kufizohet 150 m nga të dy anët e rrugës përveç në udhëkryqe. Si një masë lehtësuese propozohet që të ndërtohen hapësira të gjelbra përgjatë rrugës magjistrale dhe përmes ndërtesave duke synuar që të balancohet përqindja e hapësirave të gjelbra të hapura dhe hapësirës për biznes. Kjo është e prezantuar në detaje në hartën e zonës. Zona e industrisë se lehtë dhe inkubatori i biznesit afër vendbanimit të Suvido dhe Lagjes së re do të jetë industri miqësore për mjedisin për përpunimin e ushqimeve, që do të stimuloj prodhimin bujqësor dhe do të krijojë vend e pune në rajonet rurale, të cilat për momentin nuk janë fare të zhvilluara. Lokacioni është afër njeve transportues rrugore dhe hekurudhore dhe lënda e parë (produktet bujqësor) gjendet në këtë zonë, pra nuk do të ketë nevojë për kostot e transportit.

Skenari i propozuar synon të mbrojë tokën bujqësore dhe të promovojë aktivitet bujqësore. Dukë marrë në konsideratë traditën lokale bujqësore dhe tokën e mirë bujqësore, ka potencial të madh për zhvillim të qëndrueshëm në Graçanicë. Si një masë për reduktimin e Gazrat Serë (GHG) propozohet që të ndërtohen uzina me biomasë të cilat do të prodhonin energji për ngrohje për vendbanimet. Kjo energji është e favorshme për mjedisin dhe do të zëvendësojë energjinë elektrike e cila tani konsumohet për ngrohje, përgatitje të ushqimit etj.

Përveç uzinave me biomasë propozohet që të instalohen edhe Panelet fotovoltaike për mbështetjen e prodhimit të energjisë për objektet publike (komuna, shkolla etj) dhe ndërtesat publike (për ndërtime të larta dhe shtëpi private po ashtu edhe për ndërmarrje industriale). Ky skenar vlerësohet si më i favorshmi për zhvillimin socio-ekonomik dhe mbrojtjen mjedisore.

Sidoqoftë, çështjet institucionale dhe legale si për shembull disa klauzola në Ligjin për tokën bujqësore paraqesin pengesë në mbrojtjen efikase të tokës bujqësore.

5. STRATEGJITE DHE AKTIVITETET PER ZBATIM

Ky kapitull do të ofrojë strategji dhe veprime që të arrihet vizioni i komunës brenda periudhës së planit (2013-2028). Të gjitha veprimet e paraqitura në këtë kapitull paraqesin projekt-propozime të cilat kanë rrjedhur nga takimet konsultative me palët përkatëse të mbajtura gjatë hartimit të këtij plani.

5.1. Infrastruktura Sociale, Banimi dhe Demografia

Si një komunë e sapo krijuar, sfida kryesore gjatë përballjes me sfidat e vazhdueshme të komunës është mungesa e trashëguar e infrastrukturës sociale, si dhe numri i madh i personelit të ri dhe të papërvojë. Në këtë fushë tematike ekzistojnë dy strategji që janë vendosur për të adresuar çështjet aktuale:

Strategjia 1: Të zgjerohen kapacitetet e banimit dhe të ofrohen shërbimet në fushat e shëndetësisë, arsimit, kulturës, shërbimeve sociale dhe sporteve dhe së bashku me atë ngritja e kapaciteteve në këto fusha.

Ekzistojnë dy objektiva kryesore të cilat janë vendosur nga strategjia për t'i adresuar çështjet në zgjerimin e kapaciteteve të banimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale.

O1: Ngritja e kapaciteteve në fushat e shëndetësisë, edukimit, shërbimeve sociale, kulturës, rinisë, sportit dhe rekreacionit;

O2: Ofrimi i shërbimeve të duhura dhe cilësore.

Strategjia propozon përmirësimin e kushteve fizike të objekteve ekzistuese, si parakusht për përmirësimin e infrastrukturës sociale. Veprimet në vijim paraqesin projekte konkrete që rrjedhin nga strategjia e lartpërmendur dhe objektivat e saj në fushat e shëndetësisë, arsimit, shërbimeve sociale, kulturës, rinisë, sportit dhe rekreacionit. Për sqarim më të mirë, projektet janë të ndara në fushat e tyre përkatëse.

Shëndetësia

Komuna ka dy projekte të përgjithshme për menaxhim më të mirë të sistemit shëndetësor: përmirësimin e objekteve në qendrat e mjekësisë primare si dhe përfundimin e ndërtimit të spitalit klinik.

- Përfundimi i qendrës së spitalit klinik;
- Përmirësimi i objekteve në qendrat ekzistuese shëndetësore në nën-qendra.

Arsimi

Sistemi arsimor është planifikuar që të adresohet nga institucionet parashkollëre deri në riuftësimin dhe pajisjen e objekteve ekzistuese shkollë në tërë territorin e Graçanicës. Sistemi arsimor është adresuar nga objektet para-shkollëre deri në shkollën e mesme dhe arsimin e lartë, me veprimet e përmendura si më poshtë:

- Ndërtimi dhe pajisja e qendrave shkollë në qendër dhe nën-qendra;
- Riuftësimi dhe pajisja e objekteve ekzistuese shkollë;
- Ndërtimi i kopshteve

Shërbimet Sociale

Duke marrë parasysh se plani synon përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve të Graçanicës, strategjia propozon projekte që gjithashtu do të përmirësojnë gjendjen ekzistuese të grupeve më pak të favorizuara në shoqëri, si: të moshuarit, personat me nevoja të veçanta, jetimët. Projektet janë fokusuar kryesisht në sigurimin e objekteve/ hapësirave për strehim dhe socializmit të grupeve të sipërpërmendura.

- Zgjerimi i Qendrës ekzistuese për Punë Sociale;
- Ndërtimi i një qendre për komunitet (për socializmin e personave me nevoja të veçanta, socializimin e të moshuarve, socializimin e fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe aktivitete tjera të rëndësishme shoqërore);
- Ndërtimi i shtëpisë për fëmijët pa kujdes prindërore/jetimore;
- Vendstrehim për viktimat e dhunës.

Veprimet e mësipërme janë të vendosur ashtu që të përmirësojnë ndjeshëm situatën ekzistuese të objekteve të infrastrukturës sociale.

Shërbimet Publike

Duke marrë parasysh komunën e sapoformuar, shumë ndërtesa të shërbimeve publike ende mungojnë. Ato kryesisht janë vendosura në ndërtesa private, të improvizuar si ndërtesa publike. Ndërtim/ përmirësimi i këtyre ndërtesave do të ndihmonte në përmirësimin e qasjes në shërbimet publike për të gjithë qytetarët e Graçanicës në përgjithësi. Madje, Komuna është e angazhuar për të siguruar hapësira për këto ndërtesa në kuadër të PZHK-së.

- Ndërtimi i objektit të postës;
- Ndërtimi i ndërtesës së Gjykatës;
- Ndërtimi i objekteve për stacionin e autobusëve;
- Ndërtimi i stacionit të zjarrfikësve.

Kultura, Rinia, Sportet dhe Argëtimi

Në mënyrë që të rriten mundësitë për të rinjtë e Graçanicës që të merren me sport, rekreacion dhe aktivitete kulturore, ashtu që të rritet zhvillimi personal, kohezioni dhe krenaria e komunitetit përmes inkurajimit dhe fuqizimit të individëve lokalë, organizatave të komunitetit dhe institucioneve, komuna ka planifikuar disa aktivitete brenda kornizës së PZHK-së. Ato janë si më poshtë:

- Riaftësimi dhe pajisja e objekteve ekzistuese të qendrave kulturore (fshati fqinj serb, Gushterica e Ulët, Dobratin)
- Ndërtimi i qendrave rinore nëpër nën-qendra
- Ndërtimi i terreneve sportive dhe shesheve të lojërave për fëmijët në lagje
- Riaftësimi i objekteve ekzistuese sportive
- Ndërtimi i objektit të muzeut
- Ndërtimi i objekteve fetare në Çagllavicë dhe Kishnicë

O2: Ofrimi i shërbimeve të duhura dhe cilësore.

Përveç përmirësimit të infrastrukturës fizike, komuna është e përkushtuar edhe në rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit profesional, përmes ofrimit të trajnimeve në fushën përkatëse.

- Trajnimi i personelit profesional në të gjitha fushat (trajnime profesionale ...)

Strategjia 2: Përmirësimi i standardit jetësor përmes planifikimit dhe vendbanimeve të rregulluara

O1: Rregullimi i vendbanimeve ekzistuese të bëhet në përputhje me Ligjin 04/L-174 per Planifikim Hapesinor.

Finalizimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së), do të drejtojë zhvillimet e ardhshme të vendbanimeve në tërë komunën e Graçanicës. PZHK-ja ka paraparë gjithashtu edhe krijimin e nën-qendrave, të cilat do të krijojnë kushte më të mira për qytetarët që jetojnë në ato zona përmes afrimit të tyre tek shërbimet, dhe kjo do të balanconte zhvillimin e tërë komunës së Graçanicës. Është shumë e rëndësishme për të përcaktuar prioritetet kur është fjala për hartimin e PRRU-së për vendbanimet duke përfshirë edhe vendbanimet joformale.

PZHK propozon që rregullimi i hapësirave, zonave të ndertimit dhe kushtet e ndertimit për vendbanimet e reja, për vendbanimet joformale; për nën-qendrat komunale (L.Selo, Gushterica e Ulët dhe Lepinë); dhe për lagjet e Graçanicës; të bëhet në baze të dispozitave të Ligjit 04/L-174 per Planifikim Hapesinor.

O2 : Të zgjerohen kapacitetet e banimit nëpërmjet ndërtimit të banesave kolektive dhe individuale

Mundësia e zgjidhjes së çështjes së banimit është çështje e rëndësishme për qeverinë lokale të Graçanicës. Komuna është e përkushtuar që të punojë në këtë drejtim dhe të japin mundësinë e pronësisë së shtëpive për qytetarët e Graçanicës duke konsideruar se ofron siguri financiare dhe një formë të kursimeve dhe ul varësinë nga ndihma publike më vonë gjatë jetës. Për të adresuar çështjet e banimit në përgjithësi, komuna fillimisht do të hartojë një program tre vjeçar për banim.

- Ofrimi i banimit me çmime të përballueshme
- Punimi i një programi tre-vjeçar për banim të qëndrueshëm në komunë
- Kufizimet për shfrytëzimin e tokës dhe ndërtimit
- Të avancohet puna e inspektimit, në mënyrë që të kontrollohen ndërtimet e paligjshme
- Të respektohen ligjet dhe rregulloret në zhvillimin e dokumenteve teknike dhe të projektimit;
- Të zhvillohet sistemi komunal informativ gjeografik

5.2. Zhvillimi Ekonomik

Strategjia 1: Të përmirësohet zhvillimi ekonomik nëpërmjet zhvillimit të ekonomisë, bujqësisë dhe turizmit

Komuna e Graçanicës gjendet në zonën ekonomike Qendër (ZEQ) sipas Planit Hapësinor të Kosovës, dhe ka pozitë qendrore në lidhje me zonat e tjera ekonomike. Njëra ndër zonat më të mëdha të biznesit në vend është vendosur brenda komunës së Graçanicës. Tregtia është aktiviteti më i shpeshtë në Graçanicë, ku përbënë 69%, shërbimet 26%, dhe 5% prodhimtaria. Strategjia thekson stimulimin e prodhimtarisë dhe shërbimeve.

O1: Të inkurajohet prodhimi i qëndrueshëm bujqësor

Graçanica është komunë rurale me tokë bujqësore të cilësisë së lartë. Në mënyrë që të krijohen kushte të përshtatshme për përdorim bashkëkohor dhe më të mirë të tokës pjellore bujqësore, strategjia ka vendosur një objektiv për të nxitur prodhimtarinë e qëndrueshme bujqësor dhe vendosjen e këtyre produkteve në treg. Komuna do të lehtësojë bujqve që të zhvillojnë strategji të reja për prodhim dhe shpërndarjen e qëndrueshme të produkteve. Strategjia e komunës është që të përdorën tre objektiva të gjera, apo 3 shtylla për qëndrueshmëri: Përfitime për një kohë të gjatë; Administrim i tokës/ dheut, ajrit dhe ujit; dhe cilësinë e jetës për bujqit e komunës së Graçanicës. Komponentët thelbësore të bujqësisë si prodhimi, përpunimi, marketingu, shpërndarja, hulumtimi, zhvillimi, rregullimi, shërbimet mbështetëse si dhe menaxhimin e burimeve natyrore janë adresuar përmes projekteve/veprimeve si më poshtë:

- Edukimi i bujqve dhe barinjve, përmes vizitave nëpër panaire dhe vizita studimore;
- Hartimin e projekteve për financim nga donatorët;
- Hartimi i studimit për bujqësi të qëndrueshme;
- Aplikimi i praktikave moderne bujqësore dhe inkurajimin e prodhimit organik;
- Ndërtimi i sistemeve të ujitjes (riaftësimi i sistemit ekzistues dhe ndërtimi i atyre të reja, themelimi i ndërmarrjes për përpunimin e ujit brenda komunës).

O2: Të sigurohet qasje në treg dhe vendosje të produktit

Në lidhje me strategjinë, si objektivi është vënë edhe vendosja e produktit. Projektet janë bërë për përcjelljen e zinxhirit të plotë për shitjen e produkteve që nga themelimi i shoqatës së biznesit deri në ndërtimin e tregut për shitjen e produkteve. Theks është vënë edhe në trajnimin e tregtarëve për vendosjen e produktit, si dhe ndërtimin e objekteve për ruajtjen dhe tharjen e ushqimit.

- Trajnim mbi vendosjen e produktit;
- Promovimin e bashkëpunimit në mes të prodhuesve dhe përpunuesve (themelimi i Komisionit, nënshkrimin e një memorandumit të bashkëpunimit, programit vjetor);
- Ndërtimi i objekteve për deponim në të ftohtë dhe objekte për tharje;
- Ndërtimi i tregjeve për vendosjen e produktit;
- Themelimi i shoqatave të biznesit.

O3: Të ngrihet vetëdijësimi për një bujqësi të qëndrueshme

Edhe pse në përgjithësi, nuk është promovuar mjaft në Kosovë, përdorimi i qëndrueshëm i pesticideve dhe zhvillimi i bujqësisë së mirë është duke u bërë mjaft çështje e rëndësishme në mbarë botën. Strategjia është e fokusuar në bujqësi të qëndrueshme për shkak se ajo adreson shumë shqetësime mjedisore dhe sociale, dhe ofron mundësi të reja dhe ekonomikisht të qëndrueshme për kultivuesit, konsumatorët, politikë-bërësit dhe shumë të tjerë në tërë sistemin e ushqimit, prandaj është vendosur një objektiv për të rritur ndërgjegjësimin për këtë çështje, përmes edukimit.

- Arsimiti mbi praktikën e përshtatshme bujqësore

O4: Të stimulohet punësimi

Objektivat që janë të vendosura nga strategjia, pavarësisht nga specifikat e tyre, të gjitha lidhen me stimulimin e punësimit. Theks i veçantë është vënë në ngritjen e kapaciteteve në teknologjitë e reja dhe nevojat e tregut, si dhe krijimi i inkubatorëve të biznesit i cili do të jetë një mbështetje substanciale për fillet e biznesit. Komuna do të mbështesë bizneset të cilat stimulojnë punësimin, nëpërmjet masave stimuluese.

- Krijimi i një programi për përmirësimin dhe rikualifikim, si dhe implementimin e trajnimeve në fushat e nevojshme;
- Krijimi i një qendër biznesi dhe një inkubatori të biznesit;
- Zbatimi i masave nxitëse (stimuj për tatim, e të ngjashme.).

O5: Të inkurajohet hapja e bizneseve familjare dhe i ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme

Komuna e Graçanicës do të marrë nismën e krijimit të klimës /mjedisit të përshtatshëm për shtytjen e ekonomisë lokale, duke inkurajuar bizneset familjare si dhe krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Kjo është planifikuar të arrihet duke mundësuar qasjen më të ngushtë dhe më të shpejtë në shërbimet administrative dhe thjeshtimin e procedurave për bizneset e reja. Komuna gjithashtu do të jetë si urë lidhëse në mes të donatorëve dhe organizatave të ndryshme të cilat do të ndihmojnë gjithashtu edhe në krijimin e një fondi për mbështetjen e NMVM-ve.

- Arsimimi / trajnimet mbi drejtimin e bizneseve familjare, vizitën dhe organizimin e panairove;
- Sigurimi i buxhetit dhe subvencionet për të drejtuar biznesin e familjes.

O6: Të zhvillohet dhe promovohet turizmi lokal (turizmi kulturor, fetar, rural, sportiv dhe rekreativ)

Zhvillimi dhe promovimi i turizmit lokal është planifikuar të bëhet përmes mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe lokacioneve natyrore, si dhe duke siguruar infrastrukturën e nevojshme për përmirësimin dhe krijimin e qasjes më të mirë në këto vende. Përveç ndërhyrjeve fizike, Komuna gjithashtu do të ndërmarrë masa të buta në këtë drejtim, si promovimin dhe marketingun e lokacioneve dhe produkteve të Graçanicës. Në mënyrë që të arrihet kjo, komuna është e gatshme të bashkëpunojë me organizata dhe institucione të ndryshme si nga niveli lokal ashtu edhe nga ai qendror.

- Arsimi, vizita e panairove tregtare, përgatitja e broshurave, trajnimin e ciceronëve turistikë;
- Promovimi i ushqimit tradicional si dhe artizanatit lokal dhe suvenirët;
- Organizimi i ngjarjeve (ditët e lules, ditët e bletarisë/mjaltit, ditët e poçarisë , etj);
- Promovimi i peshkimit në Radevë dhe Sitnicë;
- Përmirësimi i pellgut të peshkut -në Radevë;
- Ndërtimi i etno-hotelit;
- Zhvillimi i hapësirave për rekreacion dhe i shtegut për vrapim rreth liqenit.

O7: Të stimulohet zhvillimi i biznesit

PZHK-ja përcakton lokacionin hapësinor për zhvillimin e biznesit. Edhe pse tërheqja e investimeve të jashtme, si dhe administrata tatimore i takon nivelit qendror, komuna është e përkushtuar për të krijuar një klimë të përshtatshme për bizneset duke u ofruar atyre infrastrukturën e nevojshme, duke qenë se shërbimet komunale apo të infrastrukturës fizike do të ndihmojnë ata për zhvillimin e biznesit në kuadër të komunës.

- Themelimi i një zyre për zhvillim ekonomik lokal dhe edukimin e stafit të saj;
- Inkurajimi për bashkëpunim ndërmjet sipërmarrësit dhe bizneseve të Komunës si dhe formimin e grupimeve;
- Ndërtimi i një parku industrial;
- Sigurimi i subvencioneve dhe granteve për zhvillimin dhe promovimin e zgjerimit të biznesit;
- Rindërtimi dhe ndërtimi i rrjetit të nevojshëm në infrastrukturë në zonat e biznesit.

5.3. Infrastruktura dhe Shërbimet Publike

Strategjia 1: Përmirësimi i shërbimeve në kuadër të komunës së Graçanicës

Për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike/shërbimeve komunale Komuna ka përcaktuar katër objektiva të cilët synojnë adresimin e shërbimeve primare në kuadër të komunës. Secili objektivi ka përcaktuar një numër të projekteve/programeve të cilët do të ndihmojnë në arritjen e objektivave të caktuara.

O1: Mbulueshmëria e sistemit për furnizim me ujë dhe me kanalizim në të gjithë territorin e komunës

Brenda komunës ka fshatra/vendbanime ku nuk ka sistem të furnizimit me ujë dhe furnizimi me ujë bëhet nga pusët private, prandaj objektivi ka vendosur një projekt për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në ato vendbanime. Duke pasur parasysh se pasuria kryesore e zhvillimit ekonomik në Graçanicë është toka pjellore bujqësore, ndërtimi i një sistemi alternativ të ujitjes do të ndihmonte në kursimin e ujit të pijshëm dhe do të përmirësonte shërbimet. Në mënyrë që të mbrojë shëndetin publik në mënyrë të përherëshme, të zvogëlojë kontaminimin e ujit dhe të tokës, ky objektivi ka paraparë ndërtimin e mikro-impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në tre vendbanime në Graçanicë, Preoc dhe Lapnasellë.

- Ndërtimi i sistemit të ri të ujësjellësit dhe kanalizimit në Radevë, Skulanevë, Suvi Do, Batusë, Lepinë, zona të biznesit dhe vende ku nuk ekziston;
- Rindërtimi i rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë;
- Ndërtimi i sistemit alternativ të furnizimit me ujë për qëllime të ujitjes;
- Ndërtimi i tre mikro-impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në Graçanicë, Lapnasellë dhe Preoc.

O2: Përmirësimi i rrjetit elektrik dhe furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike është kompetencë e nivelit qendror përkatësisht e Korporatës Elektrike të Kosovës (KEK), mirëpo komuna mund të lehtësoj punën përmes ndërtimit të infrastrukturës nën-tokësore për energjinë elektrike dhe mund të zbuloj mënyra të reja/alternative të prodhimit të energjisë në mënyrë që të arrijë objektivat e vendosur që do të përmirësonin furnizimin në komunë. Në lidhje me këtë komuna është duke planifikuar të orientoj prodhimin e energjisë alternative nga biomasa, prandaj janë dy projekte të caktuara për këtë; njëri është për fabrikën për prodhimin e biomasës dhe tjetri është për impiantin për prodhimin e energjisë nga biomasa. Projektet për të arritur këtë objektivi janë vendosur si vijon:

- Prodhimi i elektricitetit nga burimet e ri-përtëritshme të energjisë
- Ndërtimi i një fabrike për prodhimin e biomasës;
- Ndërtimi i impiantit për prodhimin e energjisë nga biomasa;
- Ndërtimi i infrastrukturës nën-tokësore në Graçanicë dhe Lapnasellë dhe në vende ku është e nevojshme.

O3: Mbulimi i rrjeteve të telekomunikimit

Komuna është kryesisht e mbuluar me rrjete të ndryshme të telekomunikimit, por duhet të zgjerohet më shumë dhe kualiteti i tyre të rritet. Vendosja e gjithë infrastrukturës nën-tokë dhe instalimi i një rrjeti me kablllo optike janë projekte të parapara nga ky objektivi. Ky objektivi kërkon bashkëpunim me kompanitë e telekomunikimit dhe komuna do të punoj në këtë drejtim.

- Ndërtimi i rrjetit nëntokësor të telekomunikimit në Graçanicë;
- Instalimi i infrastrukturës së rrjetit me kablllo me fibra optike në të gjitha zonat;
- Zgjerimi i rrjetit ekzistues të telekomunikimit në Graçanicë.

O4: Përmirësimi i Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta

Megjithëse ka shumë deponi ilegale të mbeturinave në kuadër të komunës, një deponi për mbeturinat komunale nuk planifikohet të ndërtohet sepse do të transportohet në deponitë regjionale. Përveç kësaj, strategjia propozon që deponitë për mbeturinat e ndërtimit si dhe një deponi të përkohshme për mbeturina mjekësore duhet të jenë në kuadër të territorit komunal. Është planifikuar themelimi i një ndërmarrje lokale në pronësi publike, në mënyrë që të menaxhoj nga afër shërbimet në kuadër të komunës.

- Themelimi i një ndërmarrje lokale në pronësi publike;
- Ndërtimi i varrezave të kafshëve;
- Deponi për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave mjekësore afër qendrës klinike spitalore;
- Deponi për mbeturinat e ndërtimit.

Strategjia 2: Përmirësimi i lëvizshmërisë përmes komunës së Graçanicës

Strategjia ka përcaktuar pesë objektiva dhe secili prej tyre është prioritet në një numër të projekteve/primeve, më qëllimin e përgjithshëm të përmirësimit të trafikut në kuadër të komunës. Përveç kësaj, strategjia gjithashtu promovon një stil më të shëndetshëm të jetesës përmes ofrimit të infrastrukturës për transportin e pa-motorizuar (ecjen në këmbë dhe me biçikletë), si dhe përdorimin e transportit publik.

O1: Reduktimi i bllokimeve të trafikut në qendrën e Graçanicës

Në mënyrë që të reduktoj bllokimet në trafik në qendër të Graçanicës, strategjia ka caktuar një objektiv të integritetit të tri projekteve/primeve për të siguruar arritjen e tij. Ndërtimi i rrugëve anësore përreth qendrës historike do të mbronte manastirin nga zhurma dhe ndotja me pluhur i cili është i krijuar nga trafiku i rëndë, dhe do të rrisë sigurinë e qytetarëve në qendër. Komuna është e përkushtuar të kufizoj trafikun e rëndë në qendër si dhe të menaxhoj lëvizshmërinë në mënyrë që të përmirësoj jetën publike afër manastirit. Zgjerimi i kapacitetit të parkingut (parkingut dhe garazheve publike) do të kontribuonte në sigurinë e qytetarëve si dhe do të përmirësonte kualitetin e hapësirave publike siç janë trotuarët, sheshet dhe parqet.

Koment/Rrezik: Aktiviteti i ndërlidhur me ndërtimin e rrugës anësore mund të devijoj aktivitetin ekonomik nga qendra e qytetit dhe mund të nxis zgjerimin.

- Ndërtimi i unazës në Graçanicë;
- Zgjerimi i kapaciteteve për parking në Graçanicë dhe Lapnasellë;
- Ndërtimi i një garazhe të parkingut.

O2: Përmirësimi i trafikut të këmbësorëve, biçikletave dhe zonave publike

Përmirësimi i sferës publike është veçanërisht i rëndësishëm për qytetarët e Graçanicës. Karakteri rural i kësaj komune nuk ofron zona cilësore publike dhe jetë publike; prandaj strategjia ka përcaktuar një objektiv për të adresuar këto çështje përmes ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme për promovimin e një mënyre më të shëndetshme të transportit dhe kjo do të përmirësoj sferën publike dhe kualitetin e jetës në komunë.

- Ndërtimi i trotuareve në të gjitha zonat;
- Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta aty ku është e mundshme;
- Ndërtimi i qasjeve dhe rrugëve për persona me nevoja të veçanta.

O3: Ndërtimi i korridoreve të gjelbra në komunë

Në mënyrë që të bëjë mjedisin e ndërtuar dhe mjedisin natyral të bashkë-ekzistojnë në harmoni dhe në proporcione të balancuara, strategjia ka përcaktuar një objektiv që të krijoj korridore të gjelbra përgjatë lumenjve dhe rrugëve. Duhet të merren masat për të promovuar sigurinë në trafik duke shmangur vendosjen në pika kritike dhe në kthesa përgjatë rrugës, në mënyrë që të përmirësoj dukshmërinë.

- Ndërtimi i një korridori të gjelbër përgjatë lumit Graçanka në vendbanime si dhe ndërtimi i një shtegu për këmbësor dhe biçikleta nga Graçanica deri në fshatin e Lapnasellë;
- Ndërtimi i një zone të gjelbër zbutëse përgjatë rrugëve.

O4: Përmirësimi i rrjetit rrugor

Gjithashtu është caktuar edhe një objektiv për të përmirësuar rrjetin rrugor, i cili përbëhet nga tre projekte/prime. Ka seksione në kuadër të komunës të cilët kanë nevojë për rehabilitim, projektim të sinjalizimit për të moshuarit dhe për njerëzit me shikim të dëmtuar në mënyrë që të zvogëlohen aksidentet me automjete. Kjo gjithashtu do të ndihmoj fermerët dhe bizneset e vogla në zonat rurale që të sjellin produktet e tyre në treg më lehtë dhe me shpenzime më të vogla.

- Rindërtimi dhe ndërtimi i rrugëve lokale përmes komunës;
- Ndërtimi i ndriçimit përgjatë rrugëve kryesore;
- Shënjimi i të gjitha rrugëve me sinjalizim horizontal dhe vertikal.

O5: Përmirësimi i transportit publik në Komunën e Graçanicës

Transporti publik në komunën e Graçanicës, ka nevojë për një vëmendje të veçantë duke pasur parasysh karakterin e tij rural dhe komunitetet lokale ku shumë banorë mbështeten në të. Në mënyrë që të ketë sukses në kontekstin e Graçanicës, ku ka vendbanime të shpërndara në territorin e komunës, transporti publik duhet të operojë në orare dhe rrugë fleksibile, dhe duhet të jetë kombinim i shërbimeve të ndryshme. Në të vërtetë, koordinimi i shërbimeve të pakoordinuara - punëdhënësit, mjetet e udhëtimit dhe të ngjashme - mund të jenë një nga sfidat më të mëdha, prandaj duhet të kryhet një studim i fizibilitetit për nevojat e transportit publik.

- Ndërtimi i terminalit qendror
- Studimi i fizibilitetit mbi nevojat e transportit publik
- Ndërtimi i garazhit për automjetet e transportit publik

5.4. Mjedis, Burimet Natyrore dhe Trashëgimia Kulturore

Çështja e mjedisit, burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore është mjaftë lartë në agjendën e komunës, duke e pasur parasysh cilësinë e lartë të tokës bujqësore dhe posedimin e vendit arkeologjik Ulpiana si dhe manastirin mesjetar Gracanica. Komuna ka propozuar tri strategji për të adresuar këto çështje dhe për të menaxhuar asetet e saj në mënyrën më të mirë të mundshme.

Strategjia 1: Mbrojtja e mjedisit dhe Burimeve natyrore

O1: Mbrojtja e tokës bujqësore ndaj kimikateve (mjetet agro-teknike)

Në mënyrë që të reduktoj ndikimin e Bujqësisë në mjedisin objektiv ka caktuar tre projekte për të adresuar këtë çështje. Komuna do të mbështesë projektet/programet dhe do të stimulojë fushatat të cilat do të rrisin vetëdijesimin e fermerëve në lidhje me përdorimin e kimikateve për prodhim bujqësor. Për të zgjedhur mjetet dhe mënyrat e mbrojtjes së bimëve është e mundur që të përdoren jo vetëm spërkatjet kimike të bimëve, por edhe metodat agro-teknike, mekanike dhe biologjike të kontrollit apo trajtimit të farës, prandaj komuna është e përkushtuar që të punojë në këtë drejtim. Kontrolli agro-teknik i dëmtuesve nënkupton vetëm vrojtimin e rotacionit të kulturave për të shmangur grumbullimin e dëmtuesve, agjentëve të sëmundjeve, barishteve apo dobësimit të tokës. Nuk rekomandohet të mbillen bimë të ndërlidhura në fushat fqinje apo në fushat e njëjta disa vite me radhë. Gjithashtu është e nevojshme që të gjitha masat agro-teknike të bëhen me kohë. Rregullimi i kushteve të mbjelljes mund të jetë një masë agro-teknike për kontrollimin e dëmtuesve. Numri i trajtimit me pesticide mund të ulet me anë të përdorimit të masave bujqësore.

Duke pasur parasysh se lumenjtë në komunë janë shumë të ndotur, kryesisht nga sistemi i kanalizimit, duke paraqitur kështu një rrezik për kontaminim të tokës, komuna do të marr masa për dekontaminimin e lumit.

Ngritja e vetëdijes në komunitet në lidhje me përdorimin e mjeteve kimike;

- Vlerësimi i kontaminimit të tokës bujqësore;
- Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza (Graçanica, Prishtevka Zegovka, Janjevka, Sitnica - bashkëpunimi ndër komunal).
- Performimi i një “pastrimi” hapësinor

O2: Mbrojtja e tokës nga ndërtimet ilegale

Kufijtë e ndërtimit janë të përcaktuar me dokumentin e PZHK-së. Duke pasur në mendje kualitetin e lartë të tokës bujqësore, komuna duhet të jetë e kujdesshme në mënyrë të veçantë në këtë drejtim. Prandaj ka përcaktuar veprime të koncentruara në fuqizimin e inspektoratit, dhe gjithashtu një kampanjë agresive për ngritjen e vetëdijes në mes të qytetarëve në lidhje me pasojat e ndërtimit në tokat bujqësore.

- Kampanja një-vjeçare për informimin e qytetarëve dhe ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e zonave të lejuara dhe të ndaluara të ndërtimit në zonat bujqësore.
- Fuqizimi i inspektoratit (të fuqizohen kontrollet dhe inspektimet në terren për ndërtime ilegale).

O3: Parandalimi i shpyllëzimit ilegal dhe pyllëzimi i tokës së zhveshur

Në komunën e Graçanicës janë përafërsisht 10% tokë pyjore në të gjithë territorin, dhe kjo zonë është e rrezikuar nga shpyllëzimi ilegal. Në lidhje me këtë, komuna ka caktuar një aktivitet për të bërë një fushatë e cila do të ngrit vetëdijen mbi pasojat e shpyllëzimit ilegal si dhe për përfitimet ekologjike nga pyjet. Përveç kësaj, komuna është duke planifikuar të marr masa për pyllëzimin e zonave erozive afër deponisë së Kishnicës, e cila gjithashtu do të shërbente si një zonë e gjelbër për të mbrojtur vendbanimet fqinje.

- Rripi i gjelbër përgjatë deponisë së Kishnicës;
- Parandalimi i erozioneve duke vendosur mbeturinat e ndërtimit në vendet erozive të Kishnicës;
- Ngritja e vetëdijes për ekologjinë dhe shpyllëzimin ilegal
- Pyllëzimi i tokës erozive afër deponisë së Kishnicës;
- Rehabilitimi i parqeve ekzistuese përmes përdorimit të materialeve natyrore lokale dhe krijimit të qasjes për të gjithë.

O4: Përdorimi i burimeve të ri-përtëritshme të energjisë

Integrimi i burimeve të ndryshme të ri-përtëritshme të energjisë në rrjetin ekzistues elektrik në komunën e Graçanicës do të kontribuonte shumë në cilësinë e furnizimit me energji, si dhe do të përputhej me objektivat dhe synimet e BE-së për gazra serë. Bazuar në këtë, komuna ka përcaktuar tre projekte të cilat do të shërbejnë si një pikë fillestare në drejtim të përdorimit të energjisë së gjelbër, përmes të cilave një fushat që do të informonte banorët e Graçanicës mbi rëndësinë dhe përfitimet e energjisë së bazuar në energji diellore dhe të biomasës.

- Ndërtimi i ndriçimit solar publik;
- Ndërtimi i një impianti të energjisë së ri-përtëritshme të energjisë me biomasë;
- Realizimi i një fushate për të ngritur vetëdijen e komunitetit mbi rëndësinë e përdorimit të energjisë së biomasës dhe energjisë diellore.

O5: Përmirësimi i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës duke ju adresuar mbeturinave dhe deponive ilegale

Siç është cituar shumë herë në dokument, komuna e Graçanicës posedon tokë shumë të mirë bujqësore, rrjet të mirë hidrologjik, peizazhi i mirë dhe e gjithë kjo është e rrezikuar nga ndotja prej ujërave të zeza dhe nga deponia e trashëguar dhe e shkatërruar e minierës. Nga ana tjetër, ka shumë vendbanime të cilat kërkojnë shërbime të mira dhe mbi të gjitha një mjedis të shëndetshëm të jetesës. Në mënyrë që të adresojë çështjet e lartpërmendura, komuna do të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- Ngritja e vetëdijes mbi çështjet e mjedisit;
- Zbatimi i gjobave komunale për hedhje të paligjshme të mbeturinave;
- Rikuperimin e sipërfaqeve ku ka pasur deponi ilegale të mbeturinave/rehabilitim i tokës së degraduar;
- Hartimi i Planit për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Krijimi i korridorit të gjelbër përgjatë të gjitha rrugëve në vendbanime;
- Krijimi i korridoreve të gjelbra mbrojtëse përgjatë deponisë së Kishnicës;
- Largimi i Deponive;
- Vlerësimi i cilësisë së ujërave nga pusët;
- Ndërtimi i rrjetit të ujës-jellës në fshatrat Radevë, Skulanevë, Lepinë, Batushë, Suhadoll;
- Rregullimi i shtratit të lumit dhe krijimi i korridorit të gjelbër (Ruajtja e Biodiversitetit).

Strategjia 2: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

Komuna e Graçanicës është mjaft e pasur me objekte të trashëgimisë kulturore, me objekte fetare, si dhe me vende arkeologjike. Ka dy objektiva të caktuara për strategjinë për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

O1: Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore (arkitektonike, arkeologjike, peizazheve kulturore dhe trashëgimisë shpirtërore)

Trashëgimia kulturore kërkon shumë kapacitete financiare dhe profesionale për të mbrojtur dhe mirëmbajtur atë, në mënyrë që t'i rezistoj motit dhe kushteve të zhvillimit gjatë gjithë kohës. Varësisht nga shkalla dhe statusi ligjor, menaxhimi i saj dhe administrimi duhet të bëhen në bashkëpunim me institucionet e nivelit qendror, prandaj komuna është e përkushtuar të bashkëpunoj me institucionet kompetente për menaxhim më të mirë të këtyre vendeve.

- Studimi në vendin/zonën arkeologjike në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si dhe Institutit të Arkeologjisë;
- Ri-përcaktimin e aktiviteteve në vendin arkeologjik Ulpiana;
- Vlerësimi mbi mbetjet arkeologjike mbetet në kuadër të zonës së mbrojtur të Ulpianës.

O2: Promovimi i trashëgimisë kulturore (të prekshme dhe të pa prekshme)

Ekziston një lidhje e fuqishme në mes të promovimit dhe zhvillimit të turizmit. Komuna është e përkushtuar në drejtim të industrisë dhe turizmit dhe përmes kësaj banorët lokal do të ndjejnë krenari për Graçanicën dhe historinë e saj. Komuna do të përkrah programet e turizmit lokal që dërgojnë drejt përmirësimit të ekonomisë lokale dhe përmirësimit të cilësisë së jetës për banorët lokal. Në Kosovë është një ngjarje vjetore që mbahet çdo vit në shtator dhe përkrahët nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe fondet e Bashkimit Evropian, komuna e Graçanicës është e përkushtuar të bashkëpunoj dhe të marr pjesë në aktivitetet e organizuara gjatë këtyre ditëve, të cilat do të ofrojnë të dhëna thelbësore që do të nxitin turizmin lokal.

- Promovimi i trashëgimisë kulturore, përmes vizitave turistike në vendet kulturore (Manastiri i Graçanicës, lokacioni arkeologjik Ulpiana)
- Shënjimi i ditëve të trashëgimisë/ Ditët e Trashëgimisë Evropiane çdo Shtator.

Strategjia 3: Zvogëlimi i rrezikut dhe përmirësimi i ndikimeve negative në mjedis

Në mënyrë që të zvogëloj rrezikun dhe të përmirësoj ndikimet në mjedis, të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu, është shumë e rëndësishme që të jemi të vetëdijshëm dhe të kuptojmë natyrën e atyre rreziqeve. Plani ka caktuar një objektiv që përbëhet nga disa aktivitete për të adresuar këto çështje në mënyrën më të mirë të mundshme.

O1: Zvogëlimi i ndikimeve negative në mjedis në fushat e prirura për fatkeqësi natyrore nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të VMRRF-së (Vlerësimi i Menaxhimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë)

Duke marrë parasysh rrjetin hidrologjik të Graçanicës, ka shumë fusha të rrezikuara nga përmbytjet dhe në mënyrë për të parandaluar atë, janë caktuar masat që duhet të merren të tilla si studimi/vlerësimi i zonave të prirura për përmbytje dhe pastaj rregullimi i shtratit të lumit në fushat me të rrezikuara. Pavarësisht nga kjo, komuna do të punojë në zhvillimin e planit të reagimit emergjent. E gjithë kjo është adresuar me aktivitetet e listuara më poshtë:

- Kryerja e një studimi për të parandaluar përmbytjet;
- Rregullimi i shtratit të lumit-për të parandaluar përmbytjet e lumenjve;
- Të kryhen kufizimet e përdorimit të tokës në zona të prirura për përmbytje
- Zhvillimi i mbrojtjes nga zjarri, plani i evakuimit/themelimi i njësive të zjarrfikësve.
- Pyllëzimi i zonave erozive
- Të hetohet kapaciteti mbajtës i tokës para ndërtimit dhe respektimit të kodit të ndërtimit;
- Vlerësimi dhe meremetimi i ndërtesave ekzistuese publike për karakteristika seizmik

5.5. Plani i Veprimit

FUSHA TEMATIKE	STRATEGJIA	KODI	VEPRIMI/ AKTIVITETETI/ PROGRAMI	INSTITUCIONET PËRGEJGJËSE	SUBJEKTET E TJERË TË PËRFSHIRË	PRIORITETI I lartë- L Mesatar- M I ulët - U	KORNIZA KOHORE*- Afatshkurtë- ASH Afatmesme- AM Afatgjatë- AGJ E vazhdueshme- V	IMPLIKIMET FINANCIARE** Minimale- MIN Uleta- U Mesme- M Larta- L	LINJA BUXHETORE	INDIKATORET
INFRASTRUKTURA SOCIALE, BANIMI DHE DEMOGRAFIA	Strategjia 1: Të zgjerohen kapacitetet e banimit dhe të ofrohen shërbimet në fushat e shëndetësisë, arsimit, kulturës, shërbimeve sociale dhe sportive dhe së bashku me atë ngritja e kapaciteteve në këto fusha	O1. Ngritja e kapaciteteve në fushat e shëndetësisë, edukimit, shërbimeve sociale, kulturës, rinisë, sportit dhe rekreacionit:								
		SHENDETESIA								
		1.1.	Përfundimi i qendrës së spitalit klinik;	Komuna;	Ministria e Shëndetësisë;	L	AGJ	L	Qeveria e Kosovës; Komuna; Donacionet;	Objektit funksional shëndetësor QKS;
		1.2.	Përmirësimi i objekteve në qendrat ekzistuese shëndetësore në nën-qendra;	Komuna;	Ministria e Shëndetësisë;	M	AM	M	Qeveria e Kosovës; Komuna; Donacionet;	Qendrat shëndetësore për kujdesin parësor në nën-qendra të ndërtuara;
		ARSIMI								
		1.1.	Ndërtimi dhe pajisja e qendrave shkollore në qendër dhe nën-qendra;	Komuna;	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjise;	L	AM	L	Ministria; Komuna; Donacionet;	Qendrat e shkollave të mesme të ndërtuara në qendër dhe nën-qendra;
		1.2.	Riaftësimi dhe pajisja e objekteve ekzistuese shkollore;	Komuna;	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjise;	L	V	M	Ministria; Komuna; Donacionet;	Ndërtesat ekzistuese shkollore të rinovuara dhe pajisura;
		1.3.	Ndërtimi i kopshteve;	Komuna, Sektori privat;	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjise;	L	AM	M	Ministria; Komuna; Donacionet; Sektori privat;	Qendrat parashkollore të ndërtuara;
		SHERBIMET SOCIALE								
		1.1.	Zgjerimi i Qendrës ekzistuese për Punë Sociale;	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;	Komuna;	M	AM	M	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;	Qendra e zgjeruar e mbrojtjes sociale;
		1.2.	Ndërtimi i një qendre për komunitet (për socializimin e personave me nevoja të veçanta, socializimin e të moshuarve, socializimin e fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe aktivitete tjera të rëndësishme shoqërore);	Komuna;	Sektori OJQ; Shoqëria Civile;	L	AM	M	Komuna; Donacionet;	Qendra për Komunitetin e ndërtuar;
		1.3.	Ndërtimi i shtëpisë për fëmijët pa kujdes prindëror/jetimore;	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;	Komuna;	M	AM	M	Ministria; Sektori OJQ; Komuna;	Jetimorja e ndërtuar;
		1.4.	Vendstrehim për viktimat e dhunës;	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;	Komuna; Sektori OJQ;	M	AM	M	Ministria; Sektori OJQ; Donacionet;	Strehimorja për viktimat e dhunës e ndërtuar;
		SHERBIMET								
		1.1.	Ndërtimi i objektit të postës;	Ministria e Infrastruktues;	Komuna;	M	AM	M	Qeveria; Ministria;	Posta e ndërtuar;
		1.2.	Ndërtimi i ndërtesës së Gjykatës;	Ministria e Drejtësisë;	Komuna;	M	AM	M	Qeveria; Ministria e Drejtësisë;	Ndërtesa e Gjykatës e ndërtuar;
		1.3.	Ndërtimi i objekteve për stacionin e autobusëve;	Komuna;	Ministria e Infrastruktues;	M	AM	M	Komuna; Donacionet;	Stacioni i Autobusëve i ndërtuar;
		1.4.	Ndërtimi i stacionit të zjarrfikësve;	Ministria e Punëve të Brendshme;	Komuna- Departamenti i Situatave Emergjente ;	M	AM	M	Ministria; Komuna;	Stacioni i zjarrfikësve i ndërtuar;
		KULTURA, RINIA, SPORTET DHE ARGETIMI								
		1.1.	Riaftësimi dhe pajisja e objekteve ekzistuese të qendrave kulturore (fshati fqinj serb, Gushterica e Ulët, Dobratin);	Komuna;	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;	M	AM	M	Komuna; Donacionet;	-
		1.2.	Ndërtimi i qendrave rinore nëpër nën-qendra;	Komuna;	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;	M	AM	L	Komuna; Donacionet;	Shtëpitë e rinovuar dhe mobiluar të kulturës;
		1.3.	Ndërtimi i terreneve sportive dhe shesheve të lojërave për fëmijët në lagje;	Komuna;	Sektori OJQ;	U	AGJ	M	Komuna; Donacionet;	-
		1.4.	Riaftësimi i objekteve ekzistuese sportive;	Komuna;	Sektori OJQ;	U	AGJ	V	Komuna; Donacionet;	Numri i parashikuar i hektarëve të terreneve të hapura (% e ndryshimeve nga të mëparshmet);
		1.5.	Ndërtimi i objektit të muzeut;	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;	Komuna;	M	AM	L	Ministria; Komuna; Donacionet;	% e fushave të rinovuara ekzistuese sportive;
		1.6.	Ndërtimi i objekteve fetare në Çagllavicë dhe Kishnicë;	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;	Komuna;	M	AGJ	L	Ministria; Donacionet; Komunitetet Fetare;	Biblioteka dhe muzeu komunitetevetë përshtatshme të vendosura/ të qasshme;
		O2. Ofrimi i shërbimeve të duhura dhe cilësore:								
		2.1.	Trajnimi i personelit profesional në të gjitha fushat (trajnimet profesionale ...);	Ministritë përgjegjëse;	Komuna;	L	V	M	Komuna, Sektori OJQ, Donacionet;	Numri i të trajnuarve në vit;
		O1. Rregullimi i vendbanimeve ekzistuese në përputhje me ligjet përkatëse:								
		1.1.	Hartimi i PRrU-së për vendbanimet joformale;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;	L	AGJ	M	Komuna;	% e mbuluar e vendbanimeve me URP;
		1.2.	Hartimi i PRrU-së për nën-qendrat komunale;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;	L	AM	M	Komuna;	% e mbuluar e nën-qendrave me URP;
		1.3.	Hartimi i PRrU-së për lagjet e Graçanicës;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;	L	AM	M	Komuna;	% e mbuluar e zonave urbane me URP;
		O2. Të zgjerohen kapacitetet e banimit nëpërmjet ndërtimit të banesave kolektive dhe individuale:								
		2.1.	Ofrimi i banimit kolektiv me çmime të përballueshme;	Komuna;	Sektori privat;	M	AM	L	Komuna, Sektori Privat;	% e rritjes së njësive të banimit me strehim të përballueshëm;
		2.2.	Punimi i një programi tre-vjeçar për banim të qëndrueshëm në komunë;	Komuna;	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;	M	AM	L	Komuna;	Dokumenti i ofruar për programin e strehimit;

*Afatshkurtër (1-3 vjet); Afatmesëm (deri 6 vjet); Afatgjatë (më shumë se 6 vjet); I vazhdueshëm (aktiviteti që zhvillohet vazhdimisht);

**Minimale (<1 000 €); Të ulta (<10 000 - ≥1 000€); Mesatare (<500 000 - ≥10 000 €); Të larta (≥500 000€).

Masat:

1. Percaktimi i lokacioneve për rezervimin e parcelave ndërtimore për të gjitha objektet e reja (identifikimi i lokacioneve);
2. Harmonizimi i rregulloreve ekzistuese komunale me dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal;
3. Të respektohen ligjet dhe rregulloret në zhvillimin e dokumenteve teknike dhe të projektimit;
4. Të kontrollohen ndërtimet e paligjshme;
5. Të instalohet GIS në nivel komunal.

FUSHAT TEMATIKE	STRATEGJIA	KODI	VEPRIMET / AKTIVITETET / PROGRAMET	INSTITUCIONET PËRQJEGJËSE	SUBJEKTET E TJERË TË PËRFSHIRË	PRIORITETI I vogel- V I mesem- M I lartë- L	KORNIZA* KOHORE Afatshkurtë- ASH Afatmesme- AM Afatgjatë- AGJ E vazhdueshme- V	IMPLIKIMET FINANCIARE** Minimale- MIN Të ulta- U Mesatare- M Të larta- L	LINJA BUXHETORE	INDIKAT ORET
ZHVILLIMEKONOMIK		O1. Inkurajimi i prodhimit të qendrueshme bujqësore:								
		1.1.	Edukimi i bujqve dhe barinjve, përmes vizitave nëpër panaire dhe vizita studimore;	Komuna;	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Kooperativa Bujqësore; Shoqata e Fermerëve; Donatorët;	L	V	M	Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet;	Numri i seminareve të mbajtura/ trajnimeve për bujqësinë dhe numri i seminareve të vizituara;
		1.2.	Hartimi i projekteve për financim nga donatorët;	Komuna;	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Kooperativa Bujqësore; Shoqata e Fermerëve; Donatorët;	L	V	M	Investimet Kapitale;	Numri i projekteve të dërguara për marrjen e granteve në Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe donatoreve të tjere;
		1.3.	Hartimi i studimit për bujqësi të qëndrueshme;	Komuna;	Fakulteti i Bujqësisë; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Kooperativa Bujqësore; Shoqata e Fermerëve; Donatorët;	L	ASH	M	Donacionet; Investimet Kapitale;	Plani/ studimi mbi bujqësinë e qëndrueshme;
		1.4.	Aplikimi i praktikave moderne bujqësore dhe inkurajimin e prodhimit organik;	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Komuna;	Fermerët Prodhues Individualë;	L	V	M	Subvencionet; Grantet;	-
		1.5.	Ndërtimi i sistemeve të ujitjes (riaftësimi i sistemit ekzistues dhe ndërtimi i atyre të reja, themelimi i ndërmarrjes për përpunimin e ujit brenda komunës);	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Komuna;	Fermerët Prodhues Individualë (mirëmbajtja, pagesa, përdorimi);	L	AM	L	Grantet;	Përqindja (%) e mbullimit me sistem për ujitjen e tokave bujqësore;
		O2. Sigurimi i tregut dhe qasjes për promovimin e produkteve:								
		2.1.	Trajnim mbi vendosjen e produktit;	Komuna; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;	Donatorët;	L	V	M	Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet;	Numri i seminareve/trajnimeve për tregun e produkteve;
		2.2.	Promovimin e bashkëpunimit në mes të prodhuesve dhe përpunuesve (themelimi i Komisionit, nënshkrimin e një memorandumi të bashkëpunimit, programit vjetor);	Komuna;	Prodhuesit;	L	V	MIN	Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet;	Themelimi i Komisionit, marrëveshja e nënshkruar në mes të prodhuesve dhe tregtarëve;
		2.3.	Ndërtimi i objekteve për deponim në të ftohtë dhe objekte për tharje;	Komuna;	Partneriteti Publiko Privat;	M	AM	U	Investimet Kapitale;	Ndërtimi i frigoriferit dhe tharësës;
		2.4.	Ndërtimi i tregjeve për vendosjen e produktit;	Komuna;	Partneriteti Publiko Privat;	L	ASH	M	Donacionet;	Ndërtimi i tregut;
		2.5.	Themelimi i shoqatave të biznesit;	Komuna;	Prodhuesit;	M	ASH	U	Donacionet;	Themelimi i Shoqatës së bizneseve;
		O3. Ngritja e vetëdijes për bujqësi të qëndrueshme:								
		3.1.	Arsimimi mbi praktikën e përshtatshme bujqësore;	Komuna;	Fakulteti i Bujqësisë; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Kooperativa Bujqësore; Shoqata e Fermerëve; Donatorët;	M	V	U	Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet;	Numri/ përqindja e fermerëve të trajnuara në praktikën e mira për bujqësinë;
		O4. Nxitja e punësimit:								
		4.1.	Krijimi i një programi për përmirësimin dhe rikualifikimin, si dhe implementimin e trajnimeve në fushat e nevojshme;	Komuna; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Shkolla Profesionale;	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Donatorët;	M	AM	M	Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet;	Training centre established and number of people trained;
		4.2.	Krijimi i një qendër biznesi dhe një inkubatori të biznesit;	Komuna- Zyra për Zhvillim Ekonomik Lokal;	Donatorët; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Shoqata e Sipërmarrësve, Fakulteti i Teknologjisë;	M	AM	M	Donacionet; Investimet Kapitale;	Business centre and business incubator established and number of business active in the business centre;
		4.3.	Zbatimi i masave nxitëse (stimuj për tatim, e të ngjashme.);	Komuna;	Donatorët; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Shoqata e Sipërmarrësve;	M	V	M	Donacionet; Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet;	Favourable municipal taxes in place;
		O5. Nxitja dhe hapja e biznesit familjar:								
		5.1.	Arsimimi / trajnimet mbi drejtimin e bizneseve familjare, vizitën dhe organizimin e panaireve;	Komuna;	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Donatorët; Shoqata e Sipërmarrësve; Kooperativa Bujqësore; Shoqata e Fermerëve;	L	V	M	Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet;	Number of people trained on business start-up;
		5.2.	Sigurimi i buxhetit dhe subvencionet për të drejtuar biznesin e familjes;	Komuna;	Donatorët, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;	L	V	M	Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet; Investimet Kapitale;	Allocated municipal budget for the business start-up scheme;
		O6. Zhvillimi dhe promovimi i turizmit lokal (kulturor, fetar, rural dhe turizmit sportiv e rekreativ):								
		6.1.	Arsimi, vizita e panaireve tregtare, përgatitja e broshurave, trajnimin e ciceronëve turistike;	Komuna;	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Sektori OJQ (Organizata turistike);	L	V	M	Donacionet; Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet;	Numri i trajnimeve të mbajtura/seminareve për zhvillimin e turizmit dhe materialit promovues;
		6.2.	Promovimi i ushqimit tradicional si dhe artizanatit lokal dhe suvenirët;	Komuna;	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Sektori OJQ (Organizata turistike);	L	V	M	Donacionet; Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet;	Numri i panaireve të mbajtura për promovimin e ushqimit kombëtar, artit dhe artizanalave;
		6.3.	Organizimi i ngjarjeve (ditët e lules, ditët e bletarisë/mjaltit, ditët e poçarisë , etj);	Komuna;	Sektori OJQ; Shoqata e Fermerëve;	L	V	M	Donacionet; Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet;	Ditët e shënuara promovuese dhe ata që festohen për çdo vit;
		6.4.	Promovimi i peshkimit në Radevë;	Komuna; Agjencia e Privatizimit e Kosoves;	Sektori OJQ; Shoqata e Fermerëve;	M	AM	L	Donacionet; Investimet Kapitale;	Numri i garave dhe peshkatarëve të regjistruar;
		6.5.	Përmirësimi i pellgut të peshkut -në Radevë;	Komuna;	Partneriteti Publiko Privat;	M	AM	U	Investimet Kapitale;	Rregullimi i hurdhës së peshqve në Radevë;
		6.6.	Ndërtimi i etno- hotelit;	Komuna;	Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;	M	AM	M	Investimet Kapitale;	Ndërtimi i etno- hotelit;
		6.7.	Zhvillimi i hapësirave për rekreacion dhe i shtegut për vrapim rreth liqenit;	Komuna;	Sektori OJQ; Komuna e Lipjanit; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;	M	AM	M	Investimet Kapitale;	Ndërtimi i hapësirave për rekreacion përrreth liqenit;

O7. Nxitja dhe zhvillimi i biznesit:									
Strategjia 1: Të përmirësohet zhvillimi ekonomik nëpërmjet zhvillimit të ekonomisë, bujqësisë dhe turizmit	7.1.	Themelimi i një zyre për zhvillim ekonomik lokal dhe edukimin e stafit të saj;	Komuna- Zyra për Zhvillim Ekonomik Lokal;	Donatorët; Ministria e Zhvillimit Ekonomik;	L	ASH	U	Buxheti Komunal;	Themelimi i Zyrës për Zhvillimin Ekonomik Lokal dhe Trajnimin e Personelit;
	7.2.	Inkurajimi për bashkëpunim ndërmjet sipërmarrësit dhe bizneseve të Komunës si dhe formimin e grupeve;	Komuna- Zyra për Zhvillim Ekonomik Lokal;	Donatorët; Ministria e Zhvillimit Ekonomik; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;	L	V	U	Buxheti Komunal;	Themelimi i komuniteteve për biznes;
	7.3.	Sigurimi i subvencioneve dhe granteve për zhvillimin dhe promovimin e zgjerimit të biznesit;	Komuna- Zyra për Zhvillim Ekonomik Lokal;	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Donatorët;	L	V	M	Donacionet; Subvencionet; Mallrat dhe Shërbimet;	Numri i projekteve financiare/ bizneseve nga donatorët;
	7.4.	Hartimi i Studimit të Fizibilitetit (SF) mbi sistemin Zonave Ekonomike Komunale (ZEK)- industriale, të biznesit dhe tregtare; te planifikuara (2014-2029+); si dhe Plani Aktiviteteve (PA) për zbatimin e rezultateve të Studimit të Fizibilitetit (SF);	Komuna;	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Donatorët;	L	ASH	L	Donacionet; Investimet Kapitale;	Themelimi i Zonave Ekonomike Komunale;
	7.5.	Ndryshimi i shfrytëzimit/ destinimit të tokave, në përputhje me rezultatet e Studimit të Fizibilitetit (SF) mbi sistemin Zonave Ekonomike Komunale (ZEK)- industriale, të biznesit dhe tregtare; te planifikuara (2014-2029+); në bazë të Plani Aktiviteteve (PA) për zbatimin e rezultateve të Studimit të Fizibilitetit (SF);	Komuna;	Komuna; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;	L	AGJ	L	Donacionet; Investimet Kapitale;	-
	7.6.	Hartimi i Planeve të Hollesishme Rregulluese (PHR) për secilin Zonë Ekonomike Komunale (ZEK)- industriale, të biznesit dhe tregtare; në përputhje me rezultatin e Studimit të Fizibilitetit (SF)- 7.4;	Komuna;	Partneriteti Publiko Privat;	L	ASH	L	Donacionet; Investimet Kapitale;	-
	7.7.	Ndërtimi i rrjetit të infrastrukurës teknike dhe rrugore për secilin Zonë Ekonomike Komunale (ZEK)- industriale, të biznesit dhe tregtare; në përputhje me rezultatin e Studimit të Fizibilitetit (SF)- 7.4; si dhe në përputhje me Planet e Hollesishme Rregulluese (PHR)- 7.5.	Komuna;	Partneriteti Publiko Privat;	L	AGJ	L	Donacionet; Investimet Kapitale;	-

*Afatshkurtër (1-3 vjet); Afatmesëm (deri 6 vjet); Afatgjatë (më shumë se 6 vjet); I vazhdueshëm (aktiviteti që zhvillohet vazhdimisht);

**Minimale (< 1 000 €); Të ulta (<10 000 - ≥1 000€); Mesatare (<500 000 - ≥10 000 €); Të larta (≥500 000€) .

FUSHA TEMATIKE	STRATEGJIA	KODI	VEPRIMET/ AKTIVITETET/ PROGRAMET	INSTITUCIONET PËRGEJGJËSE	SUBJEKTET E TJERË TË PËRFSHIRË	PRIORITETI I lartë- L Mesatar- M I ulët- U	KORNIZA KOHORE* Afatshkurtë- ASH Afatmesme- AM Afatgjatë- AGJ E vazhdueshme- V	IMPLIKACIONET FINANCIARE** Minimale- MIN Të ulta- U Mesatare- M Të larta- L	LINJA BUXHETORE	INDIKATORI
SHËRBIMET PUBLIKE, INFRASTRUKTURA DHE TRANSPORTI	Strategjia 1: Përmirësimi i shërbimeve komunale	O1: Mbulimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në tërë territorin e komunes:								
		1.1.	Ndërtimi i sistemit të ri të ujësjellësit dhe kanalizimit në Radevë, Skulanevë, Savi Do, Batusë, Lepinë, zona të biznesit dhe vende ku nuk ekzistojnë;	Kompania Rajonale e Ujësjellësit dhe Kanalizimit; Komuna;	Popullsia;	L	AM	L	Komuna; Kompania Rajonale e Ujësjellësit dhe Kanalizimit;	% e mbullimit të vendbanimeve me ujë dhe kanalizim;
		1.2.	Rindërtimi i rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë;	Kompania Rajonale e Ujësjellësit dhe Kanalizimit; Komuna;	Popullsia;	L	AM	M	Komuna; Kompania Rajonale e Ujësjellësit dhe Kanalizimit;	% e sistemit të sanuar të kanalizimit;
		1.3.	Ndërtimi i sistemit alternativ të furnizimit me ujë për qëllime të ujitjes;	Komuna; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;	Popullsia; Fermerët; Shoqata e Fermerëve;	M	AGJ	L	Komuna; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;	% e mbullimit të tokave bujqësore me sistemin alternativ për ujitje;
		1.4.	Ndërtimi i tre mikro-impianeteve për trajtimin e ujërave të zeza në Graçanicë, Lapnasellë dhe Preocë;	Komuna; Donatorët; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;	Komuna;	L	AM	L	Komuna; Donatorët; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;	Ndërtimi i fabrikës për pastrimin e ujërave të zeza;
		O2: Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike dhe furnizimi me energji elektrike:								
		2.1.	Prodhimi i elektricitetit nga burimet e ri-përtëritshme të energjisë;	Komuna; Korporata Energjetike e Kosoves; Donatorët; Ministria e Zhvillimit Ekonomik;	Partneriteti Publiko Privat; Korporata Energjetike e Kosoves;	M	AGJ	L	Komuna; Donatorët; Ministria e Zhvillimit Ekonomik;	Numri i KW të prodhuara nga burimet alternative të energjisë;
		2.2.	Ndërtimi i një fabrike për prodhimin e biomasës;	Komuna; Korporata Energjetike e Kosoves; Donatorët; Ministria e Zhvillimit Ekonomik;	Partneriteti Publiko Privat; Korporata Energjetike e Kosoves;	M	AGJ	M	Komuna; Donatorët; Ministria e Zhvillimit Ekonomik;	Numri i KW të prodhuara nga biomasa;
		2.3.	Ndërtimi i impiantit për prodhimin e energjisë nga biomasa;	Komuna; Korporata Energjetike e Kosoves; Donatorët; Ministria e Zhvillimit Ekonomik;	Partneriteti Publiko Privat; Shoqata e Fermerëve;	M	AGJ	M	Komuna; Donatorët; Ministria e Zhvillimit Ekonomik;	Ndërtimi i fabrikës dhe numri i tonelatës së biomasës së prodhuar;
		2.4.	Ndërtimi i infrastrukturës nën-tokësore në Graçanicë dhe Lapnasellë dhe në vende ku është e nevojshme;	Komuna; Korporata Energjetike e Kosoves; Ministria e Zhvillimit Ekonomik;	Donatorët;	L	AM	L	Komuna; Donatorët; Korporata Energjetike e Kosoves; Ministria e Zhvillimit Ekonomik;	% e mbullimit të fshatrave/vendbanimeve me infrastrukturë nëntokësore;
		2.5.	Revitalizimi i rrjetit ekzistues elektrik;	Komuna; Korporata Energjetike e Kosoves;	Komuna;	M	V	L	Komuna; Donatorët; Korporata Energjetike e Kosoves; Ministria e Zhvillimit Ekonomik;	-
		O3: Mbulimi me rrjetin e telekomunikacionit:								
		3.1.	Ndërtimi i rrjetit nëntokësor të telekomunikimit në Graçanicë;	Komuna; Kompania e Telekomunikacionit; Ministria e Infrastruktues;	Përdoruesit;	L	AGJ	M	Kompania e Telekomunikacionit; Ministria e Infrastruktues;	% e mbullimit të fshatrave/vendbanimeve me rrjetin e IT-së;
		3.2.	Instalimi i infrastrukturës së rrjetit me kablo me fibra optike në të gjitha zonat;	Komuna; Kompania e Telekomunikacionit; Ministria e Infrastruktues;	Përdoruesit;	L	AGJ	M	Kompania e Telekomunikacionit; Ministria e Infrastruktues;	% e mbullimit të vendbanimeve me rrjetin e infrastrukturës optike;
		3.3.	Zgjerimi i rrjetit ekzistues të telekomunikimit në Graçanicë;	Komuna; Kompania e Telekomunikacionit; Ministria e Infrastruktues;	Përdoruesit;	M	ASH	M	Kompania e Telekomunikacionit; Ministria e Infrastruktues;	% e zgjerimit të rrjetit ekzistues;
		O4: Përmirësimi i menaxhimit me mbeturinat e ngurta:								
		4.1.	Themelimi i një ndërmarrje lokale në pronësi publike;	Komuna; Ministria e Administratës Publike; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;	Popullsia; Donatorët;	L	AM	M	Komuna; Donatorët; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;	Themelimi i Ndërmarrjes publike;
		4.2.	Ndërtimi i varrezave të kafshëve;	Komuna;	Shoqata e Fermerëve; Donatorët;	M	AM	M	Komuna; Donatorët;	Ndërtimi i varrezave për kafshët /deponia;
		4.3.	Deponi për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave mjekësore afër qendrës klinike spitalore;	Komuna; Ministria e Shëndetësisë;	Popullsia; Institucionet Shëndetësore; Donatorët;	L	AGJ	M	Komuna; Ministria e Shëndetësisë; Donatorët;	Ndërtimi i deponisë së përkohshme;
		4.4.	Deponi për mbeturinat e ndërtimit;	Komuna;	Popullsia; Donatorët;	M	AGJ	M	Komuna; Donatorët;	Ndërtimi i deponisë ndërtimore;
		O1: Zvogëlimi i trafikut të dendur në qendër të Graçanicës:								
		1.1.	Ndërtimi i unazës në Graçanicë;	Komuna; Ministria e Infrastruktues;	Ministria e Zhvillimit Ekonomik; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Donatorët, Popullsia;	L	AM	L	Komuna; Donatorët; Ministria e Infrastruktues;	Ndërtimi i rrethrotullimit në Graçanicë;
		1.2.	Zgjerimi i kapaciteteve për parking në Graçanicë dhe Lapnasellë;	Komuna;	Popullsia; Donatorët; Sektori privat;	M	AM	M	Komuna; Donatorët;	Numri i vendbanimeve të reja për parking në Graçanicë dhe Lapnasellë;
		1.3.	Ndërtimi i një garazhe të parkingut;	Komuna;	Popullsia; Donatorët; Sektori privat;	M	AM	M	Komuna; Donatorët; Sektori privat;	Ndërtimi i garazhave publike dhe numri i vendbanimeve të reja të fituara për parking;
		O2: Përmirësimi i trafikut për këmbësorë dhe me biçikletë dhe hapësirave publike:								
		2.1.	Ndërtimi i trotuaeve në të gjitha zonat;	Komuna; Donatorët;	Popullsia;	M	AM	M	Komuna; Donatorët;	Numri i km për shëtitje/ecjen në këmbë;
		2.2.	Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta aty ku është e mundshme;	Komuna; Donatorët;	Popullsia;	M	AM	L	Komuna; Donatorët;	Shtigjet për këmbësorë, numri i km;
		2.3.	Ndërtimi i qasjeve dhe rrugëve për persona me nevoja të veçanta;	Komuna; Donatorët;	Popullsia;	M	AM	M	Komuna; Donatorët;	% e objekteve publike me qasje për persona me aftësi të kufizuara;

Strategjia 2: Përmirësimi i lëvizshmërisë përmes Komunës së Graçanicës	O3: Formimi i koridorëve të gjelbra në Komunë								
	3.1.	Ndërtimi i një korridorit të gjelbër përgjatë lumit Graçanka në vendbanime si dhe ndërtimi i një shtegu për këmbësor dhe biçikleta nga Graçanica deri në fshatin e Lapnasell;	Komuna; Donatorët;	Popullsia;	M	AGJ	M	Komuna; Donatorët;	Numri i hektarëve të projektuara si koridor i gjelbër dhe numri i km - ve të shtigjeve për biçikleta;
	3.2.	Ndërtimi i një zone të gjelbër zbutëse përgjatë rrugëve;	Komuna; Donatorët;	Popullsia;	M	AGJ	M	Komuna; Donatorët;	Numri i hektarëve të projektuara për zonën tampon të gjelbër;
	O4: Përmirësimi i rrjetit rrugor:								
	4.1.	Rindërtimi dhe ndërtimi i rrugëve lokale përmes komunës;	Komuna; Donatorët;	Popullsia;	L	AGJ	L	Komuna; Donatorët;	Numri i km- ve të ndërtuara dhe të rindërtuara për rrugët e reja;
	4.2.	Ndërtimi i ndriçimit përgjatë rrugëve kryesore;	Komuna; Donatorët;	Popullsia; Korporata Enerjetike e Kosoves;	L	AGJ	L	Komuna; Donatorët;	Numri i km- ve të rrugëve të ndriçuara;
	4.3.	Shënjimi i të gjitha rrugëve me sinjalizim horizontal dhe vertikal;	Komuna; Donatorët;	Popullsia; Ministria e Infrastruktues;	L	AGJ	M	Komuna; Donatorët;	% e furnizimit të rrugëve me sinjalizim;
	O5: Përmirësimi i transportit publik në Komunën e Graçanicës:								
	5.1.	Ndërtimi i terminalit qendror të autobusëve;	Komuna; Ministria e Infrastruktues; Donatorët;	Popullsia; Sektori privat;	L	AM	L	Komuna; Ministria e Infrastruktues; Donatorët;	Ndërtimi i Stacionit kryesor të autobusëve;
	5.2.	Studimi i fizibilitetit mbi nevojat e transportit publik;	Komuna; Ministria e Infrastruktues; Donatorët;	Popullsia;	L	AM	U	Komuna; Donatorët;	Dokumenti përfundimtar mbi studimin e fizibilitetit;
	5.3.	Ndërtimi i garazhit për automjetet e transportit publik;	Komuna; Ministria e Infrastruktues; Donatorët;	Popullsia; Sektori privat;	L	AM	M	Komuna; Ministria e Infrastruktues; Donatorët;	Ndërtimi i garazhës për transportin publik dhe numri i vendeve për parkingun e veturave.

*Afatshkurtër (1-3 vjet); Afatmesëm (deri 6 vjet); Afatgjatë (më shumë se 6 vjet); I vazhdueshëm (aktiviteti që zhvillohet vazhdimisht);

**Minimale (< 1 000 €); Të ulta (<10 000 - ≥ 1 000€); Mesatare (<500 000 - ≥10 000 €); Të larta (≥500 000€).

FUSHA TEMATIKE	STRATEGJIA	KODI	AKTIVITETET/ PROJEKTI/ PROGRAMI	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	SUBJEKTET E TJERË TË PËRFSHIRË	PRIORITETI I lartë- L Mesatar- M I ulët- U	KORNIZA KOHORE* Afatshkurtë- ASH Afatmesme- AM Afatgjatë- AGJ E vazhdueshme- V	IMPLIKACIONET FINANCIARE** Minimale- MIN Të ulta- U Mesatare- M Të larta- L	LINJA BUXHETORE	INDIKATORET	
MIEDISI, BURIMET NATYRORE DHE TRASHËGIMIA KULTURORE	Strategjia 1: Mbrojtja e mjedisit dhe Burimeve natyrore	O1: Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndikimi i kemikaljeve (bujqësore):									
		1.1.	Ngritja e vetëdijes në komunitet në lidhje me përdorimin e mjeteve kimike;	Komuna;	OJQ, Kooperativa bujqësore;	M	ASH	U	Komuna;	Trajnimi dhe fushata për ngritjen e vetëdijes për përdorimin e pesticidëve (5 trajnime apo fushata vjetore);	
		1.2.	Vlerësimi i kontaminimit të tokës bujqësore;	Komuna;	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencioni i Pyjeve;	M	ASH	U	Komuna; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencioni i Pyjeve;	Raporti i dorëzuar komunës për ndotjen e tokës;	
		1.3.	Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza (Graçanica, Prishtevka Zegovka, Janjevka, Sitnica - bashkëpunimi ndër komunal);	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Komuna e Lipjanit; Komuna e Prishtinës;	L	AM	L	Komuna; Donatorët; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencioni i Pyjeve;	Llojet & numrat e stacioneve për përpunimin e ujërave të zeza/stacionet e pompimit dhe %;	
		1.4.	Performimi i një "pastrimi" hapësinor;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Sektori OJQ; Qytetarët;	M	V	U	Komuna; Donatorët;	-	
		O2: Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimi i paligjshëm:									
		2.1.	Kampanja një-vjeçare për informimin e qytetarëve dhe ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e zonave të lejuara dhe të ndaluara të ndërtimit në zonat bujqësore;	Komuna- Departamenti i Inspekcionit dhe Shërbimeve Publike;	Sektori OJQ; Kooperativa Bujqësore;	L	ASH	MIN	Komuna;	Organizimi i fushatës/mbikqyrja mediale dhe hulumtimet lidhur me ndikimin e fushatës;	
		2.2.	Fuqizimi i inspektoratit (të fuqizohen kontrollet dhe inspektimet në terren për ndërtime ilegale);	Komuna;	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;	L	ASH	U	Komuna; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;	Numri i rasteve të raportuara nga terreni;	
		O3: Ndalimi i prerjes së pyjeve dhe pyllëzimit:									
		3.1.	Rripi i gjelbër përgjatë deponisë së Kishnicës;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencioni i Pyjeve;	L	ASH	MIN	Komuna; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencioni i Pyjeve;	Organizimi i fushatës/mbikqyrja mediale dhe hulumtimet mbi ndikimin e fushatës;	
		3.2.	Parandalimi i erozioneve duke vendosur mbeturinat e ndërtimit në vendet erozive të Kishnicës;	Komuna; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencioni i Pyjeve;	Sektori OJQ;	M	V	L	Donatorët;	Hektarët e përcaktuara për pyllëzim;	
		3.3.	Ngritja e vetëdijes për ekologjinë dhe shpyllëzimin ilegal;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencioni i Pyjeve;	L	ASH	MIN	Komuna; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencioni i Pyjeve;	Organizimi i fushatës/mbikqyrja mediale dhe hulumtimet lidhur me ndikimin e fushatës;	
		3.4.	Pyllëzimi i tokës erozive afër deponisë së Kishnicës;	Komuna; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Agjencioni i Pyjeve;	Sektori OJQ;	M	V	U	-	Numri i hektarëve të pyllëzuara;	
		3.5.	Rehabilitimi i parqeve ekzistuese përmes përdorimit të materialeve natyrore lokale dhe krijimit të qasjes për të gjithë;	Komuna;	Donatorët;	M	AM	M	Komuna; Donatorët;	Numri i hektarëve të projektuara, si dhe të realizuara për parkun në territorin e Komunës;	
		O4: Përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë:									
		4.1.	Ndërtimi i ndriçimit solar publik;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Ministria e Infrastruktues;	L	V	L	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Ministria e Infrastruktues; Donatorët;	% e ndriçimit publik me energji diellore;	
		4.2.	Ndërtimi i një impianti të energjisë së ri-përtëritshme të energjisë me biomasë;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;	M	AGJ	L	Donatorët; Sektori privat; Komuna;	KW e prodhuara nga prodhimi i biomasës;	
		4.3.	Realizimi i një fushate për të ngritur vetëdijen e komunitetit mbi rëndësinë e përdorimit të energjisë së biomasës dhe energjisë diellore;	Komuna;	Sektori OJQ;	M	ASH	MIN	Komuna;	-	
		O5: Përmirësimi i cilësisë së ujit, ajrit dhe tokës përmes zgjidhjes së problemit të djerrinës dhe deponive ilegale:									
		5.1.	Ngritja e vetëdijes mbi çështjet e mjedisit;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Sektori OJQ;	L	AM	M	Komuna; Donatorët; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	Numri i fushatës mbi mrojtjen e mjedisit;	
		5.2.	Zbatimi i gjobave komunale për hedhje të paligjshme të mbeturinave;	Komuna;	Komuna- Departamenti I Inspekcionit;	L	ASH	U	Komuna, Donatorët;	Numri i gjobave të ekzekutuara për deponinë e paligjshme;	
		5.3.	Rikuperimin e sipërfaqeve ku ka pasur deponi ilegale të mbeturinave/rehabilitim i tokës së degraduar;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	M	ASH	U	Komuna, Donatorët;Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	% e deponive të sanuara ilegale;	
		5.4.	Hartimi i Planit për Menaxhimin e Mbeturinave;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Donatorët;	L	AGJ	M	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Donatorët;	Përpilimi i Planit për menaxhimin e mbeturinave;	
		5.5.	Krijimi i korridorit të gjelbër përgjatë të gjitha rrugëve në vendbanime;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	L	V	M	Komuna; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Donatorët;	km e korridoreve të gjelbër përgjatë rrugëve kryesore;	
		5.6.	Krijimi i korridoreve të gjelbra mbrojtëse përgjatë deponisë së Kishnicës;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	L	V	M	Komuna; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Donatorët;	Numri i zonave të pyllëzuara në hektarë (në vit);	
		5.7.	Largimi i Deponive;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Ministria e Zhvillimit Ekonomik-minierat;	L	AGJ	L	-	-	
		5.8.	Vlerësimi i cilësisë së ujërave nga pusët;	Komuna;	Ministria e Shëndetësisë- Instituti I Shendetit Publik;	L	V	U	Komuna; Ministria e Shëndetësisë; Donatorët;	Cilësia e ujit nga pusetat dhe analiza e sigurisë që kryhet në mënyrë periodike;	
		5.9.	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatrat Radevë, Skulanevë, Lepinë, Batushë, Suhadoll;	Komuna;	Ministria e Infrastruktues; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	L	AM	L	Ministria e Infrastruktues; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Donatorët;	% e zgjerimit të rrjetit publik të ujësjellësit;	
		5.10.	Rregullimi i shtratit të lumit dhe krijimi i korridorit të gjelbër (Ruatja e Biodiversitetit);	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	L	V	U	Komuna;	% e zonave të mbuluara me hapësirë të gjelbër publike (ndryshimi i situatës ekzistuese);	
		Strategjia 2: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore	O1: Mbrojtja e trashëgimisë kulturore (arkitektonike, arkeologjike, peisazhet kulturore, trashëgimia shpirtërore):								
			1.1.	Studimi në vendin/zonën arkeologjike në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si dhe Institutit të Arkeologjisë;	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Komuna;	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit- Institutit Arkeologjise dhe Muzeu;	L	AM	L	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Donatorët;	Numri i m ² të pambuluara në vendet arkeologjike;
			1.2.	Ri-përcaktimin e aktiviteteve në vendin arkeologjik Ulpiana;	Komuna;	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;	L	V	U	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Donatorët;	Plani i hartuar për mbrojtjen e Ulpianës;
			O2: Promovimi i vlerës së trashëgimisë kulturore:								
			2.1.	Promovimi i trashëgimisë kulturore, përmes vizitave turistike në vendet kulturore (Manastiri i Graçanicës, vendi arkeologjik Ulpiana);	Komuna;	Organizata Turistike; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;	M	V	MIN	Komuna; Donatorët; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	% e rritjes vjetore në turizëm (numri i turistëve që do ta vizitojnë Manastirin, Ulpianën);
		2.2.	Shënjtimi i ditëve të trashëgimisë/Ditët e Trashëgimisë Evropiane çdo Shtator;	Komuna;	Organizata Turistike; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;	M	V	MIN	Komuna; Donatorët; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	Numri i ngjarjeve dhe eventeve gjatë Ditës së Trashëgimisë Evropiane;	

O1: Zvogëlimi i ndikimit negativ në mjedis në fushat e prira për fatkeqësitë natyrore përmes hartimit të PZHU (Vlësimi i rrezikut dhe menaxhimi i fatkeqësisë):									
Strategjia 3: Zvogëlimi i rrezikut dhe përmirësimi i ndikimeve negative në mjedis	1.1.	Kryerja e një studimi për të parandaluar përmbytjet;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;	L	ASH	M	Komuna; Donatorët; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;	Studimi i dorëzuar për zonat e prirura për përmbytje në Komunë;
	1.2.	Rregullimi i shtratit të lumit-për të parandaluar përmbytjet e lumenjve;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Fakulteti i Biologjisë;	M	AM	L	Donatorët; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor;	% e reduktimit të zonave të prirura për përmbytje (shtrati i përmirësuar të lumit);
	1.3.	Të kryhen kufizimet e përdorimit të tokës në zona të prirura për përmbytje;	Komuna;	Qeveria e Kosovës; Ministria e Punëve të Brendshme-Agjencioni për Mbrojtje dhe Emergjencë;	M	AM	M	Komuna; Ministria e Punëve të Brendshme-Agjencioni për Mbrojtje dhe Emergjencë;	Plani i dorëzuar i PZHK në Komunë;
	1.4.	Zhvillimi i mbrojtjes nga zjarri, plani i evakuimit/themelimi i njësive të zjarrfikëseve;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Fakulteti i Biologjisë;	M	AM	MIN	Komuna;	Plani i dorëzuar i PZHK në Komunë;
	1.5.	Pyllëzimi i zonave erozive;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;	L	AM	M	Komuna; Donatorët;	Numri i hetarëve të pyllëzuara;
	1.6.	Të hetohet kapaciteti mbajtës i tokës para ndërtimit dhe respektimit të kodit të ndërtimit;	Komuna;	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor; Fakulteti i Ndërtimtarisë;	L	V	MIN	Partneriteti Publiko Privat;	Plani i dorëzuar i PZHK në Komunë;
	1.7.	Vlerësimi dhe meremetimi i ndërtesave ekzistuese publike për karakteristika seizmike;	Komuna;	Qeveria e Kosovës; Ministria e Punëve të Brendshme;	L	AGJ	L	Komuna; Donatorët; Ministria e Punëve të Brendshme;	Plani i dorëzuar i PZHK në Komunë.

*Afatshkurtër (1-3 vjet); Afatmesëm (deri 6 vjet); Afatgjatë (më shumë se 6 vjet); I vazhdueshëm (aktiviteti që zhvillohet vazhdimisht);

**Minimale (< 1 000 €); Të ulta (<10 000 - ≥ 1 000€); Mesatare (<500 000 - ≥10 000 €); Të larta (≥500 000€).

6. DISPOZITAT PËR ZBATIM

Ky kapitull ofron dispozita të obligueshme që rrjedhin nga korniza ligjore dhe të cilat drejtojnë zbatimin e planit.

6.1. Udhëzimet për Interpretim të PZHK gjatë hartimit të PRrU/ PHRr dhe planeve tjera

- PZHK propozon udhëzime për zhvillim në zona brenda dhe jashtë vendbanimit.
 - PZHK drejton të gjithë sektorët përkatës komunal lidhur me zhvillimin e programeve dhe projekteve të ardhshme përmes udhëzimeve tematike të përcaktuara në Kornizën e Zhvillimit dhe Planin e Veprimit.
 - PZHK drejton zhvillimin e planeve ose programeve të ardhshme, të tilla si: PZHU-në, Programin e banimit, strategjinë e zhvillimit ekonomik, planin rregullues të tokës , si dhe planet tjera që sipas ligjit në fuqi mund të bëhen të obligueshme.
1. Rregullat e PZHK-së të paraqitura në faqet e mëposhtme drejtojnë zhvillimin e PZHU-së, të cilat duhet të plotësojnë konceptin e zhvillimit për zonën e fokusuar të përcaktuar me kornizën e zhvillimit.
 2. PZHK jep analizën e situatës në fushën e demografisë, kushtet socio - ekonomike, tendencat e banimit dhe tipologjisë, si dhe projeksionet e popullsisë, tipologjinë e propozuar për banimi në përputhje me kufijtë e vendbanimit dhe zhvillimit që do të drejtonte analizën e detajuar ashtu siç kërkohet nga Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit nr. 03/L-164 si dhe udhëzimet relevante administrative për zhvillimin e programeve të banimit.
 3. PZHK sugjeron një zonë potenciale për rregullimin e tokës bujqësore përmes planeve të shfrytëzimit të tokës, në përputhje me Ligjin për Rregullimin e Tokës nr. 04/L-040.

6.2. Kushtet që Përcaktohen nga Rregulloret e Qeverisë Lokale në Lidhje me Zhvillimin dhe Shfrytëzimin e Tokës në Komune

Parimet udhëzuese për planifikimin e shfrytëzimit të tokës

- Plani Komunal i shfrytëzimit të tokës është një interpretim hapësinor i vizionit dhe qëllimeve strategjike të përcaktuara nga plani, ndërtuar mbi potencialet kryesore për zhvillimin socio-ekonomik, me theks të veçantë në çështjet e mjedisit. Përmes planit për shfrytëzimin e tokës, PZHK-ja definon:
 1. Zonat e banuara, duke përfshirë banimin, infrastrukturën sociale, hapësirat publike dhe administratën publike;
 2. Trashëgimia kulturore -lokacionet e mbrojtura;
 3. Zonat ekonomike komunale;
 4. Toka bujqësore, duke përfshirë edhe pemishtet;
 5. Pyjet.
- Plani i shfrytëzimit të tokës është në përputhje me udhëzimet dhe kufizimet e përcaktuara me Ligjin për Tokën Bujqësore nr. 02/L-26 në lidhje me shfrytëzimin e tokës bujqësore, duke e pasur parasysh edhe kategorinë e saj, Ligji për Tokën Ndërtimore 14/80 dhe 42/86, i cili përcakton karakterin e zonës brenda një zone të populluar, Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura nr. 03/L-039 që përcakton zonën e mbrojtur rreth manastirit të Graçanicës, si dhe Ligjin për Miniera dhe Minerale nr. 03/L-163 që përcakton kufizimet në lidhje me mbeturinat e xehes së minierës së Kishnicës.

6.3. Kushtet e Rregullave Hapësinore

- PZHK rregullon ndërtimin në vendbanime në përputhje me nivelin hierarkik të identifikuar në Kornizën Zhvillimore.
- Ndërtimi lejohet vetëm brenda kufijve të zhvillimit që përcaktohen nga PZHK-ja.
- Zgjerimi i vendbanimit do të zhvillohet me një qasje të arsyeshme financiare. Ndërtimi në kuadër të kufijve të dhënë nuk do të lejohet nëse distanca nga infrastruktura teknike ekzistuese (rruga, energjia elektrike, uji dhe rrjeti i ujërave të zeza) është më e madhe se 150 metra.

6.4. Objektet/ Zonat me Rëndësi Kombëtare

PZHK përmend dy lokalitete kryesore që paraqesin zona të rëndësisë kombëtare:

- Manastiri i Graçanicës, i përcaktuar me Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura nr. 03/L-039 si një nga zonat e mbrojtura në territorin e Kosovës dhe përcakton një tampon zonë për të cilën vlejnë më shumë kufizime kur është fjala për zhvillimin e ardhshëm.
- Lokaliteti arkeologjik Ulpiana. Të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me zhvillimet brenda tampon zonës 100m nga kufiri i zonës së mbrojtur arkeologjike, duke përfshirë edhe gërmimet arkeologjike, i përcakton Ligji për Trashëgiminë Kulturore nr. 02/L-88 neni nr.7. Në të gjitha rastet kërkohet që tek institucionet përkatëse në nivel qendror, të paraqiten kërkesat për shqyrtim.
- Mbeturinat e xehes së Kishnicës, e cila është pjesë e Trepçës, sipas VSM-së konsiderohet të jetë kërcënimi më i madh për mjedisin dhe shëndetin publik. Për shkak të zgjerimit joformal të vendbanimit, Graçanica ka hyrë në tampon zonën e përcaktuar nga Ligji i Minerave dhe Mineraleve nr. 03/L-163. Komuna ka paraparë shumë aktivitete me qëllim të zbutjes së ndikimit në vendbanim. Prapëseprapë, komuna ka të drejtë të miratojë një sërë masash të cilat poseduesi i lejes është i detyruar që të i respektojë në mënyrë të zvogëlimit të ndikimit në shëndetin publik.

6.5. Zona e Vendbanimit

- PZHK përmes kufijve zhvillimor ka caktuar tokë të mjaftueshme për të akomoduar rritjen e parashikuar të popullsisë dhe infrastrukturën përcjellëse fizike.
- Komuna është e detyruar që të sigurojë vetëm infrastrukturën sociale dhe teknike brenda kufijve të caktuar të vendbanimit në lokalitetin e planifikuar në PZHK.
- Procedurat e parcelizimit që do të kryhen në pajtim me rregullat e përcaktuara më poshtë me Ligjin për Kadastër nr. 04/L-013 dhe Udhëzimin Administrativ 02 /2013 mbi zbatimin e Ligjit mbi Kadastër .

6.6. Princippet Udhëheqëse për Caktimin e Aktiviteteve Ekonomike

Siperfaqet per perdorimin e bashkerenditur në kuadër të vendbanimeve:

- Aktivitetet që bien në këtë kategori janë ato të tregtisë dhe të shërbimeve.
- Aktivitetet që bien në këtë kategori mund të vendosen brenda Zonës komerciale dhe banesore, të përcaktuara në planin e përdorimit të tokës.
- Aktivitetet ekonomike që bien në këtë kategori dhe për të cilat është e nevojshme marrja e lejes ekologjike komunale, siç është përcaktuar në shtojcën e udhëzimit administrativ nr. 10/2012 për lëshimin e lejes ekologjike komunale.
- Komuna është e detyruar të përcaktojë standardet/normat minimale për aktivitetet e lartpërmendura në periudhën gjashtë mujore.
- Aktivitetet e kufizuara ekonomike brenda tampon zonës së manastirit të Graçanicës cilën e përcakton Ligji mbi zonat e veçanta të mbrojtura nr. 03/L-039 janë të përcaktuara:
Neni nr. 5 i cili parandalon aktivitet në vijim:
 - a) Aktivitetet industriale siç janë hulumtimet dhe shfrytëzimet e burimeve minerale, ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo largpërçueseve, shkriretoreve dhe fabrikave dhe rrugëve të tranzitit në zonat rurale; dhe
 - b) Ndërtimi apo aktivitetet zhvillimore që çojnë deri te shpyllëzimi dhe ndotja e mjedisit.
Neni nr. 6, i cili kufizon aktivitet në vijim nëse nuk aprovohen nga Kisha Ortodokse. Në këtë rast palët i drejtohen Këshillit për zbatim dhe monitorim (KZM), i cili i shqyrton kërkesën në pajtim me ligjin nr. 4:
 - a) objektet komerciale apo zhvillimi i objekteve të tilla të cilat janë më të larta se sa Manastiri/kisha/monumentet kulturore të cilat janë të mbrojtura; ndërtimi i rrugëve; ndërtimi i depove, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeneve, hoteleve/moteleve, tezgave me ushqim dhe kioskave, pompave të benzinës dhe serviseve për riparime të automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës dhe çdo ndërtesë tjetër në zonat rurale;
 - b) tubimet publike, rekreative dhe argëtuese; dhe
 - c) urbanizimi i tokës bujqësore.
 - Të gjitha kufizimet dhe procedurat e zbatueshme në përgjithësi, të cilat i referohen Lokalitetit arkeologjik të Ulpianës duhet të jenë në përputhje me Ligjin mbi trashëgiminë kulturore nr. 02/L-88 të Neni nr. 7.
 - Të gjitha kufizimet dhe procedurat e zbatueshme të cilat i referohen tampon zonës së deponisë së Kishnicës është e nevojshme të përputhen me Ligjin mbi minierat dhe mineralet nr. 03/L-163, Neni 8 dhe Neni 13.
 - Normat e projekteve të objekteve për përdorim të bashkërenditur, të cilat janë të definuara në tekstin më lartë, duhet të plotësojnë standardet minimale të cilat i përcakton Ligji mbi mbrojtjen nga zhurma, nr. 02/L-102, Neni nr. 5.
 - Udhëzimi Administrativ nr. 03/2009 mbi rregullat teknike për efikasitetin energjetik dhe mbrojtjen termike; Udhëzimi Administrativ nr. 33/2007 mbi rregullat teknike për qasje në ndërtesa ndaj personave me nevoja të veçanta;
 - Kushtet e ndërtimit të cilat i parashirohen aplikuesit për leje të ndërtimit, siç përcaktohet në Udhëzimin Administrativ nr. 10/2013 mbi futjen e procedurave për aplikimin dhe shqyrtimin e kërkesave për fitimin e kushteve dhe lejeve të ndërtimit, duhet të jenë në përputhje me kushtet të cilat i përcakton PZHK-ja.

6.7. Zonat Ekonomike Komunale- Zonat Industriale, te Biznesit dhe Tregtare

- PZHK-ja përmes planit të shfrytëzimit të tokës propozon tokën për sistemin e zonave ekonomike komunale.
- Aktivitet brenda zonës ekonomike janë ekskluzivisht aktivitete ekonomike.
- Ligji mbi zonat ekonomike nr. 03/L-129 kufizon aktivitetet ekonomike në ato të cilat nuk kanë ndikim në mjedis, florën, faunën dhe pasuritë kombëtare të Republikës së Kosovës, të cilat nuk janë në kundërshtim me ligjin në fuqi.
- PZHK kërkon që zonat ekonomike të posedojnë tampon zonë të gjelbër, si mjet për zbutjen e ndikimit.
- PZHK dekurajon qasjet në zonat ekonomike nëpër zonat e banuara.
- Normat e projekteve për ndërtesa administrative, tregtare dhe shërbyese duhet t'i plotësojnë standardet minimale të cilat i përcaktojnë udhëzimet administrative, siç janë:
Udhëzimi Administrativ nr. 03/2009 mbi rregullat teknike për efikasitetin energjetik dhe mbrojtjen termike; Udhëzimi Administrativ nr. 33/2007 mbi rregullat teknike për qasje në ndërtesa ndaj personave me nevoja të veçanta.

6.8. Parimet Kryesore për Përcaktimin e Funksioneve Publike

- PZHK-ja ka planifikuar infrastrukturën e funksioneve publike në përputhje me normat dhe standardet e përcaktuara nga ministrinë përkatëse.
- Në rastin kur nuk ka tokë komunale për ofrimin e shërbimeve në një vend të përshtatshëm, sipas Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr .03/L-139, Neni 4, Komuna mund të blejë pronën private në një vend që i përshtatet qëllimeve për të ofruar shërbime përkatëse.
- Normat e projekteve për institucione arsimore, sportive dhe rekreative, shëndetësore siç janë edhe për shërbimet e tjera si kopshtet e fëmijëve, strehimoret apo qendrat sociale, duhet t'i plotësojnë kushtet minimale të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ si:
Udhëzimi Administrativ nr. 03/2009 mbi rregullat teknike për efikasitetin energjetik dhe mbrojtjen termike; Udhëzimi Administrativ nr. 33/2007 mbi rregullat teknike për qasje në ndërtesa ndaj personave me nevoja të veçanta;

Mbrojtja Shendetesore

- Ligji mbi mbrojtjen shëndetësore nr. 2004/4 Neni nr. 74 rregullon institucionet shëndetësore në tri nivele:
 1. Institucionet e kujdesit parësor shëndetësor;
 2. Institucionet e kujdesit sekondar shëndetësor;
 3. Institucionet e kujdesit terciar shëndetësor.

PZHK parasheh dispozitat për:

 - a) Institucionet e kujdesit parësor shëndetësor
 - b) Qendrat e mjekësisë familjare;
 - c) Shtëpitë shëndetësore;
 - d) Barnatoret;

Institucionet e kujdesit sekondar shëndetësor

 - a) a)Spitalet;
 - b) b) Qendrat diagnostike dhe terapeutike;
 - c) c) Qendrat e shëndetit oral dhe kujdesjen dentare;
 - Rehabilitimi i objekteve ekzistuese të kujdesit parësor shëndetësor do të jetë në përputhje me
 - Udhëzimin Administrativ nr. 15/2000 mbi themelimin e qendrave për mjekësi familjare.

Arsimi

- Ligji mbi arsimin parauniversitar nr. 04/L-032 rregullon arsimin parashkollor dhe parauniversitar në katër nivele : 0|arsimi parashkollor ; 1|arsimi fillor; 2|arsimi i mesëm i ulët; 3| arsimi i mesëm i lartë 4| arsimi i lartë.
- Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve përkatëse arsimore të parapara me PZHK do të jetë në përputhje me Udhëzimet për standarde dhe norma për kapacitetet arsimore të cilat i ka sjellë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Tom I dhe II, si dhe udhëzimet të cilat i parasheh PZHK-ja siç janë:

Arsimi parashkollor

Distanca maksimale banimi /shkolla: 400- 600 m;
Sipërfaqja e parcelës/ për fëmijë: 20- 40 m²/për fëmijë;
Numri maksimal i fëmijëve /objekti: 120 fëmijë;

Arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët

Distanca maksimale banimi /shkolla: 500- 800 m;
Sipërfaqja e parcelës/ për fëmijë: 7- 16 m²/për fëmijë;
Numri maksimal i fëmijëve /objekti: 500- 800 fëmijë;

Arsimi i mesëm i lartë

Distanca maksimale banimi /shkolla: 1000- 1500 m;
Sipërfaqja e parcelës/ për fëmijë: 6.4- 11.5 m²/për fëmijë;
Numri maksimal i fëmijëve /objekti: 500- 600;

Arsimi i lartë

Normat dhe standardet për ndërtimin e universitetit përcaktohen me statutin e komunës.

Kultura, Rinia, Sporti dhe Rekreacioni

- Departamenti përkatës i komunës është i obliguar të hartojë draft detyrën në përputhje me standardet përkatëse.
- PZHK-ja rekomandon që të gjitha objektet apo komplekset të kenë qasje direkte në hapësira publike ose të kenë 20% të hapësirës së gjelbër të hapur (bllok) brenda parcelës.

6.9. Parimet udhëzuese për përcaktimin e shtigjeve dhe korridoreve dhe sistemeve të tjera të infrastrukturës

Korridoret e Gjelberta dhe Shtigjet per Bicikleta

- Rrjeti i lëvizshmërisë të ngadalshme buzë kurseve të lumenjve (Sitnicës, Graçanicës), lokalitetit arkeologjik të Ulpianës dhe vendeve me rëndësi natyrore (Badovci, Radeva) do të ndërtohet nga shtresa e depërtueshme sipërfaqësore.

Rrjeti Hekurudhor

- Ligji mbi hekurudhat nr. 04/L-040 përcakton tampon zonën prej:
- 25 m nga aksi i binareve për ndërtimin e objekteve banesore, biznesore, ndihmëse dhe të ngjashme, gërmimi i puseve, tankeve, gropave septike, ndërtimi i largpërçueseve dhe 50 m nga aksi i binareve për hapjen e minierave, guroreve, ndërtimi i objekteve për prodhim të gëlqeres apo të tullave, ndërtimi i objekteve industriale dhe objekteve të ngjashme në zonën e mbrojtur.

Rrjeti Rrugor

- Ligji mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi rrugët 2003/11 (Ligji 03/L-120) përcakton rrugët në 7 kategori:
Kompetencë e administratës qendrore:
 - a) Autostradat;
 - b) Rrugët kombëtare;
 - c) Rrugët regjionale.Kompetencë e administratës lokale:
 - d) Rrugët lokale;
 - e) Rrugët në vendbanime;
 - f) Rrugët e paklasifikuara.
- Në rast të ndërtimit të rrugës së re ose të rindërtimit të cila kërkon zgjerimin e shiritave të rrugës në toka private, komuna ka të drejtë për të blerë pronën private në përputhje me rregullat e përcaktuara me Ligjin mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139.
- Ligji mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi rrugët 2003/11 (Ligji 03/L-120) Neni nr. 26 përcakton tampon zonën për kategoritë e ndryshme të rrugëve në përputhje me funksionet në mjedise të cilat përcaktojnë shiritat e rrugëve të reja dhe kufizojnë ndërtimin në vendbanimet ku kalojnë rrugët.
Distanca minimale prej rrugëve publike, kur është fjala për aktivitetet-funksionet siç janë hapja e minierës, ndërtimi i pellgjeve artificiale ose instalime tjera të cilat mund të dëmtojnë rrugët publike është:
 - a) 100 m nga autostrada;
 - b) 60 m nga rruga kryesore;
 - c) 40 m nga rruga regjionale;
 - d) 30 m nga rruga lokale.Distanca minimale prej rrugëve publike, kur është fjala për ndërtimin e ndërtesave, shtëpive, ndërtesave për zyre, gropave septike, puseve, largpërçueseve ose instalimeve të ngjashme të cilat mund të dëmtojnë rrugët publike është:
 - e) 40 m nga autostrada;
 - f) 20 m nga rruga kryesore;
 - g) 10 m nga rruga regjionale dhe lokale.
- Ndërtimi dhe riparimi i rrugëve do të jetë në përputhje me standardet e vendosura me Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor nr. 02/L-70 mbi mirëmbajtjen dhe shënimin. Normat e rëndësishme që dalin nga ky Ligj, Nenet 8, 9 dhe 10 kur është fjala për projektimin janë:
 - Rrugët publike duhet të posedojnë 2 shirita dhe 2 shirita terminal pa ndërprerje në tërë gjatësinë e tyre të njëjtës gjatësi e cila ndryshon sipas llojit të rrugës. Rrugët lokale mund të kenë vetëm një shirit të komunikacionit në rastet kur në gjatësi prej më shumë se 500 m ekziston mundësia e ndërtimit të një zgjerimi të duhur për tejkalimin e veturave të cilat vijnë nga drejtimet e kundërta.
 - Për gjithë gjatësinë e rrugës, rrugët publike duhet të kenë hapësirë të lirë në lartësi të paktën 4.5 metra.
 - Rrugët publike, përveç rrugëve lokale duhet të jenë në gjendje të mbajnë ngarkesën boshtore prej 15.000 kg, ndërsa kapaciteti i rrugëve lokale duhet të jetë deri në 6000 kg.
 - Ndalesat e autobusëve për hyrje dhe dalje të udhëtarëve, jashtë dhe brenda zonës urbane në autostradë dhe në rrugët regjionale duhet të jenë jashtë shiritave të rrugës.

Ujesjellesi

- Komuna është e obliguar të sigurojë rrjetin e ujësjes në vendet e klasifikuara në PZHK si zona të vendbanimeve, zona biznesore dhe zona ekonomike.

Kanalizimi

- Komuna është e obliguar të sigurojë rrjetin e kanalizimit në zona të klasifikuara në PZHK si zona të vendbanimeve, zona biznesore dhe zona ekonomike.
- Aktivitetet e ndërtimit jashtë zonave të vendbanimeve të specifikuara nën seksionin 5.2.2.c janë të obliguara të sigurojnë një zgjidhje për ujërat e zeza. Në rastet kur lidhja me sistemin e kanalizimit ekzistues nuk është në dispozicion ose departamenti përkatës komunal nuk e konsideron të realizueshëm, projektuesi është i detyruar të paraqesë një zgjidhje të tillë me infrastrukturën mbështetëse duke përdorur ose gropat septike ose ligatinat.
- PZHK rekomandon planin alternativ për përpunimin e ujërave të zeza nën kushtet si më poshtë:
 1. Afërsia e njësisve banesore në aspektin e zhurmës dhe ndotjes së ajrit.
 2. Dispozicioni i tokës dhe kategorisë së pestë të tokës.

6.10. Masat e Mbrojtjes së Peizazhit, Vlerave Natyrore dhe Trashëgimisë Kulturore

- PZHK përcakton lokacionet me vlera të veçanta kulturore. Komuna në bashkëpunim me institucionet përkatëse të qeverisjes qendrore miraton listën e propozuar, konstaton gjendjen aktuale të këtyre objekteve dhe harton planin operativ dhe teknik për restaurimin e këtyre objekteve
- PZHK miraton dhe aplikon masat të cilat i parashihet korniza ligjore që lidhet me Manastirin e Graçanicës dhe lokalitetin arkeologjik të Ulpianës.
- Karakteri arkitektonik i objekteve të cilat parashihen në plan si objekte ndihmëse të lokacionit arkeologjik të lokacionit të Ulpianës duhet të respektojë karakterin e lokacionit. Të gjitha procedurat përkatëse do të jenë në pajtim me Ligjin për trashëgiminë kulturore nr. 02/L-88, Neni nr. 7.
- PZHK përcakton zonën e Liqenit të Badovcit, Ribnjaku në Radev, pjesën përreth lumit të Sitnicës dhe pyjet si lokacione të vlerave të mbrojtura të cilat janë objekte të procedurave të cilat i përcakton Ligji mbi mbrojtjen e natyrës nr. 03/L-233.

6.11. Masat për Parandalimin e Ndikimeve Negative në Mjedis

- Ligji mbi mbrojtjen e mjedisit nr. 03/L-025 Neni nr. 24 obligon komunën të hartojë një plan të veprimit për mbrojtjen e mjedisit lokal dhe programeve mjedisore të cilët duhen të jenë në përputhje me Planin e Kosovës për Veprimin në Mjedis.
- Projektet zhvillimore duhet ta marrin një leje mjedisore nga departamenti përkatës i nivelit qendror që janë subjekt i vlerësimeve të ndikimeve mjedisore, të rregulluara me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nr. 03/L-214 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 25/2012 mbi lejen mjedisore.
- Impiantet për trajtimin e ujërave të zeza duhet të marrin leje të integruar mjedisore nga departamentet përkatëse të qeverisjes qendrore të cilat nuk janë subjekt i vlerësimit të ndikimeve mjedisore, janë të rregulluara me Ligjin mbi parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes nr. 03/L-043. Aktivitetet e planifikuara në PZHK dhe të cilat bien në këtë kategori janë:
 - mini-impiantet për pastrimin e ujërave të zeza.
- Projektet zhvillimore të cilat duhet të marrin leje mjedisore komunale dhe të cilat janë subjekt i vlerësimit të ndikimeve mjedisore janë të rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr. 10/2012 mbi dhënien e lejeve mjedisore komunale.

Raporti i VSM tregon më shumë masa për zbutjen e ndikimeve në mjedis:

 - Vendosija e rrjetit (me kontinuitet) mjedisor,
 - Përdorimi i instalimeve të kombinuara për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes nga biomasa dhe burimeve të ripërtërishme të energjisë,
 - Mbyllja e deponove me kapacitete më pak se 100 m³,
 - Masat për rregullimin e hedhurinave të minierës së Kishnicës siç janë: mbjellja e një brezi të gjelbër rreth hedhurinave, formimi i deponisë së mbeturinave inerte në afërsi të hedhurinave, mbjellja e vegjetacionit përkatës si mënyrë e rehabilitimit të lokacionit.
 - Ulja e konsumit të ujit në 120l/për banor/për ditë,
 - Përmirësimi i transportit publik në mënyrë të uljes të emisionit të CO₂.
 - Futja e ligatinave ku të jetë e mundur.
- Komuna mund të lëshojë leje për ujin në përputhje me procedurat të cilat i përcakton Ligji mbi ujërat në Kosovë nr. 4/L-147 si mënyra për parandalimin e përdorimit të tepruar të burimeve.
- Për aktivitete për të cilat nuk nevojitet leja për ujë, shikoni Nenin nr. 72.

6.12. Masat për Parandalimin e Ndikimeve Negative Sociale

- Komuna do të sigurojë infrastrukturën sociale dhe do të zhvillojë programe dhe aktivitete të cilat do të gjenerojnë dhe të krijojnë kushte për mirëqenie sociale, si mjete të luftës kundër sjelljes negative sociale.
- Komuna do të hartojë programin e punësimit dhe do të kujdeset për ndërmarrjen e aktiviteteve që krijojnë vende të punës duke marrë parasysh interesat e grupeve të ndryshme sociale në bazë të moshës, gjinisë, aftësive, arsimit dhe kështu me radhë.
- Gjatë zhvillimit të projekteve të ndryshme, komuna do të favorizojë potencialet lokale të Graçanicës në kryerjen e aktiviteteve të parashikuara, natyrisht me kusht se edhe ata janë të barabartë me pjesëmarrësit e tjerë që konkurrojnë për projekte.
- Komuna në bashkëpunim me OJQ-të, subjektet biznesore, donatorët etj., do të zhvillojë projekte që rrisin cilësinë dhe sasinë e aktiviteteve sportive dhe kulturore si një mënyrë e përfshirjes së të rinjve në një jetë të shëndetshme sociale.
- Komuna me anë të aktiviteteve të planifikuara do të sigurojë kushtet për të garantuar sigurinë publike, p.sh.
 - Për sigurimin e trafikut dhe lëvizjes gjatë natës, është e rëndësishme që projektet për ndërtimin e rrugëve të jenë të shoqëruara me sigurimin e ndriçimit publik;
 - Komuna nuk do të lëshojë një leje ndërtimi për objekte cilat nuk marrin në konsideratë zbatimin e standardeve të projektit për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara. Këto masa do të parandalojnë ndarjen sociale.
 - Gjatë përgatitjes së PZHU-ve të planifikuara dhe projekteve të tjera të projektimit, komuna duhet të sigurojë pjesëmarrjen e akterëve kryesor, dhe procesin transparent dhe gjithëpërfshirës. Në këtë aspekt komuna duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë informimit dhe si bëhet informimi, me qëllim të eliminimit të çdo mundësie e cila do të sjell ndonjë pakënaqësi te njëra nga palët e interesuara për projektin.

6.13. Masat për Realizimin e Planeve

Përgjegjësia për hartimin e planeve

- Kuvendi komunal është obliguar të sigurojë kushte financiare dhe kushte të tjera për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planeve;
- Planet e propozuara në PZHK duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor;
- Sipas Planit Hapësinor të Kosovës 2010- 2020+, të aprovuar më 2010, për çdo hapësirë me një sipërfaqe më të madhe se 2 ha jashtë zonave urbane duhet të hartohet PRrU/ PHRr;
- Komuna do të hartoj Planet Rregulluese Urbane për zona jashtë hapësirës së banuar;
- Lejet urbanistike dhe ndërtimore për projektet e zhvillimit jashtë zonave urbane lëshohen në përputhje me vendimet e PZHK-së dhe sipas kushteve të përcaktuara në PZHK. Komuna merr parasysh edhe dispozitat ligjore për planifikim urban dhe lejet ndërtimore për objekte në përputhje me Ligjin mbi planifikimin hapësinor 2003/14, Ligjin mbi ndërtimin 04/L-110 dhe Udhëzimet përkatëse Administrative.

Aplikimi i masave zhvillimore dhe masave të tjera

- Pas miratimit të planit, komuna ndërmerr masa për të lidhur planin me regjistrimin kadastral, duke përfshirë aktivitetet për hartimin e një plani të ri urbanistik, nëse plani nuk e ndryshon përdorimin e tokës në një lokacion të veçantë.
- Aplikimi i parcelizimit të sërishëm dhe i shpronësimit është i nevojshëm për arritjen e objektivave hapësinore dhe kjo duhet të bëhet sipas procedurave të përcaktuara me Ligjin mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03/L-139, Ligji nr. 04/L-115 dhe Ligji nr 03/L-205 mbi Ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 03/L-139 mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme, Ligji mbi kadastrën nr. 04/L-013 dhe Udhëzimet përkatëse Administrative.
- Komuna do të sjell dhe mirëmban databazën për planin hapësinor komunal (duke thirr në Ligjin mbi planifikimin hapësinor) i cili duhet të jetë në përputhje me databazën e shtetit.

Rindërtimi i ndërtesave qëllimi i të cilave është në kundërshtim me qëllimin e planifikuar

- Çështjet specifike që lidhen me vendbanimet joformale do të zgjidhen në përputhje me veprimtaritë e listuara në PZHK dhe në përputhje me udhëzimet e MMPH/DVP-së
- Komuna do të ndërmerr masa për parandalimin e ndërtimit në vendbanimet ku ndërtimi nuk është i lejuar.

6.14. Dispozitat per Bashkepunim

- Komuna do të informojë, bashkëpunojë dhe/ose do të lidh marrëveshje për bashkëpunim dhe bashkëfinancim me ministritë dhe agjencitë përkatëse për projektet e propozuara në PZHK që kërkojnë pjesëmarrjen e këtyre institucioneve.
- Komuna do të informojë, bashkëpunojë dhe/ose do të lidh marrëveshje për bashkëfinancim me komunitatet fqinje në projekte me interes të përbashkët. Komuna do të bashkëpunojë me Agjencionin për zhvillim regjional në realizimin e projekteve të tilla.
- Komuna do të informojë, bashkëpunojë dhe do të lidh marrëveshje për partneritet me kompani publike të shërbimeve publike të cilat janë kompetencë e këtyre kompanive (çështjet e furnizimit me ujë, kanalizim, rryma, menaxhimi i mbeturinave, etj.)
- Komuna do të bashkëpunojë dhe do të lidh marrëveshje për partneritet (PPP) me sektorin privat në projektet me interes të përbashkët për të dyja palët.
- Komuna do të krijojë marrëdhënie ndërkufitare të bashkëpunimit me komunitatet e shteteve fqinje në projektet me interes të përbashkët.
- Komuna do të bashkëpunojë me donatorë të ndryshëm në projekte të parapara me plan, zbatimin e të cilëve mund ta ndihmojnë programet e ndryshme të donatorëve.
- Komuna do të përkrahë dhe do të bashkëpunojë me OJQ-të në shumë projekte të cilat janë të parapara me plan, sidomos në projektet që kanë të bëjnë me fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe promovimin e vlerës komunale.
- Gjatë zhvillimit të planeve të tjera që dalin nga PZHK-ja, komuna duhet të sigurojë pjesëmarrjen e publikut (shoqërisë civile dhe pjesëmarrësve përkatës) nga fazat fillestare gjatë tërë procesit dhe të ndërmarrë fushata informuese, siç parashihet me dispozitat e Ligjit mbi planifikimin hapësinor.

6.15. Dispozitat per Renditjen Kronologjike te Fazave te Zbatimit

- Në një periudhë prej gjashtë muajve nga data e miratimit të PZHK-së, departamentet komunale duhet të shqyrtojnë politikat sektoriale me qëllim të përmbushjes së dispozitave të PZHK-së.
- Në një periudhë prej gjashtë muajve nga data e miratimit të PZHK-së, asambleja komunale duhet të miratojë një plan buxhetor për se paku tri vitet në vijim, i cili duhet të përmbajë sqarime dhe udhëzime mbi financimin e zbatimit të planit.
- Aktivitetet/ projektet e propozuara në PZHK-në janë të ndara në tri faza zhvillimore:
 - faza I: periudha 2014-2017 në të cilën janë projektet afatshkurtra/aktivitetet e lidhura me planifikime afatmesme të buxhetit komunal;
 - faza II: periudha 2014- 2020 e cila përfshin projektet/aktivitetet afatmesme;
 - faza III: periudha 2014- 2029+ e cila përfshin projektet/aktivitetet afatgjate.
- Të gjitha investimet në komunë cilat kanë karakter hapësinor duhet të jenë në përputhje me propozimet dhe prioritetet të përmbajtura në Planin zhvillimor komunal.
- Pas miratimit të buxhetit dhe hyrjes së tij në fuqi, komuna duhet të analizojë planin ekzistues të buxhetit (kornizë e buxhetit) dhe të përfshijë projekte që rezultojnë nga PZHK-a në përputhje me nivelin e prioritetit.

6.16. Elementet dhe Udhëzimet për Hulumtime të Mëtejshme

PZHK siguron kornizën për hartimin e studimeve dhe hulumtimeve në fusha specifike si:

- Studimi i fizibilitetit për përdorimin e energjisë alternative në përgjithësi, por edhe mundësia e përdorimit të saj për ngrohje qendrore;
- Studimi i fizibilitetit për sistemin e zonave ekonomike komunale të planifikuara;
- Studimi i fizibilitetit për zgjerimin e vendbanimeve në zona të prirura për rrëshqitje;
- Studimi i fizibilitetit për nevojat e trafikut publik;
- Hartimi i studimit për bujqësi të qëndrueshme;
- Hartimi i studimit për parandalimin e përmytjeve.

6.17. Dispozitat Përfundimtare

Hyrja në fuqi:

- Ky dokument hyn në fuqi pas miratimit të tij nga ana e Asamblesë komunale dhe 8 ditë pas lajmërimit në Gazetën Zyrtare të Kosovës. Plani shfaqet në faqen zyrtare të komunës.

Kohëzgjatja:


- Ky plan do të zgjasë deri në vitin 2029.


Monitorimi, vlerësimi dhe ndryshimi i planit:

- Monitorimi, vlerësimi i implementimit, ndryshimet dhe plotësimet e PZHK, do të kryhen sipas dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.


7. ANEKS- Hartat e PZHK-se

**SOCIJALNA INFRASTRUKTURA
INFRASTRUKTURA SOCIALE
SOCIAL INFRASTRUCTURE**





PUTNA INFRASTRUKTURA I JAVNI PREVOZ INFRASTRUKTURA RRUGORE DHE TRANSPORTI PUBLIK ROAD INFRASTRUCTURE AND PUBLIC TRANSPORT



**TEHNICKA INFRASTRUKTURA
INFRASTRUKTURA TEKNIKE
TECHNICAL INFRASTRUCTURE**

